

Edukata Islame
Revistë shkencore, kulturore islame tremujore
Viti XLI nr. 104 / 2013

Edukata Islame
Revistë shkencore, kulturore islame tremujore
Viti XLI nr. 104 - 2013

Botues:
Kryesia e Bashkësisë Islame e Kosovës
Prishtinë, rr. Vellusha nr. 84
Tel & fax: 038 / 224-024
e-mail: **edukataislame@hotmail.com**

Kryeredaktor:
Mr. Qemajl Morina
qemajlmorina@hotmail.com

Redaksia:
Akad. Pajazit Nushi, Dr. Fejaz Drançolli, Dr. Ejup Sahiti,
Nexhat Ibrahim, Hajrullah Hoxha dhe Dr. Xhabir Hamiti.

Sekretar i redaksisë:
Hajrullah Hoxha

Lektor:
Bislim Berisha

Realizimi: **Shtëpia Botuese**



*Redaktor teknik &
Operator kompjuterik:*
Nuhi Simnica

Shtypi: “Grafika REZNIQI” - Prishtinë

Tirazhi: 600

Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore
Viti XLI nr. 104 / 2013

Prishtinë
2013

EDITORIALI

Qemajl Morina

PRANVERA ARABE: MES ISLAMIT DHE LAICIZMIT

Edhe pesimistët më të mëdhenj të Pranverës Arabe nuk e kishin pritur një përfundim të këtillë aq të shpejtë dhe zhgënjyes të asaj që në fund të vitit 2010, u quajt revolucion i parë arab, që jepte shpresë për një të ardhme më të mirë të të gjitha vendeve arabe, sepse në fillim dukej se procesi i ndryshimit do t'i përfshinte të gjitha vendet një pas një. Mirëpo, siç duket shumë shpejt gjërat morën kahen e kundërt. Kjo u bë për shkak të gabimeve që bënë udhëheqësit e këtyre revolucioneve në një anë si dhe për shkak të kundërshtimeve të shumta që hasën projektet pro islamike nga forcat e shumta laike si dhe nga forcat ushtarake, siç ishte rasti i Egjiptit.

Kështu, nëse u bëjmë një vështrim vendeve të Pranverës Arabe do të shohim jo vetëm një destabilitet, por edhe mundësinë e dështimit të plotë të një projekti aq ambicioz, për të cilin në fillim shumica e popullatës e shikoi me simpati një hap të tillë. Kështu që Pranvera Arabe mund të kthehet në një Vjeshtë të vërtetë, e cila mund t'i çojë vendet e rajonit në një kaos të vërtetë politik dhe të sigurisë.

Këtë po e themi duke u mbështetur në realitetin e hidhur që po mbretëron në ato vende. Po fillojmë me Tunizinë, djepin e Pranverës

Arabe, ku edhe pas tre vjetëve të jetës së revolucionit kemi një qeveri në dorëheqje si dhe një kushtetutë objekt mospajtimi politik.

Në kohën kur opozita përkrahu propozimin e politikanit veteran, Muhamed Nasir si dhe ish-ministrin e Mbrojtjes Abdul Kerim Ez-zubejdi, në ndërkohë që Lëvizja Islame "Nahda" si dhe aleati i saj në qeverisje Partia për veprim demokratik mbështetën liderin e njohur politik Ahmed El-Misteri.

Në Siri, si duket gjasat janë minimale që bisedimet e Gjenevës 2 mes regjimit të Asadit dhe opozitës siriane, nën mbikëqyrjen e SHBA-së dhe Rusisë, të kenë far suksesi. Këtë më së miri e ilustron deklarata e ministrit sirian të Informimit Amran Ez-zabi, i cili ditë më parë për mediet siriane kishte pohuar: "Presidenti Beshar nuk do të shkojë në Gjenevë 2 për ta dorëzuar pushtetin." Për të shtuar se "Beshari do të mbetet president i Sirisë dhe kushdo që vjen me tjetër mendim, ne i themi të mos vijë fare që të mos jetë objekt talljeje nga të pranishmit. Si përgjigje në këtë, Ahmed Xherba, kryetar i Opozitës së bashkuar siriane, refuzoi të bisedojë për çfarëdo zgjidhjeje para se të tërhiqet Asadi nga pushteti.

Libia, e cila dy muaj më parë festoi dyvjetorin e vrasjes së diktatorit Muamer El-Gadafit, nuk ka qetësi në vend. Kryeqyteti Tripoli dhe Bengazi, vendi ku nisi revolucioni i Libisë. Ditëve të fundit sipas lajmeve që vijnë nga Libia thuhet se janë të fuqishme përleshjet e armatosura mes forcave rebele dhe forcave të rendit, të cilat kanë në dispozicion armatim modern që ka mbetur prej kohës kur në Libi ishte në pushtet ish-prijësi Gadafi. Qyteti i Bengazit pak ditë më parë përjetoi protesta të mëdha kundër një serie atentatesh, si dhe për shkak të gjendjes së sigurisë në qytet, ku u kërkua dorëheqja e qeverisë së kryeministrit, Ali Zejdani si dhe parlamentit të vendit. Kurse sipas lajmeve të fundit, mbrëmë një numër i konsideruar i të armatosurve nga qyteti Misrata kanë hyrë në Tripoli, gjatë përleshjeve janë vrarë 3 veta dhe janë plagosur dhjetëra të tjerë.

Në Jemen, ku gjendja është tejet kritike mes fiseve Huthijinve, të cilët u përkasin shijve dhe selefijve, ku thuhet se armëpushimi që sapo hyri në fuqi ishte prishur vetëm pak orë pas shpalljes së tij, në mome-

ntin kur Gjysmëhëna e Kuqe kishte filluar tërheqjen e të plagosurve nga vendi i përleshjes.

Ndërkohë që Egjipti, vendi më i madh arab, mbetet pothuaj i paralizuar deri në këtë kohë.

Në një anë kemi vendosmërinë e gjeneralit, Abdul Fetah Es-sisi, i cili nuk done të bëjë farë kompromisi, kurse në anën tjetër kemi “Vëllazërinë Myslimane”, të cilët thirren në legjitimitetin e fituar me anë të zgjedhjeve të lira, por që e humbën me puçin ushtarak që u bë kundër tyre.

Çështja, siç duket, arriti deri në atë masë sa Uashingtoni vendosi të qëndrojë në anën e legjitimitetit të “Vëllazërisë Myslimane”, duke ua ndërprerë ndihmën ushtarake prej 1.3 (një miliard e treqind milionë) dollarësh që SHBA-të i jepnin për çdo vit Egjiptit në bazë të Marrëveshjes së Kemp Davidit të vitit 1979, mes Egjiptit dhe Izraelit.

Por, siç duket kokëfortësia e gjeneralit egjiptian ishte aq e madhe sa që ai vendosi t’ia hapë dyert Rusisë për t’u rikthyer në Egjipt. Kështu, e përditshmja e afërt me qarqet qeveritare të Kajros “Al-Ahram” shkruante se brenda dy ditësh në Kajro pritej të vijë ministri i Jash-tëm rus, Sergej Lavrov si dhe ai i mbrojtjes Sergej Sojgoj, të cilët do ta përgatisin vizitën e Vladimir Putinit në Kajro, e cila është vizita e parë e një lideri rus që po i bënë Egjiptit pas shkatërrimit të ish-Bashkimit Sovjetik.

Në vazhdim po sjellim shkrimin e analistit, Halil al-Anan, nga *al-jazeera.com*, të botuar në portalin “Brezi ri”, i cili në mënyrë kritike i bën një vështrim gjendjes aktuale në Lindjen e Mesme.

Rënia e Vëllazërisë Myslimane të Egjiptit e ka vënë Islamin Politik në një udhëkryq. Kjo jo vetëm që ka treguar se ideologjia në vetvete nuk është një garantues i suksesit politik, por edhe që islamistët duhet të mendojnë sërish strategjinë dhe taktikat e tyre, në mënyrë që të menaxhojnë me mjedisin e ri të krijuar pas Pranverës Arabe. Megjithatë, debati mbi fundin e Islamit Politik, apo pas Islamit Politik në Lindjen e Mesme, jo vetëm që është i parakohshëm, por është edhe irrelevant dhe sigurisht mashtrues. Në vend të kësaj do të ishte më efe-

ktive të diskutojmë ndryshimet ideologjike dhe politike që mund të ndodhin brenda lëvizjeve islamiste gjatë kohës së krizës.

Impulsi i mbijetesës

Al-Anani, po ashtu në shkrimin e tij përmend një të vërtetë të hidhur, të cilën shumë analistë tjerë nuk e përmendin fare, e ajo ka të bëjë me atë se gjatë represionit, mbijetesa bëhet qëllimi kryesor për islamistët. Si lëvizje ideologjike dhe sociale, islamistët kanë tendencë të bashkohen në mënyrë që të ruajnë kohezionin midis anëtarëve. I tillë ka qenë rasti me Vëllazërinë Myslimane, që nga themelimi i saj në vitin 1928.

Lëvizja ka pësuar shumë kriza gjatë dekadave të fundit, megjithatë, ajo nuk është thyer ose ndarë. Lëvizjet islamike duken të jenë një reflektim i një blloku i shoqëror tradicional dhe konservator, që shihet të ketë kapluar shoqëritë arabe.

Gjatë tre dekadave të fundit, Vëllazëria Myslimane është zmadhuar mbi brutalitetin e ish-presidentit Hosni Mubarak dhe çnjerëzimin e grupit. Jologjike, shtypja mundëson islamistët që të mbijetojnë dhe të bashkohen, gjithashtu duke forcuar dhe zgjeruar rrjetet e tyre shoqërore. Kjo u pa më së miri me rrëzimin e Mubarakut, që ia mundësoi Vëllazërisë Myslimane të shfaqet si lëvizje më e fuqishme dhe më e organizuar e Egjiptit.

Impulsi i mbijetesës gjithashtu shpjegon edhe sjelljen e Partisë tuniziane Nahda. Gjatë tre vjetëve të fundit, udhëheqësit e Nahda-së kanë treguar një shkallë të lartë të pragmatizmit dhe fleksibilitetit. Andaj, ata ishin të prirë që të mos armiqësohen ose të marginalizojnë forcat laike dhe liberale të Tunizisë. Në vend të kësaj, ata treguan gatishmëri për të bërë lëshime ideologjike dhe politike, të cilat kulmuan kohët e fundit në marrëveshjen e tyre për t’i dorëzuar pushtetin një qeverie teknokratike. Në mënyrë të qartë shihet që Nahda ka marrë mësim nga përvoja e Vëllazërisë Myslimane në Egjipt.

Kriza e Islamit Politik

Rënia e Vëllazërisë Myslimane në Egjipt, ka zbuluar krizën që ballafaqohen islamistët pas Pranverës Arabe. Mungesa e një mendimi dhe agjende revolucionare. Shumica e lëvizjeve islamike në botën arabe mbajnë një vizion konservator dhe të vjetruar që nuk mund të jetojnë me aspiratat dhe ëndrrat që ushqyen Pranverën Arabe tre vjet më parë. Ky konservatorizëm, ose mungesa e ideologjisë revolucionare, vazhdon të jetë i papajtuësëm me mjedisin e ri që pasoi pas rënies së regjimeve të vjetra. Shumica e të rinjve arabë që dolën rrugëve ishin të motivuar kryesisht nga një agjendë revolucionare dhe ambicioze që do mund të ndryshojë jetën dhe fatin e tyre. Megjithatë, ata ishin të goditur nga shfaqja e islamistëve tradicionalë të cilët kërkonin të përhapnin revolucionin. Për më tepër, lëvizjet islamike duken të jenë një reflektim i një blloku shoqëror tradicional dhe konservator që shihet të ketë kapluar shoqëritë arabe.

Pamundësia për të krijuar një platformë të tillë revolucionare është në fakt arsyeja më e rëndësishme për rënien e Vëllazërisë Myslimane. Ata vazhdojnë të veprojnë si lëvizja shoqërore konservatore më e madhe në Egjipt. Kjo u mundëson atyre që të ruajnë një strukturë të mbyllur dhe rigide e përbërë nga klasat shoqërore të ulëta dhe të mesme të Egjiptit, të cilët janë të vendosura kryesisht në deltën e Nilit, dhe pjesët më të varfra të Egjiptit të Epërm.

Çuditërisht, segmente të mëdha të këtyre strukturave demografike u larguan nga Vëllazëria gjatë vitit të saj në pushtet, edhe pse ata përfituan më së shumti nga rrjeti i shërbimeve shoqërore të grupit.

E ardhmja e paqartë e Selefistëve

Gjatë tre vjetëve të fundit, selefistët kanë dalë si një nga fitimtarët e Pranverës Arabe. Ata kanë fituar pushtet të konsiderueshëm politik dhe kanë luajtur një rol kyç në riformimin e politikës së brendshme. Megjithatë, partitë selefiste duket se e kanë keqkuptuar se çfarë përfa-

qëson Pranvera Arabe dhe duket se pikësëpari kanë harruar përse kanë hyrë në politikë. Që prej rënies së Morsit, selefistët janë bërë gjithnjë e më të ndarë. Derisa partitë selefiste të tilla si al-Watan dhe el-Asalah kanë mbështetur Vëllazërinë, të tjerët si al-Nour kanë zgjedhur të mbështesin grusht-shtetin e korrikut. Ndërkohë, përpjekja e qeverisë të mbështetur nga ushtria për të kontrolluar sferën fetare ka kufizuar shejhut dhe imamët selefë për të përhapur ideologjinë e tyre. Mbyllja e disa kanaleve televizive selefiste ka lënë shumë liderë selefë të marginalizuar dhe të pazëshëm. E ardhmja e selefistëve duket të jetë gjithnjë e më e pasigurt, kryesisht për shkak të fleksibilitetit. Për shembull, ata krijuan aleancë me Vëllazërinë Myslimane kur ata ishin në pushtet vetëm e vetëm që të mbështetnin ushtrinë dhe planin e saj pas largimit të Morsit. Përpjekja e tyre në avancimin e agjendës së tyre politike dhe ideologjike ka rezultuar në një humbje të mbështetjes dhe besueshmërisë. Derisa fleksibiliteti i partisë al-Nour mund të theksojë mendjemprehtësinë dhe pragmatizmin e saj politikë, kjo mund gjithashtu të dëmtojë pozitën dhe kredibilitetin e partisë në mesin e islamistëve. Në përgjithësi, llogaritjet politike të al-Nour janë të trefishta: Së pari, ajo kërkon të sigurojë se Vëllazëria Myslimane nuk do të rimëkëmbet nga goditja aktuale në një kohë të shpejtë. Së dyti, udhëheqësit e al-Nour besojnë se ata mund të mbushin vakuumin politik i lënë nga Vëllazëria Myslimane, të paktën brenda elektoratit islam. Së treti, al-Nour shpreson të arrijë një rezultat të rëndësishëm në zgjedhjet e ardhshme parlamentare. Përvoja e tre vjetëve të fundit ka treguar se demokracia është një rrugë e gjatë dhe e ndërlikuar dhe pa përfshirjen e të gjitha forcave politike, stabiliteti i brendshëm dhe rajonal do të mbetet i paarrtshëm. Megjithatë, pragmatizmi i al-Nour mund t'iu kushtojë shtrenjtë. Në dëm të saj, partia është armiqësuar me palët tjera selefiste të tilla si al-Watan, el-Asalah dhe el-Fadhila.

Për më tepër, mbështetja e partisë dhënë planit të ushtrisë ka zemëruar shejh të ndryshëm selefë dhe njerëz të shquar që e kanë kritikuar ashpër strategjinë e partisë. Është e pamundur që al-Nour të ketë kapacitete organizative apo njerëzore që do t'i mundësonte të zëvendësojë Vëllazërinë Myslimane. Së fundi, nuk është e garantuar nëse

al-Nour do të mbetet një parti legale pasi që projekt-kushtetuta e re ndalon partitë fetare. Në të vërtetë, partia duket të jetë duke gërmuar varrin e vet dhe duke u bërë thirrje mbështetësve të saj që të votojnë “po” për kushtetutën.

Historikisht, represioni ka qenë një faktor kyç në gjenerimin e ekstremizmit, duke lejuar që të shfaqen tendenca islamike radikale dhe të dhunshme. Tekefundit, kur Gamal Abdel Nasser, presidenti i famshëm i Egjiptit gjatë viteve 1950 dhe 1960, ndoqi penalisht dhe torturoi shumë anëtarë të Vëllazërisë Mysliamne, Sejid Kutbi doli në sipërfaqe si krye-ideologu dhe frymëzoi shumë të rinj islamikë që e zbatuan filozofinë e tij në terren. Në mënyrë të ngjashme, masakra **R4baa**, e cila la qindra protestues paqësorë të vdekur, përveç represionit të vazhdueshëm, janë pika të mundshme kthese në rrugën e Islamit politik. Duke humbur besimin në demokraci, është e mundshme që të rinjtë islamistë të shkëmbejnë pjesëmarrjen në politikë paqësore me një ideologji dhe diskurs ekstrem Kutbist. Nëse kjo ndodh, do të ishte puthje e vdekjes për Pranverën Arabe.

Rimëkëmbja politike

Historia ka treguar Islamin politik të jetë një fenomen ripërtërirës. Kur ata ndeshen me një kërcënim për ekzistence, islamistët kanë tendencë për t’u përshtatur, të duruar dhe të shërohen, megjithëse në formë të ndryshme. Kur Naseri mori masa restriktive ndaj Vëllazërisë Myslimane, duke burgosur dhjetëra anëtarë të grupit, besonin shumë se lëvizja veç kishte vdekur. Megjithatë, lëvizja u rishfaq më e vrullshme dhe më e fortë në vitet 1970 dhe 1980. Më të fuqishëm dhe të fortë.

Në mënyrë të ngjashme, kur qeverisja laike turke pati rrëzuar Nexhmedin Erdogan, kryeministri islamist i Turqisë dhe udhëheqës i Partisë së Mirëqenies, islamistët turq goditën përsëri në vitin 2002, dhe kanë qeverisur vendin që atëherë. Megjithatë, kthimi i islamistëve turq ka ndodhur vetëm pasi kishin bërë ndryshime thelbësore në ideologjinë e tyre dhe platformën politike. Ata u zhvendosën nga “ideali-

zmi” i Erbakanit te “realizmi” i kryeministrit Rexhep Tajip Erdogan, dhe ndërtuan modelin e tyre të qeverisjes bazuar në meritokraci, transparencë dhe llogaridhënie.

Në të vërtetë, suksesi i Islamit politik në Turqi nënvizon se përfshirja është një faktor vendimtar në ndryshimin e ideologjisë dhe mendimit të islamistëve për të u bërë më të moderuar dhe progresivë.

Përvoja e tre vjetëve të fundit ka treguar se demokracia është një rrugë e gjatë dhe e ndërlikuar dhe pa përfshirjen e të gjitha forcave politike, stabiliteti i brendshme dhe rajonal do të mbetet i paarrtshëm.

Qemajl Morina

THE ARAB SPRING: BETWEEN ISLAM AND LAICISM

(Summary)

Even those, who were largely pessimistic about the Arab Spring, did not expect such a disappointing outcome of this movement, which promised a better future for all the Arab countries. In the beginning it seemed that all the Arab countries would be affected by the process of change. Yet, as it turned out to be, things quickly took another direction. This was due to the mistakes that were made by those leading these movements as well as the opposition these pro-Islamic projects encountered from secular and military forces, as was the case in Egypt. If we analyze the current situation in the countries which were affected by the Arab spring we notice instability as well as the chance of failure of a very ambitious project, which was viewed by most people with great sympathy. Consequently, the Arab Spring can turn into an Arab Autumn, which can lead the countries in the region into chaos, both political and with regard to security.

كمال مورينا

الربيع العربي بين الاسلام و العلمانية (خلاصة البحث)

يبدو أن أكثر المتشائمين للربيع العربي لم يكونوا ينتظرون هذه النهائية السريعة و المحزنة التي كانت تسمى في نهاية العام ٢٠١٠ أول ثورة عربية و التي كانت تبشر بمستقبل عربي مشرق في جميع الدول العربية لان في البداية كانت كل الدلائل تشير بأن الثورة ستشمل جميع البلاد.

و لكن مع الاسف الشديد الامور بسرعة أخذت اتجاهها معاكسا . هذا حصل لسببين : أولهما بسبب الاخطاء التي ارتكبتها زعماء تلك الثورات و السبب الثاني هو الاعتراضات الكثيرة التي واجهتها القوى الاسلامية من قبل العلمانيين و كذلك من الجيوش العربية مثل ما حصل في مصر .

AKAID

Nexhat Ibrahim

BESIMI NË KADER

و بالقدر خير و شره من الله تعالى...

Besimi në caktimin (kaderin) e Allahut xh. sh. është kushti i gjash-të i besimit islam. Mirëpo, duke marrë parasysh se kaderi dhe kadaja në aspektin e tyre përmbajtjesor, terminologjik nuk përmbahen në Kur'an, por as në kohën e as'habëve nuk dolën në sipërfaqe si tema thelbësore, ato përbëjnë një rëndësi prej çështjeve të akaidit islam që çojnë mes vullnetit hyjnor dhe vullnetit njerëzor, mes përsosmërisë së atri-buteve hyjnore dhe përgjegjësisë njerëzore.

A. Përkufizimi i kadasë dhe kaderit

Ulemaja islame ndahet lidhur me përkufizimin e konceptit “kader” dhe “kada”. Disa madje këto dy shprehje i konsiderojnë shprehje si-nonimike. Megjithatë, ne do t'i trajtojmë të dy kuptimet parësore.

Në kuptimin gjuhësor fjala “kader” do të thotë: matje, vlerësim, përcaktim, formësim, trajtësim etj. Në arabishte folja *kadere* do të thotë: vlerësoi, caktoi, ndau në pjesë, i caktoi secilit pjesën e vet, si

dhe munda, pati fuqi, që i aftë. Kurse trajta foljore *kaddere* do të thotë: vendosi, ekzekutoi, veproi.¹

Në kuptimin përmbajtjesor “kaderi” është vendimi i Allahut, kurse “kadaja” është ekzekutimi i këtij vendimi nga ana e Tij, respektivisht kadaja është kryerja e gjësë, për të cilën ka marrë vendim dhe zbatimin e vendimit. Me fjalë të tjera, kaderi është “*planëzimi dhe programimi nga Krijuesi i Lartë që zotëron dijen e pasosur, që i sheh dhe di të shkuarën, të tashmen dhe të ardhmen, si një pikë të vetme dhe për të cilën nuk ka të shkuar, të tashme dhe të ardhshme, i tërë gjithësisë etj. Kurse kadaja është zbatimin nga Zoti i gjerave të caktuara dhe vendosura prej Tij në pafillimshmëri, kur t'u vijë koha, me anë të vullnetit dhe fuqisë së Tij dhe në përputhje me dijen e tij eternale.*”²

Të këtij mendimi janë edhe maturidinjtë, të cilët shprehjes *kada`* ia atribuojnë kuptimin e krijimit (halk), kurse shprehjes *kader* ia atribuojnë kuptimin e përcaktimit (takdir).³

Imam Ebu Hanife e jep këtë përkufizim: “Caktimi (*kada`*) dhe përcaktimi (*kader*) dhe vullneti (*meshi`atu*) janë cilësitë e Tij të amshueshme pa (modalitetin) si”.⁴

Duke menduar për kaderin do të përfundojmë se ai është “përkatësia ndaj Allahut xh. sh. e çdo gjëje në planin informativ dhe me qenien e vet me karakter informativ para se të ndodhë. Gjëja që ka hyrë në kushtet e ekzekutimit dhe që përpiket të zërë vendin e vet mes vargut të aksidencave, shkruhet e shënohet me anë të engjëjve të respektuar në formë kopjesh të Librit të Kujtesës (Levhi Mahfudh) në Librin e Kujtesës dhe në provë përsëri me kusht që të jetë brenda dijes së Allahut xh. sh. Kaderi është bashkëshoqërimi i përpjekjes njerëzore me aktin krijues të Allahut xh. sh. Mohimi i kaderit merr kuptimin e mohimit të të gjithatributeve të Zotit, që çon në mosbesim.”⁵

¹ Vehbi S. Gavoci, Erkan'ul-imani, fq. 33-35.

² Udhërrëfyesi, I, fq. 248.

³ Sipas: Orhan Bislimaj, Akaidi hanefij, po aty, fq. 229.

⁴ Imam Ebu Hanifeh, El-Fikh'ul-ekber, po aty, fq. 69.

⁵ Fethullah.Gylen, Kaderi, po aty, fq. 19

B. Kaderi si parim besimi

Ekzistenca e Allahut xh.sh., pejgamberia e Muhammedit a.s., ma-dje edhe ringjallja mund të provohen shkencërisht. Por, kaderi nuk është i tillë, as nuk është çështje teorike dhe shkencore, sepse ai është çështje shpirtërore dhe i ndërgjegjes.

Domosdoshmëria e besimit në *kader* në Islam bazohet në dy argu-mente:

- 1) Në numrin e madh të ajeteve dhe të haditheve që flasin për domosdoshmërinë e besimit në kader dhe;
- 2) Në domosdoshmërinë e besimit në atributet absolute, të pakushtë-zuara e të pakufizuara të dijes, vullnetit dhe fuqisë së Zotit.⁶

Kur’ani në shumë ajete kur’anore na bën të qartë për ekzistimin e kaderit lidhur me njeriun. Allahu xh.sh. thotë:

مَا أَصَابَ مِنْ مُصِيبَةٍ فِي الْأَرْضِ وَلَا فِي أَنْفُسِكُمْ إِلَّا فِي كِتَابٍ مِّن قَبْلِ أَن نَّبْرَأَهَا ۚ إِنَّ ذَٰلِكَ عَلَى اللَّهِ يَسِيرٌ . لَّكَيْلًا تَأْسَوْا عَلَىٰ مَا فَاتَكُمْ وَلَا تَفْرَحُوا بِمَا آتَاكُمْ ۗ وَاللَّهُ لَا يُحِبُّ كُلَّ مُخْتَالٍ فَخُورٍ .

“S’ka mjerim (fatkeqësi) që e godet Tokën dhe juve, përveç asaj që është shënuar më parë në Libër; kjo për Allahun me të vërtetë është lehtë! Për të mos u dëshpëruar për atë që ju ka kaluar, por edhe për të mos u gëzuar së tepërmi për atë që Ai ju ka dhënë juve, Allahu nuk i do lavdëruesit dhe vetëmburrësit.” (El-Hadid: 22-23).

Ajeti i sipërm në mënyrë eksplicite tregon se të gjitha qeniet, du-kuritë dhe ngjarjet, e edhe njeriu dhe çdo gjë lidhur me të para se të dalin në ekzistencë janë të shkruara në dijen hyjnore.

Edhe hadithet flasin qartë lidhur me kaderin:

⁶ El-Buti, Të vërtetat e patundshme, po aty, fq. 150.

“...(besim do të thotë) të besosh Allahun, në engjëjt e Tij, librat e Tij, të dërguarit e Tij, ditën e ahiretit dhe kaderin, të mirën dhe të ke-qen...”. (Muslimi, Iman).

Pjesa e hadithit **“...dhe të keqen...”** tregon qartë se besimi në të mirën ashtu edhe në të keqen se e kanë prejardhjen nga Allahu do të thotë se çdo gjë bëhet me vullnetin dhe fuqinë e Allahut, por jo pse Allahu e do të keqen, por nga urtësia e Tij se e di paraprakisht se ç’do të ndodhë me njeriun dhe se Ai nuk vepron spontanisht por me dije hyjnore.⁷

Në një hadith Muhammedi a.s. u ka tërhequr vërejtjen besimtarëve të tij, të cilët justifikoheshin me kaderin, dhe duke lënë anash rolin dhe përgjegjësinë e njeriut në aktin e vet. Kjo lidhet me rastin kur Pejgamberi a.s. pas namazit të jacisë shkoi te Aliu r.a. i cili po bëhej gati të flejë. E pyeti atë:

“A ngrihesh natën për ta falur namazin e tehexhudit?” Aliu r.a. është përgjigjur: **“O i Dërguari i Allahut, jeta jonë është në dorë të Allahut, po deshi na e jep, po deshi na e merr, po deshi na zgjon!”** Atëherë Pejgamberi, duke i rënë me pëllëmbë gjunjëve të Aliut r.a., i ka thënë: **“Sa shumë po përpiqet njeriu.”** (Buhariu).

Kështu e shprehi pakënaqësinë e tij Muhammedi a.s. ndaj perce-ptimit justifikues të kaderit nga ana e Aliut r.a. Kjo do të thotë: Edhe pse njeriu përballet me një kader të përcaktuar nga ana e Allahut xh. sh., ai posedon edhe vullnetin dhe pëlqimet e tij, që së bashku kanë rol të rëndësishëm dhe për këtë rol të tyre kanë shpërblimin apo ndëshki-min. Në shikim të parë duket se ekziston kundërtënie, por gjendja nuk është ashtu.

- 1) Le të shohim nga dy shembujt vijues lirinë dhe përgjegjësinë e njeriut:

إِنَّا هَدَيْنَاهُ السَّبِيلَ إِمَّا شَاكِرًا وَإِمَّا كَفُورًا .

“Na, ia treguam atij rrugën, e ai (do të jetë) ose mirënjohës ose jomi-rënjohës.” (El-Insan: 3).

⁷ Udhërrëfyesi, I, po aty, fq. 250.

وَقُلِ الْحَقُّ مِنْ رَبِّكُمْ فَمَنْ شَاءَ فَلْيُؤْمِنْ وَمَنْ شَاءَ فَلْيُكْفُرْ ...

“Dhe, thuaj: “E vërteta është nga Zoti yt. Kush të dojë, le të besojë, e kush të dojë, le të mohojë ...”. (El-Kehf: 29).

2) Le të shohim nga dy shembujt vijues vullnetin hyjnor si bazë e veprimit të njeriut:

وَمَا تَشَاءُونَ إِلَّا أَنْ يَشَاءَ اللَّهُ ...

“Por ju nuk mund të doni, përveç nëse do Allahu...”. (El-Insan, 30).

... كُلِّ شَيْءٍ قُبُلًا مَّا كَانُوا لِيُؤْمِنُوا إِلَّا أَنْ يَشَاءَ اللَّهُ ...

“Po të mos donte Allahu, nuk do të besonin!” (El-En’am: 111).

... قُلْ إِنَّ الْأَمْرَ كُلَّهُ لِلَّهِ ...

“Thuaju: “Për të gjitha vendos vetëm Allahu!” (Ali Imran: 154).

Analiza e ajeteve kur’anore te grupit te parë tregon se njeriu është i lirë të dëshirojë, vetëm se realizimi i gjësë së dëshiruar prej tij varet nga vullneti dhe fuqia hyjnore; dëshirimi i njeriut nuk ka asnjë vlerë po qe se Allahu nuk e dëshiron po atë gjë dhe nuk jep leje për realizimin e saj. Këtë meditim tonin dijetari F. Gylen e elaboron kështu:

*“Allahu e ka pranuar aktin tonë që është një realitet konvencional, si fues të dëshirës dhe vullnetit të Tij, i ka dhënë rëndësi atij, ka premtuar se do t’i bëjë realitet projektet më të mëdha duke u mbështetur mbi të dhe e ka krijuar këtë element konvencional si një pretekst për mirësinë dhe mëkatën, e ka bërë bazë atë për shpërblimin dhe ndëshkimin ...”.*⁸

⁸ Udhërrëfyesi, I, po aty, fq. 218-219; F. Gylen, Kaderi, po aty.

C. Vullneti absolut i Allahut dhe liria relative e njeriut

Vullneti i Allahut (kaderi) është i paraqenë, i pasqenë, i pafund, i pakufizuar, i pakushtëzuar me diçka si dhe absolut dhe në gjuhën arabe quhet *el-iradet’ul-mutlaka* apo *el-iradet’ul-kul-lijeh*. Ai është i përkryer sikurse pasqyra e cila me besnikëri e kopjon objektin që qëndron përballë saj. Para dijës së Allahut e kaluara dhe e ardhmja nuk ekzistojnë, sepse Allahu e di ç’ka ndodhur, ç’po ndodh dhe ç’do të ndodhë. Sado i pjekur të jetë njeriu, urdhri dhe vullneti i përkasin Allahut xh. sh. Asnjë element nuk sendërtohet pa dëshiruar dhe pa treguar vullnet Ai. Pa dëshirën e Tij sot nuk do të ekzistonte as koha, as hapësira dhe do të ishte një hiç.

Kurse vullneti i njeriut ka një fund të caktuar, është i kufizuar dhe i kushtëzuar nga faktorë të tillë si koha, hapësira dhe në gjuhën arabe quhet *el-iradet’ul-xhuz’ijeh* etj. Vullneti i njeriut lidhet me të kaluarën dhe të tashmen deri te të cilat ka ardhur nëpërmjet shqisave dhe arsyes.⁹

Edhe pse në shikim të parë duket se ekziston dallim, Vullneti i Allahut nuk është në kundërshtim me lirinë e njeriut, por shkojnë paralel. Ky pohim konsiston në faktin se të besosh në kaderin e Allahut në parim do të thotë të besosh se çdo gjë që ekziston është me dijen, dëshirën, fuqinë dhe aktin krijues të Allahut, se nuk ka krijues tjetër përveç Allahut. Besimi në kader nuk do të thotë mohim i lirisë së njeriut, ku edhe buron mirësia dhe ndëshkimi për njeriun. Në këtë mënyrë, besimi në kader dhe parimi i zgjedhjes bëhen bashkë, partnerë dhe heq mundësinë që njeriu të kërkojë pretekst që gabimin e bërë t’ia hedhë kaderit. Këtë ndryshim A. Tantavi e thotë në mënyrën vijuese: Inxhinieri projektin objektin dhe tërë atë që nënkupton projektin, kurse ndërmarrësi realizon projektin e inxhinierit. E para është kaderi, kurse e dyta është kadaja. I pari mban të drejtën për ndryshime në projekt nëse këtë e kërkon nevoja, sikur që Allahu xh. sh. ndryshon

⁹ Mehmed Handzic, VI, po aty, fq. 570 etj.

planin nga mëshira e Tij, duke pranuar duanë dhe sadakën në dobi të njerëzve.¹⁰

Fakti se ne nuk e bëjmë një gjë pse Allahu e di në pafillim dhe pse e ka shënuar këtë që di, pra, pse i tillë është kaderi ynë, përkundrazi, Allahu i shënon ato që kemi bërë dhe kemi për t'i bërë sepse e di që më parë. Po qe se Allahu do të kishte shkruar jo për ta karakterizuar gjendjen, por me një vendim me anë të të cilit do të zbatohet ajo që duhej, atëherë vullnetit të njeriut nuk do t'i mbetej vlerë. Mulla Alij El-Karij këtë e shpjegon edhe me fjalët se sikur Allahu ta kishte detyruar njeriun të veprojë sipas dijes së Tij të paraqenë nuk do t'i thoshte **“do të bëhet** kështu e ashtu” por do t'i thoshte **“të bëhet** kështu e ashtu.”

Këtë mendim do ta ilustruam me një shembull të përshtatshëm:

*“Dukuritë dhe ngjarjet astronomike si eklipset e diellit dhe hënës përcaktohen që më parë dhe shënohen me ditë, orë e minuta në raportet dhe kalendarët shkencorë. Tani, a mos eklipset e diellit dhe hënës realizohen në atë orë dhe minutë pse u njohën e u përcaktuan nga shkencëtarët se u shënuan në kalendarë, apo shënohen në raportet e shkencëtarëve pse dihet që më parë se do të realizohen në atë orë? E vërteta është se eklipsi i diellit dhe hënës nuk ndodhin pse janë shënuar në kalendar, përkundrazi, shënohen në kalendar pse dihet që më parë se do të ndodhin.”*¹¹

Ç. Dallimi ndërmjet kaderit dhe fatalitetit

Në Islam ekziston kaderi (paracaktimi) por nuk ekziston fataliteti, siç pretendojnë disa grupime besimore apo individë me ndikim. Të tillët, pohojnë se *“rrjedha e ngjarjeve në natyrë, në shoqëri ose në jetën shpirtërore, sikurse edhe ekzistenca apo joekzistenca është e paracaktuar, nuk varet nga njeriu e njerëzimi”*. Mirëpo, në Islam, kaderi nuk kërkon nga njeriu që ta lëshojë veten në rrjedhën e ngjarjeve dhe t'i braktisë ibadetet dhe masat parandaluese. Kaderi është ndër kushtet

e besimit, por ikja nga besimi dhe aktiviteti nuk është justifikim për t'i arsyetuar mëkatet dhe gabimet e ndryshme se “kjo ka qenë kështu e shkruar”, pikërisht sikur që ndodh me një gjeth druri përballë erës. Përballë këtij qëndrimi xhebrit, hashevit etj., ekziston edhe qëndrimi kaderit dhe mu'tezilit i cili mendon se njeriu është i lirë në mënyrë absolute dhe se përzgjedhjen e veprës e bën vetë, me fuqinë krijuese që ia ka dhënë Krijuesi.¹²

Shkolla e ehli-sunetit dhe xhematit (maturidinjtë dhe esh'arinjtë) përdorin një rrugë të mesme, duke i ndarë detyrimet në:

- **Veprime të detyrueshme të pavullnetshme.** - Rrahja e zemrës, frymëmarrja, puna e trurit e të tjera janë refleksë të pavetëdijshme dhe natyrisht të pavullnetshme, respektivisht janë rezultat i vullnetit dhe përcaktimit hyjnor, ndërsa njeriu nuk ka përgjegjësi për punën e tyre.

- **Veprime të vullnetshme.** - Ecja dhe mosecja, puna dhe mospunja, falja apo mosfalja janë veprime të vullnetshme dhe për to njeriu ka përgjegjësi (shpërblim apo ndëshkim), por sërish krijues i të dyja grupeve është Allahu.¹³

وَاللَّهُ خَلَقَكُمْ وَمَا تَعْمَلُونَ .

“Kurse Allahu ju ka krijuar juve dhe ato që i bëni ju”. (Es-Saffat: 96).

اللَّهُ خَالِقُ كُلِّ شَيْءٍ ...

“Allahu është Krijues i çdo gjëje” (Ez-Zumer: 62).

Pra, parapëlqimi dhe përzgjedhja e veprimeve është nga njeriu, kurse krijimi është nga Allahu xh.sh.

¹⁰ Ali Tantavi, Prezentimi i përgjithshëm i fesë islame, Prishtinë, 2000, fq. 87-95.

¹¹ Sipas: Udhërrëfyesi, I, po aty, fq. 255-256.

¹² Ali Tantavi, po aty, fq. 93.

¹³ Es-Sabuni, po aty, fq. 121 ...; F. Gylen, Kaderi, po aty, fq. 35

Këtë e vërteton edhe ajeti kur'anor:

مَا أَصَابَكَ مِنْ حَسَنَةٍ فَمِنَ اللَّهِ وَمَا أَصَابَكَ مِنْ سَيِّئَةٍ فَمِنْ نَفْسِكَ ...

“E mira që të gjen ty o njeri, prej Allahut është, kurse e keqja që të godit, është nga merita jote...”. (En-Nisa` : 79).

Ibni Abbasi ajetin “*kurse e keqja që të godit, është nga merita jote*” e shpjegon me fjalët: “*Për shkak të mëkateve tua. Unë t’i kam përcaktuar.*”

Imam El-Maturidiu këtë e shpjegon si vijon: “*E keqja që e ka goditur njeriun për shkak të joedukatës së tij nuk mund t’i përshkruhet Allahut... Allahu e ka krijuar mundësinë e mosbesimit dhe ashtu ka dëshiruar të veprojë, por mosbesimin (kufrin) nuk e ka urdhëruar dhe mosbesimtarit i ka urdhëruar besimin, por ai nuk e ka dashur atë.*”¹⁴

Këtë e forcon edhe ajeti vijues kur'anor:

... فَإِذَا عَزَمْتَ فَتَوَكَّلْ عَلَى اللَّهِ إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ الْمُتَوَكِّلِينَ .

*“... Pasi të kesh vendosur për diçka, mbështetu tek Allahu. Allahu pa dyshim i do ata që mbështeten tek Ai.”*¹⁵

Shejh Gavoçi, dijetar shqiptar, thotë se ndodhitë në këtë gjithësi janë dy llojesh:

1. Gjerat që ndodhin plotësisht vetëm nga Zoti dhe në to nuk mund të ndërhyjë askush prej krijesave;
2. Gjerat që ndodhin dhe në to merr pjesë edhe njeriu apo edhe krijesat tjera.

Kjo nuk do të thotë se Allahu nuk ka dije për ato që ndodhin.¹⁶

D. Urtësia e sugjerimit për mospreokupim me temën e kaderit

Pejgamberi a.s. nuk e kishte për qejfi marrjen me temën e kaderit dhe kadasë. Niveli intelektual dhe qytetërues te arabët ishte në shkallë të ulët dhe nuk lejonte që ata të merren me tema të vështira. Mjaftoheshin me informacionet më elementare. Me një rast, kur vërejti se besimtarët po debatonin për çështjen e kaderit, ai iu tha as’habëve:

“A mos ju jeni urdhëruar për këtë apo mos unë u dërgova te ju për këtë? Kur ata që qenë para jush nisën të debatonin mbi këtë çështje, u shkatërruan!”

Me një rast tjetër tha:

و اذا ذكر القدر فامسكوا .

*“Nëse theksohet kaderi, përmbajuni.”*¹⁷

Përse e bëri Muhammedi a.s. këtë rekomandim rigoroz, ka shumë urtësi:

Çështja e kaderit është çështje besimi, kurse debatimi dhe polemizimi me çështjet e besimit nuk është i drejtë për shkak të delikatshmërisë së temës. Por, nuk ka ndonjë të keqe nëse kjo temë diskutohet në mënyrë kompetente, konstruktive, pa stërhollime dhe ngatërresa. Kjo gjë ka rezultuar me një sërë shkrimesh mjaft të nevojshme për këtë temë dhe kontribute të vyeshme.

Njeriu ka kaderin e vet të lidhur me vullnetin e vet si dhe kaderin e vet që vepron jashtë vullnetit të vet. Duke u nisur nga fakti se mendja e njeriut është e krijuar dhe nuk ka kapacitet t’i perceptojë gjerat metafizike si Krijuesin, në pajtim me mësimin islam, ajo nuk do të mund t’i kuptojë të gjitha urtësitë dhe misteret e kaderit. Të tilla fshehtësi të kaderit janë: vendlindja, gjinia, prindërit, fatkeqësitë etj. Ato vijnë nga faktorë jashtë vullnetit të njeriut, prandaj edhe për këtë di-

¹⁴ Imam El-Maturidiu, Jeta, vepra dhe mësimi, po aty, fq. 226.

¹⁵ Kur’ani, Ali Imran: 159. Es-Sabuni, Akaidi maturidij, po aty, fq. 124-125.

¹⁶ Vehbi S. Gavoçi, Degët e imanit, po aty, fq. 33-34.

¹⁷ Mustafa Mahmud, El-Kur’an muhaveletun li fehmin asrijjin, Kajro, 1980, fq. 26.

mension të kaderit Pejgamberi i Allahut e ka ndaluar të debatohet e polemizohet.

Përpjekja e njeriut për ta zgjidhur në mënyrë të prerë çdo specifikë lidhur me kaderin, do të thotë përpjekje për një gjë që e kapërcen kapacitetin e tij. Kaderi nuk është koncept vendor dhe kohor dhe nuk lejon që të eksplorohet nga po këta faktorë.¹⁸

Pejgamberi a.s. e ka ditur se kaderi është një ndër temat filozofike në të cilën nuk mund të jepet përgjigje nëpërmjet të arriturave shkencore të kohës së tyre. Polemika në këtë rast do t'i shpinte në hapësirat ku do të lajthiteshin. Për këtë arsye, prioritet i ka dhënë besimit me zemër kundrejt përpëlitjeve sterile e racionale.¹⁹

¹⁸ Udhërrëfyesi, I, fq. 257-258.

¹⁹ Mustafa Mahmud, El-Kur'an, fq. 26.

Nexhat Ibrahim

BELIEF IN AL-QADAR

(Summary)

Belief in Al-Qadar is the sixth article of faith. Yet, bearing in mind, that the phrase Al-Qada' wal-Qadar was not mentioned as such in the Qur'an, and did not arise as a topical issue in the time of the As'hab, the topic is related to Islamic aqeedah.

نجد إبراهيم

الايمان بالقدر

(خلاصة البحث)

و بالقدر خيره و شره من الله تعالى

الايمان بالقضاء و القدر يعتبر الشرط السادس للاسلام و لكن بما أن القضاء و القدر بحسب محناه و مصطلحاته لم يذكر في القرآن الكريم و كذلك في عهد الصحابة عليهم السلام لم يظهر كموضوعات رئيسية و على الرغم ذلك هما موضوعان يدخلان في اطار العقيدة الاسلامية و التي تتعلق بين الارادة الالهية و الارادة الانسانية و كذلك بين كمال الصفات الالهية و بين مسؤولية الانسانية .

Mr. Ejup Haziri

KAMATA DHE ALTERNATIVAT ISLAME

Hyrje

Në këtë punim do ta trajtojmë kamatën si një dukuri shkallmuese, e cila ka shkallmuar individë e shoqëri dhe ka rrënuar shtete e fuqi. Do ta trajtojmë kamatën si një dukuri të ndaluar, ku do t'i përmendim shkaqet dhe arsyet e ndalesës së saj. Do t'i elaborojmë dy llojet e njohura të kamatës, llojet që përfshijnë ato dhe motivet e ndalimit. Gjithashtu do të trajtohen edhe dispozita tjera që kanë ndërlidhje me kamatën, dhe në fund do të ofrohen alternativat islame, ku do të përmenden mundësi të ndryshme që njerëzit të mos trokasin në dyert e kamatarëve, por të drejtohen tek institucionet kredibile, sipas vlerave islame dhe tek individë të ndryshëm të tregohen solidarë dhe të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin, sidomos me ata që janë në gjendje të vështirë. Islami kur ka ndaluar diçka ka ofruar motivet e një ndalese të tillë, por në rrafshin tjetër ka ofruar alternativa tjera.

Sidoqoftë, jam i vetëdijshëm se një tematikë e tillë është e gjerë, ndërkaq është e pamundur të përfshihet brenda një punimi të tillë, mirëpo shpresoj se me ndihmën e të Madhit Zot, do të përmenden gjërat thelbësore dhe do të përfshihet ajka e kësaj tematike.

Përkufizimi

Kamata (ribaja) në aspektin etimologjik do të thotë shtim, shtesë¹, në këtë kontekst ka ardhur në Kur'an:

وَتَرَى الْأَرْضَ هَامِدَةً فَإِذَا أَنْزَلْنَا عَلَيْهَا الْمَاءَ اهْتَزَّتْ وَرَبَتْ ... ﴿١٠٠﴾

“E ti e sheh tokën e tharë - të vdekur, e kur Ne ia lëshojmë asaj ujin ajo gjallërohet, shtohet...”²

Po ashtu ka ardhur:

وَمَا آتَيْتُم مِّن رِّبَا لَّيْرَبُوا فِي أَمْوَالِ النَّاسِ فَلَا يَرَبُّوهُ عِنْدَ اللَّهِ ... ﴿١٠١﴾

“Dhe çka të jepni nga pasuria për ta shtuar e rritur (me kamatë), në pasurinë e njerëzve, ajo nuk do të shtohet tek Allahu...”³

Ndërkaq, në aspektin terminologjik ribaja-kamata nënkupton shtimin që e merr huadhënësi⁴ nga huamarrësi, kundruall një kohe të caktuar, pa të drejtë.⁵ Si p.sh. nëse një person i jep hua një personi tjetër me vlerë 5000 euro për një vit, e pastaj ia kërkon 6000, që i bie 1000 euro shtesë për kohën dhe afatin.

Dispozita e kamatës

S'ka dyshim se kamata është e ndaluar, kurse argumentet që e ndalojnë atë burojnë nga Kur'ani, suneti, analogjia dhe nga mendja e shëndoshë.

¹ Kasim ibn Abdullah el-Hanefij, *Enisu-l Fukaha fi Ta'rifat-il Elfadh el-Mutedaviletu bejne-l Fukaha*, dar el-kutub el-ilmijetu, 1424h-2004m, fq. 77.

² Kur'ani, Haxh: 5.

³ Kur'ani, Rum: 39.

⁴ Në ditët e sotme huadhënësit (borxhdhënësit) quhen kreditorë. Kurse huamarrësit (borxhmarrësit) me kamatë quhen debitorë.

⁵ Muhamed Ali Sabuni, *Fikhul Muamelat*. vëll. I, fq. 140.

Nga Kur'ani

Allahu i Madhërishëm thotë:

وَأَحَلَّ اللَّهُ الْبَيْعَ وَحَرَّمَ الرِّبَا ... ﴿٢٧٥﴾

“...Allahu e ka lejuar shitblerjen, por e ka ndaluar kamatën...”⁶

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ وَذَرُوا مَا بَقِيَ مِنَ الرِّبَا إِن كُنتُمْ مُؤْمِنِينَ ﴿٢٧٦﴾

“O ju që besuat, kijeni frikë Allahun dhe, nëse jeni besimtarë të sinqertë, hiqni dorë prej asaj që ka mbetur nga kamata.”⁷

Nga Suneti

Nga Ebu Hurejre transmetohet se si i Dërguari i Allahut ka thënë: “Largohuni prej shtatë gjërave shkatërruese.” Atij i thanë: “Cilat janë ato, o i Dërguar i Allahut?” Profeti tha: “T’i bësh ortak Allahut; magjia; vrasja, të cilën e ka ndaluar Allahu, përveçse me të drejtë; ngrënia e kamatës; ngrënia e pasurisë së jetimit; dezertimi nga fushëbeteja dhe shpifja ndaj grave të ndershme e besimtare.”⁸

Ndërsa në hadithin tjetër thuhet:

لَعَنَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ أَكِلَ الرِّبَا وَمُؤَكِّلَهُ وَكَاتِبَهُ وَشَاهِدِيهِ وَقَالَ هُمْ سَوَاءٌ

“I Dërguari i Allahut ka mallkuar ngrënësin e kamatës, atë që e jep (autorizon) atë, shkruesin e saj, dëshmitarët e saj, dhe tha: Të gjithë janë njësoj.”⁹¹⁰

⁶ Kur’ani, Bekare: 275.

⁷ Kur’ani, Bekare: 278.

⁸ Buhariu në Sahihun e tij, nr. i hadithit 6351, Muslimi në Sahihun e tij, nr. 129, Ebu Davudi në Sunenin e tij, nr. 2490. Hadithi është autentik.

⁹ Të gjithë ata janë njësoj - në mëkat dhe në dënim.

¹⁰ Muslimi në Sahihun e tij, nr. 2995. Hadithi është autentik.

Nga librat paraprakë të shenjtë:

Madje, kamata është e ndaluar në të gjitha fetë qiellore, në hebraizëm dhe krishterim. Në Dhiatën e Vjetër përmendet: “Nëse i jep hua dikujt nga populli yt, mos kërko prej tij fitim për pasurinë tënde.”¹¹ Në një citat tjetër thuhet: “Nëse vëllai yt ka nevojë për diçka, ndihmoje atë...mos kërko prej tij as fitim, as dobi.”¹² Porse hebrenjtë nuk shohin ndonjë pengesë në marrjen e kamatës prej johebraikut, siç përmendet në versetin 20, kapitulli 23, prej librit Deuteronomisë.¹³ Kur’ani u jep përgjigje këtyre, kur thotë në suren Nisa:

وَأَحْذِهِمُ الرِّبَا وَقَدْ هُبُوا عَنْهُ ... ﴿٢٧٧﴾

“Edhe për shkak të marrjes së kamatës edhe pse e kishin të ndaluar atë...”¹⁴

Në Dhiatën e Re thuhet: “Nëse i jepni hua dikujt, prej të cilit parashikoni ndonjë shpërblim, çfarë merite do të keni? Por bëni mirësi dhe jepni hua pa pritur përfitim për këtë. Atëherë shpërblimi juaj do të jetë i mirë.”¹⁵

Nëse flasim për kamatën në shoqëritë tjera njerëzore, do të vërejmë si disa shoqëri e praktikuan e disa tjera ishin kundër saj. Kështu, sa për ilustrim, egjiptianët dhe grekët e lashtë e kundërshtuan kamatën si praktikë të dëmshme shoqërore. Soloni, një jurist i njohur dhe njëri nga Shtatë të Mençurit e Greqisë, u mundua ta ndalonte kamatën në ligjet e tij. Aristoteli, filozofi më i famshëm grek, po ashtu e kundërshtoi kamatën. Ai tha se kamata ishte ndër gjërat më të dëmshme për shkak se përfaqësonte një fitim pa punë nga kapitali. Duhet të kujtohet që në mesjetë në Evropë një borxhli që nuk paguante futej në burg për kohë të gjatë ose merrej në skllavëri nga kreditori i tij.¹⁶

¹¹ Verseti 25, kapitulli 22 i librit të Eksodit.

¹² Verseti 35, kapitulli 25 i librit të Levit.

¹³ Sejid Sabik, *Legjislacioni i traditës së Profetit*, vëll. III, fq. 243.

¹⁴ Kur’ani, Nisa: 161.

¹⁵ Verseti 34, kapitulli 6, Ungjilli i Llukës.

¹⁶ Grup autorësh, *Hyrje në ekonominë dhe financat islame*, fq. 94.

Konsensusi i dijetarëve:

Dijetarët janë unanimë sa i përket ndalesës së kamatës, që nga koha e të Dërguarit të Allahut [paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të] e këndeje, saqë asnjë prej tyre nuk e ka kundërshtuar këtë. Maverdiu ka thënë: Është thënë se në asnjë legjislacion nuk është lejuar kamata, bazuar në fjalët e të Madhërishmit: **“Edhe për shkak të marrjes së kamatës, edhe pse e kishin të ndaluar atë...”**¹⁷ E që është për qëllim në librat e mëhershëm para Kur'anit.¹⁸

Kronologjia e ndalimit të kamatës

Ndalimi i kamatës erdhi në mënyrë graduale, ashtu siç kishte ardhur edhe ndalesa për alkoolin, metodë kjo që Islami zgjodhi për shërimin e punëve të shëmtuara të njerëzimit, duke parapërgatitur shpirtrat dhe mendjet për të pranuar dispozitat e Islamit me shumë bindje e kënaqësi, në një formë të përshkallëzuar për të mos iu shkaktuar atyre një goditje të befasishme.¹⁹

Kur'ani ka folur për kamatën në vende të ndryshme, të renditura sipas kohës. Në periudhën mekase zbriti ky ajet kuranor:

وَمَا آتَيْتُم مِّن رَّبًّا لِّيرِيُوٓا۟ فِي۟ أَمْوَالِ النَّاسِ فَلَا يَرِيُوٓا۟ عِنْدَ اللَّهِ وَمَا آتَيْتُم مِّن زَكَاةٍ تُرِيدُوٓا۟ وَجْهَ اللَّهِ فَأُولَٰئِكَ هُمُ الْمُضَعِفُونَ ﴿٢٤﴾

“Dhe çka të jepni nga pasuria për ta shtuar e rritur (me kamatë), në pasurinë e njerëzve, ajo nuk do të shtohet tek Allahu, e çka të jepni nga sadakaja (bamirësia) me qëllim që t'i afroheni Allahut, të tillët janë ata që u shumëfishohet (shpërblimi).”²⁰

Ky ajet ka zbritur para se të ndalohet kamata, ajeti tregon se shtimi i pasurisë në këtë mënyrë nuk do të sjellë shtimin e saj tek Allahu, gjë

që sjell mesazhin për mendjen e myslimanit se kjo vepër bie në kundërshtim me natyrën e pastër njerëzore me të cilën kënaqet Allahu xh.sh.²¹

Në periudhën medinase zbriti ndalesa e qartë e kamatës përmes ajetit kuranor:

يٰۤاَيُّهَا الَّذِيْنَ ءَامَنُوْا لَا تَاْكُلُوْا رِبٰٓوًا اُضْعَفًا مَّضْعَفًا ۚ وَاتَّقُوْا اللّٰهَ لَعَلَّكُمْ تُفْلِحُوْنَ ﴿٢٣٠﴾

“O ju të cilët besuat, mos e hani kamatën që po e shumëfishoni dhe kijeni frikë (dënimin e) Allahun ashtu që të gjeni shpëtim.”²²

Ky ajet ka trajtuar marrëdhëniet në periudhën e injorancës lidhur me shtyrjen e afateve për larjen e borxheve. Kamata shtohet dhe shumëfishohet sa herë që shtyhet shlyerja e borxhit. Ata nuk e njihnin diferencën ndërmjet kamatës së rëndë dhe asaj të lehtë, të cilat i shpikën sistemet e sotme. Thënia e Allahut **“që po e shumëfishoni”** nuk do të thotë kufizim të kamatës, e cila përmban çmim të lartë, apo që ka masë të madhe, por përmbledh të gjitha format e kamatës që praktikoheshin në borxhet me interes apo kamatë, që do të thotë se ndalesa është për të gjitha llojet e kamatave të buta apo të forta qofshin, në kundërshtim me atë që besojnë orientalistët se kamata është e ndaluar pjesërisht e më pas është e ndaluar plotësisht.²³

Së fundi vjen qëndrimi i prerë në një formë të atillë që Kur'ni nuk e ka sjellë ndonjëherë, duke ndaluar, duke kërcënuar dhe premtuar dënim. I Madhërishmi tha:

يٰۤاَيُّهَا الَّذِيْنَ ءَامَنُوْا اتَّقُوا اللّٰهَ وَذَرُوْا مَا بَقِيَ مِنَ الرِّبَاۤ اِنْ كُنْتُمْ مُّؤْمِنِيْنَ ﴿٢٣١﴾

“O ju që besuat, të keni frikë ndaj Allahut dhe, nëse jeni besimtarë të sinqertë, hiqni dorë prej asaj që ka mbetur nga kamata.”²⁴

¹⁷ Kur'ani, Nisa: 161.

¹⁸ Vehebeh Zuhejli, *el-Fikhul Islamij ve Edil-letuhu*, vëll. V, fq. 3699.

¹⁹ Muhamed bin Saleh el-Uthejmin, Ahmed Es-Salus, *Kamata, lufta me Allahun*, Jehona, gusht 2004, fq. 27-28.

²⁰ Kur'ani, Rrum: 39.

²¹ Muhamed bin Saleh el-Uthejmin, Ahmed Es-Salus, *Kamata, lufta me Allahun*, fq. 28.

²² Kur'ani, Ali Imran: 130.

²³ Muhamed bin Saleh el-Uthejmin, Ahmed Es-Salus, *Kamata, lufta me Allahun*, fq. 29.

²⁴ Kur'ani, Bekare: 278.

الَّذِينَ يَأْكُلُونَ الرِّبَا لَا يَقُومُونَ إِلَّا كَمَا يَقُومُ الَّذِي يَتَخَبَّطُهُ الشَّيْطَانُ
مِنَ الْمَسِّ ... ﴿٢٧٥﴾

Ata që e hanë kamatën, ata nuk ngrihen ndryshe vetëm se si ngrihet ai çmenduri nga të prekurit e djallit...²⁵ Për përdoruesit e saj i Madhërishtmi shpalli luftë të hapur:

فَإِنْ لَّمْ تَفْعَلُوا فَأْذَنُوا بِحَرْبٍ مِّنَ اللَّهِ وَرَسُولِهِ ... ﴿٢٧٦﴾

“E në qoftë se nuk e bëni këtë (nuk hiqni dorë nga kamata), atëherë binduni se jeni në konflikt me Allahun dhe të dërguarin e Tij...”²⁶

Ky ajet përmban përgjigje të prerë për atë që thotë se kamata nuk ndalohet për raste të tjera, por vetëm nëse është e shumëfishuar (pra nga dhënia e borxhit), sepse Allahu i Lartësuar nuk ka lejuar asgjë tjetër, por veçse kthimin e kapitalit fillestar, e jo shtesën mbi të, pasi ky është ajeti i fundit që ka zbritur për këtë çështje.²⁷

Duke pasur parasysh atë që e thamë më lart, kuptojmë se ndalimi i kamatës shfaqet në Kur'an në katër vende të ndryshme. Së pari, ajeti i 39 i sures së 30, i shpallur në Mekë, thekson se ndërsa kamata e largon pasurinë nga bekimi i Zotit, bamirësia e shton atë. Së dyti, ajeti i 161-të i sures së 4-t, i shpallur në periudhën e hershme të Medinës, e dënon atë ashpër, në vijë me ndalimin e kamatës në ajetin e mëparshëm. Ai i vë ata që e hanë kamatën në një vend me ata që kanë uzurpuar pa të drejtë pronën e njerëzve të tjerë dhe i kërcënon që të dy me dënimin e Zotit. Së treti, ajetet 130-132 të sures së 3-të, të shpallura rreth vitit të dytë pas hixhretit, i urdhërojnë myslimanët të qëndrojnë larg kamatës, nëse dëshirojnë mirëqenie (në kuptimin e plotë islam). Së katërti, ajetet 275-281 të sures së 2-të, të shpallura afër plotësimit të misionit të të Dërguarit, u kundërvihen në mënyrë të rreptë atyre që

²⁵ Kur'ani, Bekare: 275.

²⁶ Kur'ani, Bekare: 279.

²⁷ Sejid Sabik, Legjislacioni i traditës së Profetit, vëll. III, fq. 243.

e marrin kamatën, duke krijuar një dallim të qartë ndërmjet tregtisë dhe kamatës.²⁸

Urtësia e ndalimit të kamatës

Çdo urdhër ose ndalesë në Islam e ka urtësinë e vet, ndërsa në këtë kontekst edhe ndalimi i kamatës ka urtësitë e saj.

Legjislacioni Islam e konsideron kamatën njërin ndër krimet më të mëdha shoqërore dhe fetare, ndaj këtij fenomeni i ka shpallur luftë, duke i kërcënuar përdoruesit e kamatës me dënim të dhembshëm në këtë botë dhe në botën tjetër. E na mjafton neve ta dimë se përdoruesit e kamatës do të ngrihen sikur të çmendurit, apo sikur ata që janë të prekur nga xhinët, që nuk mund të ecin mirë, kanë pengesa në të folur, ashtu sikurse i çmenduri që është i prekur në trupin dhe mendjen e tij.²⁹ **“Ata që e hanë kamatën, ata nuk ngrihen ndryshe veçse si ngrihet ai çmenduri nga të prekurit e djallit...”**³⁰ Për përdoruesit e saj i Madhërishtmi shpalli luftë të hapur: **“E në qoftë se nuk e bëni këtë (nuk hiqni dorë nga kamata), atëherë binduni se jeni në konflikt me Allahun dhe të dërguarin e Tij...”**³¹

Kamata sjell dëme të mëdha shpirtërore, shoqërore, ekonomike dhe fetare. Në aspektin shpirtëror kamata paraqet egoizëm, koprraci dhe e vdes shpirtin e bashkëpunimit dhe interesit shoqëror mes njerëzve. Gjithashtu, ajo ndikon në largimin e mirësisë dhe të mirës njerëzore, saqë kamatari bëhet i pamëshirshëm që nuk i intereson gjë tjetër përpos pasurisë së tjerëve, duke u buzëqeshur atyre e në realitet ua fsheh kthetrat.

Sa i përket aspektit shoqëror, mund të themi se ajo lind armiqësi dhe urrejtje ndërmjet individëve të shoqërisë, sikurse që bëhet shkak për prishjen e lidhjeve njerëzore dhe shoqërore, ndërmjet shtresave të njerëzve, gjithashtu ajo ndikon në largimin e mëshirës dhe dhembshu-

²⁸ Grup autorësh, Hyrje në ekonominë dhe financat islame. fq. 58.

²⁹ Muhamed Ali Sabuni, Fikhul Muamelat. vëll. I, fq. 159.

³⁰ Kur'ani, Bekare: 275.

³¹ Kur'ani, Bekare: 279.

risë, ndikon në largimin e bashkëpunimit dhe mirësisë ndërmjet njerëzve, ajo mbjell në zemra urrejtjen, zilinë dhe shkatërron lidhjet e dashurisë dhe vëllazërisë.³²

Në aspektin ekonomik, kamata i ndan njerëzit në dy shtresa: shtresa e pasur, e cila jeton në luks dhe kënaqet me djersën e të tjerëve; dhe shtresa e varfër, e cila jeton në skamje dhe varfëri, e kjo pa dyshim që shkakton armiqësi ndërmjet shtresave të njerëzve, saqë disa bëhen si shtazë të egra duke i shfrytëzuar të tjerët, e kështu fillojnë sprovat dhe të këqijat.³³

41. Husein Hifzi, *Hulâsa-i Târîh-i ‘umûmî (kurûni vustâ)*, osmanisht, histori (mesjeta), Stamboll 1908, 18.5x12.5, f. 112, pronarë Hafiz Islami i biri i Hafiz Shabanit, viti 1907.
42. ***, *Ilmi hâl*, për klasat e iptidais (fillores), osmanisht, doracakë, Stamboll 1915, 19x12, f. 16; 42/A, *Yeni küçük târîhi Islâm*, osmanisht, histori, Stamboll 1909, 19x12, f. 54; 42/B, Mehmed Celâl, *Zihni ‘ameli-hisâb dersleri* (për klasën e dytë), osmanisht, matematikë, Stamboll 1909, 19x12, f. 80, “Karâbit Matbâ’ası”; 42/C, Hilmi (Ankara Darûl-muallimin müdiri), *Cogrâfyâ*, osmanisht, gjeografi, Stamboll 1910, 19x12 cm, f. 46. “Murtebiyyîn Osmâniyye Matbâ’ası”.
43. ‘Ali Seyyidi, *Sokollulü Mehmed Paşa*, osmanisht, histori, Stamboll 1909, 18x12, f. 59. “Kanâ’at Matbâ’ası”.
44. Şihâbuddîn Süleymân, *Sanâ’at, tahrîr ve edebiyât*, osmanisht, Letërsi, Stamboll 1911, 18x12 cm, f. 295, “Arâkas Matbâ’ası”.
45. Abdûlhakim Hikmet Dogani-Gostivari⁵, *Türkçe dersleri*, doracakë për mësimin e turqishtes, osmanisht, gjuhësi, Sarajevë 1923, 22.5x15 cm, f. 104, jo komplet, “Zemalska matbâsende”.

⁵ Abdulhaqim Hiqmet Dogani (1880-1955), lindi në vitin 1880 në një famijle me tradita të hershme fetare dhe patriotike, për shumë vite me radhë babai i tij kishte shërbyer si myfti i Gostivarit. Pasi përfundoi studimet e larta në Stamboll, Abdulhaqim Hiqmet Dogani ndoqi rrugën e mësuesisë. Në vitin 1911, afërsisht për gjashtë muaj, ushtroi detyrën e profesorit të gjuhës shqipe në shkollën Normale (Darul-mu’allimin) të Shkupit. Për pak kohë, ai u zgjodh edhe deputet në Parlamentin e dytë Osman si përfaqësues i Gosti-

46. ***, *Ticāret ve nāfi'a nezāretī*, osmanishte, ekonomi, Stamboll 1899, 25x16.5 cm, kopertina të forta, "Mahmud Beg Matbā'ası".
47. ***, *Fezlek-i Tārīhi osmānī*, osmanishte, histori, Stamboll 1869, 18.5x12.5, "Matbā'a-i 'Āmire".
48. ***, *'Alem-i tārīh*, osmanishte, historiografi, pa vit dhe vend botimi, 20.5x14.5, nuk ka shënime të tjera.
49. Ibrāhīm Halebī bin Muhammed, *Multekā 'l-Ebhur*, arabisht, fikh-jurisprudencë islame, Stamboll 1882, 22x15 cm, pronë e Kapllanit të birit të Fazliut nga Shkupi, "Matbā'a-i Ihtirā".
50. ***, *Nasīhatū 'l-hukemāi*, osmanishte, etikë islame, pa vit dhe vend botimi, 17x11.5 cm. Ka një vulë që shkruan "Hysni". Nuk është komplet.
51. Ticarzāde Ibrāhīm Hilmī, *Müslimān büçük yeni Ilmi hāl*, osmanishte, doracakë, Stamboll 1908, 18x13 cm. "Mahmūd Beg Matbā'ası".
52. ***, *Muntehabāt lügati osmāniyye*, fjalor arabisht, persisht-osmanisht, Stamboll, 1950, 20.5x14.5.
53. Hāfiz Hüseyin efendi bin el-Hāci Ismā'īl el-Ivanseriyy, *Hadīkatu 'l-cevāmi'*, vëllimi II, osmanishte, histori, Stamboll 1865, 24x16 cm. "Matbā'a-i 'Āmire".
54. ***, *Terceme-i ve şerh-i Mesnevī şerīf*, vëllimi IV, persisht-osmanisht, Stamboll 1907, 24x16, "Kütübhanē-i 'İrfān".
55. Ahmed Refik, *Büyük Tārīh-i 'umūmī*, vëllimi II, osmanishte, histori, Stamboll 1910, 24x16, "Kütübhanē-i Islām ve 'Askeriyy (Ibrāhīm Hilmī)".
56. *Zirā'at isfātistiki* (viti i parë), për vitin 1905, të dhëna për malet, xehet, bujqësinë etj. të Evropës Osmane, osmanishte, statistikë, Stamboll 1908, 27.5x19.5, "Mahmūd Beg matbā'ası".
57. *Xhyzi i fundit i Kuranit fisnik*, arabisht.

varit. Por, kontributi i tij kryesor konsiston në fushën e tekstologjisë, si didakt ai mban autorësinë e të paktën 16 teksteve shkollore, të cilat janë të shkruara në gjuhën turke. Në këtë kuadër ai hartoi dhe një "Abetare shqip me gërma arabe" ("Arnavutça elifba-arap harlariyla"), ndërsa në vitin 1946 hartoi një "Abetare" të gjuhës shqipe, të cilën për shkaqe objektive ne nuk kemi mundur ta sigurojmë brenda kohës që po përgatishim këtë kumtesë.

58. *Jasini dhe dua*, arabisht-osmanisht, Kuran dhe etikë islame.
59. ***, *Şerhi Bustān*, persisht-osmanisht, poezi, Stamboll 1871, 25.5x16.5, "Matbā'ai 'Āmire".
60. ***, *Tācü t-Tevārīh*, osmanishte, histori, nuk ka fillim dhe fund, formati 26.5x16 cm.
61. Ahmed Refik, *Büyük Tārīhi 'umūmī*, vëllimi III, osmanishte, histori, Stamboll 1910, 24x16, "Kütübhanē-i Islām ve 'Askeriyy (Ibrāhīm Hilmī)".
62. Ibn Is'hāk Ibrāhīm ibn 'Ali b. Yūsuf esh-Şirāzī, *Tercume-i kāmūs*, vëllimi I, arabisht-osmanisht, gjuhësi-leksikografi, Stamboll 1887, 20x13.5, "Kütübhanē-i Rizelī Hasen Hilmī efendi".
63. ***, *Kāmūs tercümesi*, përktheu Ebu 'l-Kemāl es-Seyyid Ahmed 'Āsim, arabisht –osmanisht, leksikografi, Stamboll 1888, 20x13.5, botuar nën mbikëqyrjen e Hasan Hilmiut dhe Hasan Tahsinit, në "Cemāl Efendi Matbā'ası".
64. Hāfiz Husein efendi bin el-Haci Ismā'īl el-Ivanseriyy, *Hadīkatū 'l-cevāmi'*, vëllimi II, osmanishte, histori, Stamboll 1865, 24x16 cm. "Dāru 't-Tabā'ati 'Āmire".
65. Ahmed Refik, *Büyük Tārīh-i 'umūmī*, vëllimi I, osmanishte, histori, Stamboll 1910, 24x17 cm, "Kütübhanē-i Islām ve 'Askeriyy (Ibrāhīm Hilmī)".
66. Muhamed ibn Mālik, *Şerh-i Ibn 'Akil 'alā Elfiye*, gramatikë arabe, arabisht, Stamboll 1876, 22.5x14.5 cm. Pronë e Salih Sabriut nga Prishtina, "Matbā'ai 'Ali Beg".
67. Ahmet Muhtār, *Ruhber necātī Risāle*, vëllimi I, osmanishte, etikë islame, Stamboll 1881, 22x15, "Mekteb Sanā'i Şahhāne-i Matbā'ası".
68. Ismā'īl Hakkı, *Kitābu 'l-huttāb*, osmanishte, akaid-etikë islame, Stamboll 1840, 21x15 cm, ka shënime në margjina, "Matbā'ati Kursiyy".
69. *Ballkân harbende şerki Erdos komandanti Abdullāh Paşa'nen hatīrātī*, vëllimi I, osmanishte, histori, Stamboll 1918, 23x15 cm, "Erkân Harbiyeti Mektebi Matbā'ası".

70. *Seid Paşa'nın hatîrâtî*, vëllimi I, osmanishte, histori, Stamboll 1910, 24x16 cm, "Sabah Matbâ'ası"
71. *Fetâvâ 'Ali efendi*, vëllimi I, osmanishte, jurisprudencë islame-fikh, Stamboll 1894, 27.5x18.5 cm, nën redaktuarën e Osman Hilmi Qarâ Hisârit, "Matbâ'ai 'Âmire".
72. Muhammed Zekkî, *Maktûl şehzâdeleri*, osmanishte, histori, Stamboll 1918, 23x15, "Ikbâl Kütübhanesi, sâhib ve nâşir: Husein".
73. ***, *Şerh-i Birgevî*, osmanishte, etikë dhe akaid islam, Stamboll 1835, 23x16 cm, është lënë vakëf për Mektebin e vogël dhe mektebin e Madh të Vushtrrisë nga Sylejmani nga fshati Turiqec, "Darû 't-Tabâ'ati 'Âmire", nën mbikëqyrjen e Şeyhzâde es-Seyyid Mehmed Es'ad.
74. Joseff von Hammer, *Devlet-i Osmâniyyeti Târihi*, përktheu Mehmed 'Atâ, vëllimi VII, osmanishte, histori, Stamboll 1914, 23x17 cm, "Artin Asâdoriyân ve Mahdumleri".
75. Joseff von Hammer, *Devlet-i Osmâniyyeti Târihi*, përktheu Mehmed 'Atâ, vëllimi I, osmanishte, histori, Stamboll 1911, 23x17 cm, "Artin Asâdoriyân ve Mahdumleri". I dëmtuar.
76. Joseff von Hammer, *Devlet-i Osmâniyyeti Târihi*, përktheu Mehmed 'Ata, vëllimi IX, osmanishte, histori, Stamboll 1917, 23x17 cm, i dëmtuar.
77. Mihri, *Mutavvel sarfî osmânî*, për shkollat rushdije dhe idadije, osmanishte, gramatikë, Stamboll 1887, 23x15, "Matbâ'ai Nişâni Berberiyân".
78. *Hatîrâtî Sulltân Abdülhamîd Hân Thânî*, osmanishte, histori, Stamboll 1920, 23.5x16.5, "Cihân Kütübhanesi".
79. Rif'at, *Nez'hetu 'l-Munşeât*, osmanishte, Stamboll 1873, 22.5x16 cm.
80. ***, *Tercemetu 'l-Kâmûs*, vëllimi III, osmanishte, fjalor, Stamboll 1888, 20x13.5 cm, "Kütübhanë-i Rizeli Hasen Hilmi efendi".
81. ***, *Tercemetu 'l-Kâmûs*, vëllimi II, osmanishte, fjalor, Stamboll 1888, 20x13.5 cm, "Kütübhanëi Rizeli Hasen Hilmi efendi", "Bahriye Matbâ'ası".

82. Ahmed Kâmil, *Takvîm-i devri dâim*, osmanishte, histori, Stamboll 1893/94, 18x12 cm, "Matbâ'ai 'Âmire".
83. *Ahdi cedîd (Incili şerif)*, përkthim nga gjuha greke në gjuhën osmane, Dhjata e Re, Stamboll 1895, 13.5x9 cm, është pa kopertinë, i dëmtuar dhe i mungon fundi.
84. Ahmed Cevdet Paşa (përgatiti), *Mecelle-i Ahkâmi adliye*, osmanishte, jurisprudencë, Stamboll 1896/97, 16.5x11 cm, "Âlem Matbâ'ası Ahmed Ihsân ve şurekâsi".
85. ***, *Peyâde ta'limnâmesi*, osmanishte, jurisprudencë, Stamboll 1906, 16x11 cm, "Dâire-i 'Askeriye Matbâ'ası".
86. Abdullâh Cevdet-Ismaîl Ibrâhîm, *Osmanlıce ceb lügati*, osmanishte, fjalor, Stamboll 1896, 13x9 cm, "Kasbâr Matbâ'ası".
87. Şemsuddin Sami Frashëri, *Kâmûs ul-A'lâm*, vëllimi I, osmanishte, enciklopedi, histori-gjeografi, Stamboll 1889, 25x17 cm, "Mihrân Matbâ'ası".
88. Şemsuddin Sami Frashëri, *Kâmûs ul-A'lâm*, vëllimi II, osmanishte, enciklopedi, histori-gjeografi, Stamboll 1889, 25x17 cm, "Mihrân Matbâ'ası".
89. Şemsuddin Sami Frashëri, *Kâmûs ul-A'lâm*, vëllimi III, osmanishte, enciklopedi, histori-gjeografi, Stamboll 1891, 25x17 cm, "Mihrân Matbâ'ası".
90. Şemsuddin Sami Frashëri, *Kâmûs ul-A'lâm*, vëllimi IV, osmanishte, enciklopedi, histori-gjeografi, Stamboll 1894, 25x17 cm, "Mihrân Matbâ'ası".
91. Şemsuddin Sami Frashëri, *Kâmûs ul-a'lâm*, vëllimi V, osmanishte, enciklopedi, histori-gjeografi, Stamboll 1896, 25x17 cm, "Mihrân Matbâ'ası".
92. Şemsuddin Sami Frashëri, *Kâmûs ul-A'lâm*, vëllimi VI, osmanishte, enciklopedi, histori-gjeografi, Stamboll 1898, 25x17 cm, "Mihrân Matbâ'ası".
93. Sami Frashëri, *Kâmûs frânsevi-turki*, osmanishte-frëngjisht, fjalor, botimi i tretë, Stamboll, 20x13, pronë e Nexhmuddinut nga Shkupi, "Mihrân Matbâ'ası".

94. 'Ali Nezīm- Reşād, *Mukemmil osmānli lügati*, osmanishte, gjuhësi, Stamboll 1901, 18x12 cm, "Hāci Husein efendi Matbā'ası".
95. Nën mbikëqyrjen e Muallim 'Ali Haydar-it, *Düreru 'l-hukkām şerh mecelleti 'l-ahkām*, osmanishte, jurisprudencë, Stamboll 1895/96, 20x13.
96. Tāhā Zāde Ümer Fāruk bin Muhammed Murād, *Tārīh Ebū 'l-Fārūk*, vëllimi V, osmanishte, histori e osmanëve, Stamboll 1911, 19.5x14, botim i parë, "Matbā'ai Āmidī".
97. Xhon Dobenport, *Hazreti Muhammed ve Kurāni Kerīm*, përktheu Ümer Rizā, osmanishte, histori, Stamboll, 1926, 14.5x20 cm, Pronë e Ibrahim Fehmiut, i cili më 1933 e kishte blerë këtë libër në Sarajevë në vlerë 12 dinarë. Pronari i lut lexuesit e këtij libri që të kenë kujdes dhe ta ruajnë këtë libër. Ibrahim Fehmiu d.v.
98. Muallimi 'Ātif Beg, *Şerh-i Erāzi kânunname-i humāyūnī*, osmanishte, jurisprudencë, Stamboll 1901, 20.5x14, "Mahmud Beg Matbā'ası".
99. Necip 'Āsim-Mehmed 'Arif, *Osmānli tārīhī*, vëllimi I, osmanishte, histori, Stamboll 1917, 25x16 cm, "Matbā'ai Orhāniye".
100. Dr. Frans Babinger, *Tevārih-i 'Āli Osmān*, osmanishte, histori, Hanover 1925, 22.5x14 cm, "Hanover Şerki Kütübhanesi".
101. Ebū 'z-Ziyā, *Nevsāl ma'rifeti*, osmanishte, histori-kronologji, Stamboll 1889, 23x15, "Matbā'ati Ebu 'z-Ziyā".
102. Ebū er-Refīd Muhammed Hafīd ibn Mustafā 'Āşir, *ed-Düreru 'l-muntehabāt el-menthure fī islāhi 'l-illetatil-meşhūre*, osmanishte, Stamboll 1863, 23x14, "Dāru 't-Tabā'a".
103. Ibrāhīm bin Abdullāh bin Ibrāhīm Bābātāgi, *Halebī Bābātāgi tercumesi*, osmanishte, jurisprudencë, Stamboll 1872, 23.5x15.
104. Ahmed bin 'Aliy bin Mes'ūd, *Merāh el-Ervāh*, arabisht, gramatikë, Stamboll 1893/94, pronë e Sherif Idrisit nga Stanovci i Poshtëm i Vushtrrisë dhe i Ahmed Musiqit po ashtu nga Stanovci i Poshtëm i Vushtrrisë.
105. Ahmed Cevdet Paşa, *Tārīh-i Cevdet*, osmanishte, histori, Stamboll 1858/59, 24x16 cm, ka një vulë ku shkruan "Osman", "Dāru 't-Tabā'a-i Āmire".

106. Përgatiten: Ismā'il Hakkı dhe 'Ali Reşād, *Bismārk (hayāt husūsi ve siyāsi)*, osmanishte, histori, Stamboll 1898/99, 20x13, "Matbā'ati 'Āmire".
107. ***, *Tārīh-i Yunānistāni kadīm (kablel-milād min 2200 ilā 146)*, osmanishte, histori, Stamboll 1869, 20x12, "Matbā'ati 'Āmire".
108. 'Abidin Paşa, *Tercumeti ve şerhi Mesnevī şerif*, osmanishte, misticizëm, Stamboll 1908, 25x16, "Kütübhanë-i 'Irfān".
109. Mustafā Ibrāhīm, *'Avāmili cedīd tühfesi*, arabisht-osmanisht, gramatikë, Stamboll 1883, 24.5x16.5, Pronë e Salih efendiut, "Rif'at efendi Matbā'ası".
110. 'Abidin Paşa (Ankara Valisi), *Tercume-i ve şerh-i Mesnevī şerif*, osmanishte, misticizëm, Stamboll 1889, 26x17 cm, "Mahmud Beg Matbā'ası".
111. Hālis Eşref, *Külliyāt şerhi Kānūni erāzi*, osmanishte, juridikë, Stamboll 1898, 23x15, "Kütübhanë-i Cihān Sāhibi Mihrān".
112. Hāfiz Nūrī, *Tecvīd*, osmanishte, texhvid, Stamboll 1910, 19x13.
113. Abdurrahmān Karābāşī, *Tecvīdi Karābāş*, osmanishte, texhvid, Stamboll 1899, 24x16 cm. "Matbā'ati 'Āmire".
114. Ahmed Rāsim, *Osmānli Tārīhī*, vëllimi I, botimi i parë, osmanishte, histori, Stamboll 1910-1911, 20x14 cm, e ilustruar me harta dhe vizatime, "Şemsi Matbā'ası".
115. Ahmed Rāsim, *Osmānli Tārīhī*, vëllimi III, botimi i parë, osmanishte, histori, Stamboll 1910-1911, 20x14 cm, e ilustruar me harta dhe vizatime, "Şemsī Matbā'ası", "İkbāl Kütübhanesi".
116. *Sālnāme-i Devlet-i 'Āliye-i Osmāniyye*, për vitin 1900, viti i VI, osmanishte, kronologji, Stamboll 190221x13 cm, "Matbā'a-i Ahmed Ihsān ve şurekāsī".
117. Vallter Scot, *Salahud-dīn Eyyūbi*, përktheu Muhammed Halid, osmanishte, histori, Stamboll 1910, 20x14, "Mihrān Matbā'ası".
118. 'Ali Nezīmā, *Mukemmil osmānli lügati*, arabisht-osmanisht, fjalor, Stamboll 1900, 18x12 cm.
119. 'Ali Nezīmā, *Mukemmil osmānli lügati*, arabisht-osmanisht, fjalor, Stamboll 1900, 18x12 cm.

120. Mehmed Celāl, *Osmānli edebiyāti numūnleri*, osmanishte, letërsi, Stamboll 1895, 20x14 cm, “Matbā’i Safā ve Enver”.
121. M. Behāuddīn, *Yeni türkçe lügati*, botimi III, osmanishte, fjalor, Stamboll, 18x12 cm, “Evkāf Islamiyye Matbā’ası”.
122. Muallim Nācī, *Lügati-i Nācī*, arabisht-osmanisht, fjalor, pa vit dhe vend botimi, 20x14 cm, “Asr Matbā’i”.
123. ‘Abdurrahmān Karābāšī, *Tecvīdi Karābāš*, osmanishte, texhvid, Stamboll 1911, 23x15.5 cm, “‘Ali Rāif Matbā’ası”.
124. Ahmed Rāsim, *Osmānli Tārīhī*, botimi I, vëllimi II, osmanishte, histori, Stamboll 1910, 20x13 cm, “Şemsī Matbā’ası”.
125. Nāmik Kemālī, *Külliyāti Kemāl* -ikinci tertipi osmanli tarihi, vëllimi I, pjesa III, osmanisht, histori, Stamboll 1908, 20x13.5 cm, “Mahmud Beg Matbā’ası”.
126. Ahmed Refik, *Kapakci Mustafā*, osmanishte, histori, Stamboll 1913, 18.5x12.5, botimi III, “Kütübhanē-i Askeriye (Ibrāhīm Hilmi)”.
127. Tāhā Zāde Ümer Fārūk bin Muhammed Murād, *Tārīh Ebū ‘l-Fārūk*, vëllimi II, botimi i parë, osmanishte, histori e Perandorisë Osmane, Stamboll 1910, 20x13 cm, “Matbā’i Āmīdī”.
128. *Hadikatu s-suedā*, osmanishte, poezi-letërsi, Stamboll, 22x14 cm. Nuk është komplet.
129. Mehmed Zihni, *el-Muşedhdheb*, gramatik dhe sintaksë osmanishte-arabisht, Stamboll 1902, 21.5x14.5 cm, ka një vulë ku shkruan Mehmedi i biri i Jasharit, “Āsādorīyān Matbā’ası”.
130. Hāfiz Ferīd, *Tecvīd*, shkenca kuranore, osmanisht, Stamboll 1896/97, 20x14 cm, “Kaspār Matbā’ası”.
131. ***, *Emsile*, gramatikë osmane, Stamboll 1897/98, 17x12.5 cm.
132. ‘Azmi, *Elif-bā*, Abetare osmane, Stamboll 1904, 19x14 cm, “Kaspār Matbā’ası”.
133. Husein Hifzi, *Hulāsa-i sarfī osmānī*, gramatikë osmane, Stamboll 1905, 16x12, “Āh Āsādorīyān Matbā’ası”.
134. Munif Paşa, *Destāni ‘Āli Osmān*, osmanishte, poezi, Stamboll 1882, 20x14 cm, “Mihrān Matbā’ası”.

135. Suleymān Hüsni Paşa, *Hulāsa-i vukū’āti harbiye*, osmanishte, kujtime, histori, Stamboll 1906, 23x17 cm.
136. Ahmed Refik, *Sokollulū*, osmanishte, histori, Stamboll 1924, 19x13 cm, “Orhaniye Matbā’ası”.
137. *Kurāni Kerim Tercümesi*, përkthim i Kuranit fisnik nga arabishtja në gjuhën osmane, përktheu Cemil Seidi, pa vit dhe vend botimi, 20x14 cm, nuk shënon ku është botuar.
138. Mihri, *‘Alāveli kades-i muharerāt resmīyeti ve gayru resmīyeti*, osmane, paleografë, Stamboll 1886, 23x16.
139. ***, *Letāifu Hoca Nasruddīn*, osmanishte, Stamboll 1907, 24x16 cm, “Hilāl Matbā’ası”.
140. *Irşādu ‘l-gāfilīn*, osmanishte, etikë, Stamboll 1908, 24x17 cm, “Darū ‘t-Tabā’a ‘Āmire”.
141. Ahmed Bicān, *Envāru ‘l-āşikīn*, osmanishte, teologji, Stamboll 1897, 23x15 cm, “Matbā’i Osmāniye”.
142. Ahmed bin ‘Aliy bin Mes’ūd, *Merāhu l-Ervāh*, arabisht-osmanisht, gramatikë, Stamboll 1899, 27x19 cm.
143. *Seid Paşa’nen hatirātī*, vëllimi II, osmanishte, histori, Stamboll 1910, 24x16, “Sabāh Matbā’ası”.
144. *Seid Paşa’nen hatirātī*, vëllimi II, pjesa II, osmanishte, histori, Stamboll 1910, 24x16, “Sabah Matbā’ası”.
145. H. Rāif, *Ma’lūmāt kânūniyye*, osmanishte, jurisprudencë, Stamboll 1909, 18.5x12.5 cm.
146. Dr. M. Sa’di, *‘Ilm-i Erāzī*, osmanishte, gjeografë, Stamboll 1909, 19x13 cm, “Tābiyye-i ‘Askeriyye Matbā’ası”.
147. Ahmed Refik, *Köprülülēri* (familja e Qyperlinjve, shqiptarë nga Berati), osmanishte, histori, Stamboll 1913, 8.5x12.5, “Kütübhanē-i ‘Askeriye”.
148. Muallim Nācī, *Mektebi edeb*, pjesa I, osmanishte, letërsi, Stamboll 1897, 19.5x13.5, pronë e Glisha Elezoviçit, “Nişāni Berberiyān Matbā’ası”.
149. Mustafā Hamza, ‘Atāli cedīd ‘ale ‘l-idhhār, koment veprës *Idh-hāru ‘l-Esrār* të Birgeviut, gjuha osmane, gjuhësi, Stamboll 1871,

- 23.5x16 cm. Pronë e nxënësit të medresesë “Pirinaz” të Prishtinës Hafiz Rrystemit, është vënë edhe vula e hafiz Rrystemit.
150. Husein ‘Atay - Ibrāhim ‘Atāy dhe Mustafā ‘Atay, *Mu’cemu ‘l-lügati*, (*Büyük Lügati*), vëllimi I, pjesa III, arabisht turqisht, fjalor, Ankara 1966, 24x17.
151. Husein ‘Atay - Ibrāhim ‘Atay dhe Mustafā ‘Atay, *Mu’cemu ‘l-lügati*, (*Büyük Lügati*), vëllimi II, pjesa I, arabisht turqisht, fjalor, Ankara 1968, 24x17. “Hilāl Matbā’asi”, Ankara.
152. *Kadin*, gazetë, nr. 1-11, viti i parë, 1906, gjuha osmane, drejtor A. Avni, Stamboll 1906, 27x18.5 cm.
153. Ahmed Refik, *Büyük Tārīhi ‘Umūmī (kurūni vustā)*, vëllimi IV, osmanishte, histori, Stamboll 1909, 24x16 cm, “Kutübhāne-i Islām ‘Askeriye”.
154. Seyfullāh efendi Nizāmuddīnī, *Mi’rācu ‘l-mu’mini*, osmanishte, poezi, Stamboll 1850, 24x16 cm, pronë e Hysejn Spahiut (në vitin 1910), 24x16 cm, “Şeyh Yahyā efendi’nin Matbā’asi”.
155. Mevlānā Muhamed ‘Ali, *Peygamberimiz Aleyhi ‘s-selām*, përktheu Ümer Riza, osmanishte, histori, Stamboll 1923/24, 22.5x15.5cm, “Mahmud Beg Matbā’asi”.
156. Pjesë nga Kurani, *Xhyzi ‘Amme dhe Jasini sherif*, arabisht, Sarajevë 1932, “Matbā’ati Omer Şahiç”.
157. ‘Abdurrahmān Karābāşī, *Tecvīdi Karābāş*, osmanishte, texhvid, pa vit dhe vend botimi, 23x16 cm. “‘Arīf efendi Matbā’asi”.
158. Ibn Hācib, *el-Kāfiye*, arabisht, gramatikë arabe, Stamboll 1899, 23.5x15, Pronë e Enver Eminut të birit të Muhamedit nga Mëhalla e Gazi Ali Beut në Vushtrri. “El-‘Alem Matbā’asi”.
159. Muallim Nācī, *Ta’limu kirāeti*, pjesa IV, osmanishte, ushtrim leximi, Stamboll 1906, 21.5x13 cm. “Hilāl Matbā’asi”.
160. Abdulhakim Hikmet Dogani (nga Gostivari), *Türkçe dersleri*, osmanishte, doracakë i gjuhës turke, Sarajevë 1923, 23x15 cm.
161. ***, *Sā’atnāme*, arabisht, Stamboll 1871, 23x15 cm.
162. ‘Ali Haydar, *Kosova meydān muhārebesi*, osmanishte, histori, Stamboll 1910, 19.5x11 cm. “Matbā’ai Ebu Ziyā”.

163. ***, *Ahlāk*, vëllimi I, osmanishte, etikë islame, doracakë për mektebin iptidai, Stamboll 1901, 20x14.5 cm. “Āsādorīyān Matbā’asi”.
164. Ahmed Cevdet-Osmān Şevki, *Ta’lim-i kirāeti –yeni usūl*, pjesa III, osmanishte, gjuhësi, Selanik 1912, 20x14.5, “Yeni ‘Asr Matbā’asi”.
165. ***, *Devlet-i ‘Āliye-i Osmāniye, (tārīh-i siyāsī)*, vëll. 1, osmanishte, histori, Stamboll 1327/1909, 24.5x17.5, “Matbā’a-i Ahmed Ihsān”.
166. *Kitāb el-Ahd el-kadīm (Dhiata e Vjetër)*, osmane, teologji, Paris 1873, 26x20, f. 318, “Darü ‘t-Tabā’at-i ‘l-Mulkiyyeti ‘l-Ma’mureti”.
167. *Kitāb el-Ahd el-kadīm (Dhiata e Vjetër)*, osmane, teologji, Paris 1873, 26x20, f. 318, “Darü ‘t-Tabā’at-i ‘l-Mulkiyyeti ‘l-Ma’mureti”.
168. ‘Ali Tevfik, *Memāliki Osmāniye cogrāfiyesi*, osmanishte. Gjeografi, stamboll 1308, 17x12, “Karābet Matbā’asi”.
169. Mehmed Tāhir Brusali, *Osmānli müellifleri*, vëll. 2, osmanishte, histori, Stamboll 1338/1919, 28x19, “Matbāa-i ‘Āmire”.
170. Niyāzī, *Divāni Niyāzī*, osmanishte, letërsi, Stamboll 1285, 23x15.5.
171. *Kurāni Kerīm*, arabisht, teologji, pa vit dhe vend botimi, 14x9, Nuk është komplet.
172. Ebu ‘l-Cezmi Hifzi, *M’alūmāti fenniyye ve sihiyye*, osmane, doracakë shkollor, Stamboll 1328/1910, 17x11, “Artin Āsādorīyān Matbā’asi”.
173. Mehmed Izzet, *‘Ilmi ceber*, osmanishte, algjebër, Stamboll, 1319/1901, 17x11, “Karābet Matbā’asi”.
174. Ya’kub Kadri, *Nūr Baba*, osmanishte, mistikë, Stamboll, 1922, 20x14, “Akşām Matbā’asi”, pronë e Mustafa Beg efendiut.
175. Ya’kub Kadri, *Nūr Baba*, osmanishte, mistikë, Stamboll 1923, 20x14.5, “Orhāniye Matbā’asi”, pronë e Mustafa Beg efendiut.
176. Ahmed Cevdet, *Kavā’idi osmāniye*, osmanishte, gjuhësi, Stamboll 1308/1890, 17x11, “Kaspār Matbā’asi”.

177. ***, *Ta'limu l-fārisi*, abetare persiane, osmanishte, Stamboll 1317/1899, 17x13, "Darü 't-Tabā'ati 'Āmire", pronë e Hurshid agazade Mulla Sherifit (1374/1954).
178. Kādi zāde Islambolli (Ahmed b. Mehmed Emini), *Cevhere-i behiye-i Ahmediyye fī şerhi 'l-vasiyyeti 'l-Muahamediyye*, osmanishte, etikë, Stamboll 1223/1808, 19x14.
179. Mahmud b. el-Husein b. El-Kāşgārī, *Divānī lügati 't-türk*, arabisht-osmanisht, gjuhësi, Stamboll 1333/1915, 29x19, "Matbā'ati 'Āmire".
180. *Fjalor arabisht-osmanisht*, nuk ka fillim dhe as mbarim, 18x20.
181. Princ Duhelo, *Peyāde mektubleri*, përktheu: Ahmed Refik, osmanishte, edukatë paraushtarake, Stamboll 1315/1897-8, 18x12, "Islām ve 'Askeriye".
182. ***, *Şerh-i Sa'adüddīn Taftāzānī*, sintaksë arabe, arabisht, Stamboll 1268/1852, 20x13, "Darü 't-Tabā'ati Āmire".
183. Mehmed Eşref, *Cografyā-yı 'umūmi atlası*, osmanishte. Gjeografi, Stamboll 1325/1907, 18x11.5.
184. Mehmed Ali el-Halīmī, *Ümer ibnu 'l-Hattābi (fil-cāhiliye vel-Islām)*, arabisht, histori, pa vend botim, viti 1935, 15x12.
185. Sercan Lebok, *Idāre-i hayāt*, përktheu Mehmed 'Ali, osmanishte, Stamboll 1328/1910, 18x12, "Artīn Āsādorīyān".
186. Pol Dymmer, *Oglalarma (terbiye-i ahlākiye, siyāsiye ve icitimā'iyeye)*, osmanishte, Stamboll 1325/1907, 18x12, "Islām ve 'Askeriye".
187. ***, *Elifba*, Abetare arabe, pa vend dhe vit botimi, 22x16.
188. Rif'at Paşa, *Risāle-i ahlāk*, osmanishte, etikë, pa vit botimi, Stamboll, 16x12, "Cemāl efendi Matbā'ası".
189. ***, *Elifba osmani*, Abetare osmane, Stamboll 1303/1886, 17x12.
190. ***, *Ibretun halkiyyetun min sirti Seyyidinā Muhammed Resūlull-llāh*, arabisht, histori, Kajro 1342/1923-4, 12x10, "Matbā'ati et-Takvā".

191. Topci Husein Tayfur, *Takvīm-i ma'rifeti*, viti II, osmanishte, kronologji, Stamboll 1310/1892, 14x10, "Nişān-i Berberiyān Matbā'ası".
192. 'Ali Nezīmā, *Sunbulistān - kirāeti fārisī*, persishte, gjuhësi, Stamboll 1325/1907, 17x12, "Kasbār Matbā'ası".
193. Mustafā Beg, *Telhīsi mulehassi 'l-ilmihāl*, osmanishte, fikh, Stamboll, pa vit botimi, 18x12.5.
194. Husein Gālib, *Kāmūs-i hukūk*, osmanishte, jurisprudencë, Stamboll 1305/1888, 17.5x12.5, nuk është komplet, "Cemāl efendi Matbā'ası".
195. Mustafā Hamī Paşa, *Vezāif-i atfāl*, osmanishte, etikë, Stamboll 1312/1894, 17.5x12.5.
196. *Kurāni Kerīm*, arabisht, 24x16.
197. *Kurāni Kerīm*, arabisht, 19x11.5.
198. W. Wiesenthall, *Kāmūs fransevi-turki*, fjalor frëngjisht-turqisht, Stamboll 1895, 14x10.5, "Garabet Matbā'ası".
199. Ahmed b. Mehmed Emin Istanbuli, *Ferāidi 'l-fevāid fī beyāni 'l-akāid (āmentu şerhi)*, osmanishte, apologjetikë, pa vit dhe vend botimi, 23x15, është në gjendje jo të mirë.
200. Hasan Sirri, *Muhtasar osmanli cografyāsı*, osmanishte, gjeografi, Stamboll 1313/1895-6, 18x13, nuk është komplet.
201. Imām 'Ali el-Birgevī, *Maksūd ve Binā*, arabisht, gramatikë e gjuhës arabe, 20x14, pa vit dhe vend botimi, nuk është komplet, biblioteka: "Mulā Islām efendi".
202. ***, *Ilmihāl*, osmanishte, doracakë, Stamboll 1325/1907, 17.5x13.
203. Sālih Zekkī, *Hisāb dersleri*, osmanishte, amtematikë, Stamboll 1337, 20x14.
204. Ibrāhim Hilmi, *Cocuklar ilik cografyā*, osmanishte, gjeografi, Stamboll 1325/1907, "Mahmūd beg Matbā'ası".
205. Rif'at Paşa, *Risāle-i ahlāk*, osmanishte, etikë, Stamboll 1312/1894-5, 17x13.

206. M. Nurdaimo (?), *Felsefe-i tārīh*, përktheu Sāhibi, osmane, filozofi e historisë, Stamboll 1330/1912, 19.5x13.5, “Hürriye-i matbā’ası”.
207. ***, *Ismā’īl Şāh*, osmane, tregime, Stamboll 1301, 23x15, Pronë e Mulla Idris Hajrullahut-Gjilanit.
208. Muhamed Ruşdi b. Mustafā, *Zübdetu ‘t-ta’rifāti li ehī Çelebi*, osmane, gramatikë, pa vit dhe vend botimi, 23x15, nuk është e kompletuar.
209. Muhammed Muhyiddīn Abdulhamīd, *Et-Tühfetu ‘s-sinniyye bi şerhi el-Mukaddimetu ‘l-Acrumiye*, arabisht, gramatikë arabe, Kajro 1939, 19x13, nuk është kompletuar.
210. ***, *Elifbā osmāni*, osmanishte, doracakë/abetare, pa vit dhe vend botimi, 18x13, është e dëmtuar.
211. Mustafā b. Ibrāhim, *Tühfetu ‘l-ihvān a’le ‘l-‘Avāmili*, arabisht, gramatikë, ? 1882, 22x14, është e dëmtuar. Ka qenë pronë e Mulla Arif efendiut.
212. ***, *Mükemmel Osmānli lügati*, osmanishte, fjalor, 18x12, nuk është i kompletuar. Ka qenë në pronësi të Ali Zylfikar efendiut nga Prizreni.
213. ***, *Yeni küçük tārīhi Islām*, osmanishte, histori, Stamboll 1227/1812, 18x12.5, “Hurriyet Matbā’ası”.
214. Hāfiz Nurī, *Tecvīd*, osmanishte, rregullat e leximit të drejtë të Kuranit fisnik, Stamboll 1327/1909, 19x12, “Mertebiyyine osmaniye matbā’ası”.
215. *Xhuzi (pjesa) i 29 i Kuranit fisnik*, arabisht, 16x11.
216. Andon Dimitrov, *Mecmua-i lisāni osmānī - Turska hristomatika*, osmanishte-bullgarisht, gramatikë, Selanik 1315/1897-8, 19x13.5.
217. Kemāl Nāmik, *Küllüyyāti Kemāl (Osmanli tārīhi)*, vëllimi I, pjesa IV, osmanishte, histori, Stamboll 1326/1908, 20x13, “Mahmud Beg Matbā’ası”.
218. Ebū Ridvān – M. Sādik Vicdāni, *Tomari turuk-i ‘āliye*, osmanishte, mistikë, Stamboll 1340/1921-2, 20x14, “Matbā’a-i Āmire”.

219. ***, *Ilāveli muntehabāti lügati osmāniye*, vëllimi I, osmanishte, fjalor, Stamboll 1298/1881 16.5x11.5, është i dëmtuar dhe jo komplet.
220. Hasen Hilmī, *Mirkāti ‘akāidi vadi’a (ilmi hāl)*, osmanishte, apologjetikë islame, Stamboll 1328/1910, 18x12.5, “Ārtin Āsādorīyān”.
221. Ebu ‘l-Cezmi Hifzī, *Ma’lumāt-i fenniye ve sihiye*, osmanishte, Stamboll 1327/1909, 18x12, jo e kompletuar, “Ārtin Āsādorīyān”.
222. M. Sādik, *Hazine-i tedrisāt-i sarfī türki*, osmanishte, gjuhësi, Stamboll 1308/1890-1, 20x13, “Ālem Matbā’ası”.
223. ‘Ali Nezīmā, *T’alīm-i fārisiy*, persisht, gramatikë, Stamboll 1312/1894-5, 18x13, “Kasbār Matbā’ası”.
224. Abdullāh Efendi, *El-Muharrem*, arabishte, gramatikë, Stamboll 1277/1860-1. Ka qenë në pronësi të Mulla Ismail efendiut i cili në vitin 1285/1868 këtë libër e kishte blerë 45 groshë.
225. ***, *Ilmi terbiye-i atfāl*, përktheu Necmuddin Sādik, osmanishte, etikë, Stamboll 1333/1915, 20x14, “Matbā’a-i ‘Āmire”.
226. ***, *Lehce-i osmānī*, vëllimi I, osmanishte, gramatikë, Stamboll pa vit botimi, 19x13.5.
227. Tāhā Zāde Ümer Fārūk b. Mehmed Murād, *Tārīh-i Ebū ‘l-Fārūk*, vëllimi III, osmanishte, histori, Stamboll 1328/1910, 20x13, “Kasbār Matbā’ası”.
228. Ibn Abdullāh Muhammed b. Ismā’īl Ibrāhim el-Buhārī, *Sahihu ‘l-Buhārī*, vëllimi V, arabisht, traditë islame-Hadith, Stamboll, pa vit botimi, 27x18, “Dāru ‘t-Tabā’ati ‘Āmire”.
229. Ahmed b. Ali b. Mes’ud, *Merāhu ‘l-Ervāh*, osmanishte, gramatikë, Stamboll, pa vit botimi, 23x14.5, “Dārū ‘t-Tabā’ati ‘l-Āmire”, ka qenë në pronësi të Osman Sylejmanit.
230. Ed. Engelhard, *Devlet-i Osmāniye-nin Tārīh-i islahāti (1882-1896)*, përktheu: ‘Ali Reşād, osmanishte, histori, Stamboll 1328/1910, 24x15. 5, “Mertebiyyīne Osmāniye-i Matbā’ası”.
231. Fuzuliu, *Divān-i Fuzūlī*, persisht-osmanisht, poezi, Stamboll 1315/1897, 23x15, “Hurşīd Matbā’ası”.

232. Ümer Hilmi efendi, *Ahkāmu 'l-evkāfī*, osmanishte, jurisprudence, Stamboll 1307/1890, 19.5x13.5, "Matbā'a-i Āmire".
233. 'Ali Haydar efendi, *Düreru 'l-hukkām şerh-i mecellet-i 'l-ahkām*, vëllimi I, osmanishte, jurisprudencë, Stamboll 1314/1897, 18x12, "Āh Āsādorīyān".
234. 'Ali Haydar efendi, *Düreru 'l-hukkām şerh-i mecellet-i 'l-ahkām*, vëllimi VIII, osmanishte, jurisprudencë, Stamboll 1314/1897, 20x14, "Ālem Matbā'ası".
235. ***, *Lehce-i osmanī*, vëllimi I, osmanishte, gramatikë, Stamboll 1293/1876, 19x14. "et-Tabā'ati 'l-Āmire".
236. Ümer Rizā, *Kurān nedir?*, osmanishte, teologji, Stamboll 1927, 19.5x13.5, "Amidi Matbā'ası".
237. Ahmed Cevdet, *Vekāyā 'i Devlet-i 'Āliye-i min bekiyeti vekāyā 'i sene 1196 ilā āhiri sene 1200*, vëllimi II, osmanishte, histori, Stamboll 1292/1875, 23.5x16, në margjina ka të shënuara disa poezi të një autori anonim.
238. ***, *Terceme-i şerīf (Türkçe Kurāni kerīm)*, arabisht osmanishte, teologji, Stamboll pa vit botimi, 20x13, "Ahmed Kāmil Matbā'ası".
239. Ismā'il Hakkı Efendi, *Mevā'idu 'l-en'ām fī berāhīni akāidi 'l-Islām*, osmanishte, apologjetikë islame, Stamboll, pa vit botimi, 17x12.5.
240. Azmī, *Elifbā*, osmanishte, abetare, Stamboll 1326/1908, 20x13, "Gasbār Matbā'ası".
241. Mahmud Ekrem, *Yeni tabī'ati tedkiki ve hifzü 's-sihhati*, osmanishte, njohuri natyre dhe ruajtje e shëndetit, Stamboll 1926, "Türk Matbā'ası".
242. F. Reşāt, *Numune-i kitābet*, osmanishte, doracakë, Stamboll 1313/1895, 17x12, "Asir Matbā'ası".
243. R. Yousouf, *Grammaire complete de la lingua otomane*, frëngjisht-osmanishte, gramatikë, Stamboll 1892, 18x12.
244. ***, *Terceme-i tilmāk*, osmanishte, histori, pa vit dhe vend botimi, 18x12.

245. Hāci Andurrahmān Hilmī, përmbledhje e poezive (kasideve), arabisht, Stamboll 1320/1902, 18.5x12.5, nuk është i kompletuar.
246. La Martini, *Rafāik*, përktheu Nuri Şeydā (Şidā), osmanishte, letërsi, Stamboll 1315, 16.5x11.5, "Akdām Matbā'ası".
247. Muslihuddīn Sa'adī Şirāzī, *Gülistān*, osmanishte, poezi, Stamboll 1288/1871, 18.5x13, "Matbāa-i Āmire", Ka qenë në pronësi të Iljas begut i biri i myftiut të Prishtinës Zejnelabidinit.
248. *Sālnāme-i hāriciye-i nezāreti celiyesi*, osmanishte, Vjetar/Anuar i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Perandorisë Osmane, Stamboll 1306/1888-9, 19.5x13.
249. Gustave Le Bon, *Rūhu 'l-akvām*, përkthue Dr. Abdullāh Cevdet, osmane, filozofi, Stamboll, 1913, 19x13.
250. Mehmed Āta, *Iktizāf*, osmane, poezi, Stamboll 1322/1904, 18x12, "Āh Āsādorīyān".
251. ***, *Kāfiye*, gjuhë arabe, arabisht, Stamboll 1275/1859, 20x13, "Matbā'a-i Āmire", e dëmtuar.
252. Muslihuddīn Sa'adī Şirāzī, *Gülistān*, osmanishte, poezi, Stamboll 1304/1887, 17x12, "Matbāa-i Āmire", Ka qenë në pronësi të Mulla Eminut, nxënës në shkollën rushdije të Vushtrrisë, në vitin 1311/1893.
253. Selim Sirri, *Terbiye-i bedeniye*, osmanishte, edukatë fizike, Stamboll 1326/1908, 18x12, "Askeriye ve Islām".
254. ***, *Hikāye-i Şāh Mirān*, osmanishte, histori, Stamboll, 1292/1875, 20x11.
255. Mehmed Zihnī, *Kitābu 'l-Hacci*, osmanishte, jurisprudencë islame, Stamboll 1329/1910, 20x14.
256. Hāfiz Nurī, *Tecvīd*, osmanishte, rregullat e leximit të Kuranit fisnik, Stamboll, 1328/1910, 18x12.5, "Murtebiyyīn-i Osmāniyye".
257. 'Abdurrahmān Karābāş, *Tecvīdi Karābāş*, osmanishte, rregullat e leximit të Kuranit, Stamboll 1317/1899, 22x16, "Matbāa-i 'Āmire".
258. Hāfiz Refīk, *Tecvīd*, osmanishte, rregullat e leximit të Kuranit, Stamboll, p.v., 22x12, "Mahmud Beg Matbā'ası".

259. 'Ali Haydar, *Kosova meydān muharebesi*, osmanishte, botimi i parë, histori, Stamboll, 1328/1910, 20x11, "Matbā'ati Ebu Ziyā".
260. ***, *Musahhahi Durriyektā*, osmanishte, i dëmtuar, 18x12.
261. Ibrāhīm Hilmi, *Ğogrāfyā*, osmanishte, gjeografi, Stamboll 1325/1907, 17.5x12, "Mahmud Beg".
262. Suleymān Mursel, *Mali Ilmihāl*, boshnjakisht-arabisht, doracakë, Sarajevë 1350/1931, 22x14.5.
263. Jeyms Conor, *Mecmua-i Muhakeme*, përktheu Ragib Refki, fjalor frëngjisht-turqisht, Stamboll 1327/1329 (1909-1911), 18x12, "Sāncākçiyān Matbā'asi".
264. Jankov P. Milijopolos, *Mukalemāt*, fjalor turqisht-greqisht, greqisht-turqisht, Stamboll, 1887, 18x12.
265. Mustafā Lutfi el-Menfelūtī, *el-Ibārāt*, tregime, arabisht, Kajro, 1926, 22x15.
266. Turābī Efendi, *Divān-i Turābī*, letërsi, osmanishte, Stamboll, 1294/1877, 23x14, "Kutubhāne-i 'Āmire".
267. Necib Necātī, *Çocuklar Kirāeti*, osman, Stamboll 1316/1898, 21.5x13, "Nişāni Berberiyān Matbā'asi".
268. Feriduddīn Muhammed el-'Attārī, *Pendnāme*, osmanishte, etikë, Stamboll 1280/1863, pronë e Nezif efendiut.
269. ***, *Mecmua-i funūn*, osmanishte, Stamboll, 1281/1865, 21x13.
270. ***, *Kayseriye-i şehri*, osmanishte, histori, Stamboll 1334/1916, 23x15, e dëmtuar, "Matbā'a-i Orhāniye".
271. ***, *Bektāşi nefleri*, osmanishte, Stamboll, 1340/1921, 21x14.
272. Husein 'Akāşī, *Lügatci resmīye-i istalāhātī*, osmanishte, fjalor, Stamboll 1308/1890, "Ālem Matbā'asi".
273. Osmān efendi, *Osmānli Yūnān seferi Dumke-i meydān Mehārebesi*, osmanishte, histori, Stamboll 1314/1897, 19x13, "Āh Āsādorīyān".
274. Mehmed 'Āsim, *Ameli Kitābet*, osmanishte, stilistikë, Stamboll 1330/1912, 18x11.5, "Hayriye".
275. ***, *Eskāni Muhācirīne ve bunā memur olanların ve zaifi hakkinda izahnamedir*, osmanishte, juridike, Edrene, 1330/1912, 22x14.

Sadik Mehmeti

THE COLLECTION OF OLD BOOKS IN ORIENTAL LANGUAGES IN THE LIBRARY OF THE KOSOVA STATE ARCHIVES

(Summary)

A collection of rare/old books in Oriental languages (in Arabic, Turkish and Persian) is kept in the library of the Kosova state archives alongside a relatively large number of important documents in Oriental languages (more than 3000) and a fund of manuscripts in Oriental languages (99 manuscripts and 63 codices).

صادق محمد

مجموعة من الكتب القديمة باللغات الشرقية

في مكتبة دار الوثائق في كوسوفا

(خلاصة البحث)

الى جانب وجود عدد كبير من الوثائق المهمة باللغات الشرقية (أكثر من ٣٠٠٠ وثيقة) و وجود مجموعة من المخطوطات باللغات الشرقية (٩٩ مخطوطة في ٦٣ مجموعة مخطوطة) يخفظ بمكتبة دار الوثائق مجموعة من الكتب النادرة و القديمة باللغات الشرقية على شكل كتب مطبوعة باللغة العربية و التركية و الفارسية .


PORTRET

Genti Kruja

DR. HAXHI HAFIZ HASAN KADUKU (1865-1948), STOMATOLOGU I PARË SHQIPTAR

Hasan Kaduku lindi në Shkodër dhe ishte djali i madh nga pesë djemtë e Ismail (Mala) Kadukut, një tregtar i njohur në pazarin e qytetit në punimin e lëkurave, burrë i ndershëm, dijedashës dhe atdhetar.

Hasani ishte vëllai i madh i Haxhi Ibrahim Kadukut, i cili kreu detyra të rëndësishme në shërbim të Islamit dhe vendit të tij¹, vëllai i Riza Kadukut, funksionar në Komunitetin Mysliman në sektorin e financës, Sulejmanit (i cili posedonte kartolerinë më moderne), si dhe



¹ Haxhi Ibrahim Kaduku (1869-1949) është cilësuar si dijetari i tre kontinenteve, për arsye se shërbeu si pedagog në universitetet dhe medresetë e Stambollit, Edirnesë, Kajros, Arabisë Saudite, etj., si dhe kur u kthye në Shqipëri përfundimisht më 1925, ku u emërua drejtori i parë i Medresesë së re në lagjen Pazar, Shkodër. Më pas kreu edhe detyrën e zv/kryetarit të Komunitetit Mysliman dhe për 20 vjet deri sa ndërroi jetë më 1949 ishte myfti i rrethit Kavajë.

Hafiz Jusuf Kadukut, një prijës fetar i shkolluar si vëllezërit e tij Hasan e Ibrahim në Universitetin e Stambollit, ku njihej për komentimin e Kur'anit gjatë qëndrimit atje.

Hasan efendiu që në moshë të re shkon në Stamboll për të vazhduar shkollën, ku vendoset pranë dajës së tij Fetah Lini, ku fillon dhe punë. Atje njihet me dijetarë të kohës, nga të cilët merrte edhe mësimë mistike, si dhe filloi mësimin përmendësh të Kur'anit. Sipas kronikanit Hamdi Bushati, mësuesit e tij kishin vënë re se kishte disa probleme me dhëmbët e parë të cilët i kishin rënë dhe bënë që të mos i shqiptonte qartë shkronjat arabe me “texhvid”, të cilët duan një vokalitë shumë të pastër. Nga dashuria që kishte për Kur'anin, ai vendos fillimisht që paralel me mësimin e Kur'anit, të rregullojë edhe dhëmbët, ku u njoh edhe me profesionin e dentistit, të cilin e dashuroi menjëherë. Kështu ai i lutet dentistit të tij, që ta merrte në punë, por dentisti i thotë se nuk ka nevojë. Hafiz Hasani i thotë se, “ti nuk ke nevojë për mua, por unë kam nevojë për ty dhe jam gati të të paguaj rrogë, vetëm të rri pranë teje dhe të mësoj profesionin”, e kështu ndodhi. Më vonë fillon praktikën edhe pranë dentistit të famshëm Halid Shenazi Bej dhe më pas dhe te profesor Dionizi me kombësi armene. Pasi siguron lejen e ushtrimit të profesionit, ai kthehet në vendlindjen e tij, në Shkodër.

Kështu ai për një kohë të shkurtër rreth tre vjeçare bëhet Hafiz Kur'ani dhe dentist.

Hafiz Hasani me t'u kthyer nga Stambolli në Shkodër, fillon ushtrimin e këtij zanati, duke hapur një klinikë portative, duke shkuar në shtëpitë e atyre që kishin nevojë, siç shkonin edhe mjekët e tjerë. Por nga dëshira e madhe për profesionalizëm të plotë me t'u hapur Fakulteti i Stomatologjisë në Universitetin e Stambollit (1907), pasi punoi disa vjet si dentist diletant, në një moshë kur tashmë ishte familjar dhe me fëmijë, shkon përsëri në Stamboll, ku nga tre vjet studimi, që kishte fakulteti, ai i kryen studimet për dy vjet, favor ky që iu bëhej atyre që kishin njohuri praktike disa vjeçare. Hafiz Hasani arrin të bëhet një nga studentët më të përparuar të fakultetit, pavarësisht moshës së tij gati 40 vjeçare. Madje familjarët e tij tregojnë se edhe letrat që i

vinin nga familja nuk i hapte deri në fundjavë, për të mos u shkëputur nga mësimet.² Ai diplomohet më 1908 dhe kthehet në vendlindje si i pari mjek stomatolog, apo siç njihej ndryshe “mjek dhëmbësh” me diplomë universiteti, jo vetëm në Shkodër, por edhe në të gjithë Shqipërinë. Ai njihte gjithashtu shumë mirë arabishten, osmanishten dhe frëngjishten.

Hafiz Hasan Kaduku mbahet si njeriu që vuri bazat e shërbimit stomatologjik modern në qytetin e tij të lindjes, në Shkodër.

Kronikani Hamdi Bushati tregon se Hafiz Hasan Kaduku e ushtroi profesionin si dentist në disa qytete të Shqipërisë dhe në Mal të Zi. Kronikat e asaj kohe tregojnë që Hasan Kaduku, me zotësinë e një dentisti të talentuar, tërhoqi vëmendjen e të gjithë bashkëqytetarëve të tij, duke krijuar një klientelë të gjerë edhe jashtë kufijve të vendit, si p.sh. në Mal të Zi. Të gjithë konsujt e huajt që ishin të akredituar në Shkodër, si dhe personalitete të viseve të tjera të vendit, kishin si dentist (apo siç quhej atëherë mjek dhëmbësh) të tyre Hafiz Hasan Kadukun. Shkodra në fillim të shekullit XX, duke qenë një prej pikave më perëndimore të Perandorisë Osmane, kishte pesë konsullata të huaja, personeli i të cilëve bëheshin shpeshherë pacientë të Hafiz Hasanit.

Hafiz dr. Hasan Kaduku ua la trashëgim profesionin e tij pinjollëve të tjerë të familjes, e cila në atë kohë ishte një ndër më të njohurat në Shkodër. Haki Kaduku³, djali i dentistit të parë shqiptar, pasi kreu gjimnazin në Austri dhe fakultetin e stomatologjisë në Stamboll, u kthye në Shkodër. Ai vijoi profesionin e të atit, duke punuar kështu bashkë. Derisa doli në pension, Hakiu, djali i Hasan Kadukut, punoi si dentist në poliklinikën e qytetit të Shkodrës. Ai ishte një mjek i cili i kushtonte një rëndësi të madhe edukimit të rinisë për përkujdesjen shëndetësore. Haki Kaduku mbante biseda për përkujdesjen ndaj dhëmbëve në shkollat e shtetit të të gjitha niveleve.

² Kaduku, Hasan (nip i Hafiz Hasanit), dorëshkrim, 2012.

³ Haki Kaduku (1900-1978).

Tradita e familjes Kaduku vazhdon me të tjerë emra. Qamurani djali i Hakiut dhe nipi i Hafiz Hasanit, është brezi i tretë i dhëmbëtarëve të kësaj familjeje. Ndërsa Hasan Haki Kaduku, nipi i Hafiz Hasanit ka ushtruar profesionin e profesorit të matematikës në shkollat e qytetit. Ndërsa Mesereti, njëra nga vajzat e Haki Kadukut, ashtu si vëllai i vet arsimtare në matematikë, do të vinte bazat e matematikës për shumë vite në Medresenë “Haxhi Sheh Shamia” në Shkodër.

Studiuesi Osman Hoxha e përshkruan kështu figurën e Hasan Kadukut: “Njeri madhështor, shtatlartë e shpatullgjerë, syshqiponjë e hundëshkabë, me mjekër të bardhë dhe shumë i pashëm, fisnik dhe zemërgjerë, i respektuar dhe mendjemprehtë, energjik dhe i papërkullur, i dashur e bujar, ishte gjithmonë mes njerëzve, që e donin dhe i donte aq shumë. Ishte i punës por dhe i pushkës. Në kohën e rrethimit të Shkodrës nga malazetët në vitet 1912-1913, Hafiz Hasan Kadukun e gjejmë të rreshtuar në llogore përkrah vullnetarëve të tjerë, duke kryer detyrën ndaj atdheut.

Në vitin 1932 kreu edhe ritualin e Haxhit. E tashmë njerëzit e njihnin si Dr. Haxhi Hafiz Hasan ef. Kaduku.”

Shprehja “po shkoj te Kaduku”, më shumë se prej një shekulli në Shkodër nënkupton “po shkoj te dentisti”.

Klinika e famshme dentare “Kaduku”, në vitin 1948 do të sekuestrohej e gjitha nga shteti, duke bërë kështu që shumë klinika shtetërore për stomatologji në Shkodër dhe Tiranë, të hapeshin me veglat e shtetizuarra të dr. Kadukut.

Klinika e Hafiz Hasanit ndodhej në pikëtakimin e lagjeve të vjetra myslimane dhe katolike, e cila shërbeu kështu edhe si një busull afrimi mes dy besimeve, sepse klientët ishin nga të dyja lagjet.

Shenjë e tolerancës është edhe një fakt interesant ku revista katolike e kohës “Elçija e Zembrës s’Krishtit”, e vitit 1906 (vjeta XVI, Dhetuer, 1906, nr.12), boton një reklamë interesante të Hafiz Hasan Kadukut, i cili i fton klientët që të mbushin apo të venë proteza dhëmbësh në klinikën e tij dhe paratë mund t’i paguajnë më vonë, pasi ata të jenë mësuar me protezat apo mbushjet dhe të jenë të kënaqur prej tyre.

Hafiz Hasan Kaduku ishte intelektual i plotësuar për kohën, ndaj dhe gëzonte respektin e banorëve të qytetit. Ai vishej me shije dhe ishte i dashur si me pacientët, ashtu dhe me shoqërinë që e kishte të shumtë. Paradhoma ku prisnin pacientët ishte e akomoduar mirë dhe e pajisur me libra dhe revista, madje aty kishte edhe libra për fëmijë apo ndonjë lodër.

Kultura e tij e gjerë bënte që ai të vizitohej edhe nga klerikë të lartë katolikë, si Gjergj Fishta, Ndre Mjeda, Anton Harapi etj.

Madje Fishta i kishte kushtuar Hafiz Hasan Kadukut edhe këto vargje, të cilat tregojnë se ai ishte mjekuar te mjeku i shquar stomatolog:

“Asnjëherë s’jam përkulë

As prej shkjaut e as dhe ukut

Por rri urtë e bahem pulë

Te karrigia e Kadukut”⁴

I biri i tij, dr. Haki Kaduku, tregon se dr. Hasani ishte i pari që përdori floririn në mbushjen e dhëmbëve. Ai përdorte një peshore precize të farmacistëve, për të racionuar sasinë e arit për punimet e veçanta.

Kur mosha bëri të veten, Hafiz Hasani vetë kaloi në laborator dhe Hakiu në klinikë. Ai ishte i pari që mbajti korrespondencë me një firmë londineze (A.SH. & Sons), nga ku ka porositur edhe klinikën e tij, të cilën e ka pasur me qira në shtëpi të ndryshme shkodrane, njëra prej të cilave është fotografuar edhe nga Marubi.

Studiuesi i njohur, profesor Gëzim Uruçi, në dosjen e tij “Personalitete të shquara në memorien e malësorëve tanë”⁵, (Haxhi Dr. efendi Kaduku dhe kroni i Kadukut në fshatin Theth të Dukagjinit), na njeh me shumë histori, episode dhe toponime që hapin një faqe të re shumë interesante për figurën e Hasan Kadukut. Lidhur me këtë ka shkruar edhe dr. Musa Bizaku, duke bërë një monografi për brezninë Kaduku.

⁴ Bizaku, Dr. Musa, Vol. XII, “Historiku i Dhëmbëtarëve në Shkodër” (Breznia Kaduku), Monografi, Shkodër, 2006: 25.

⁵ Uruçi, Gëzim, “Personalitete të shquara në memorien e malësorëve tanë”, (Haxhi Dr. efendi Kaduku dhe kroni i Kadukut në fshatin Theth të Dukagjinit), Shkodër, 1985: 127.

Hafiz Hasani ishte ndër të parët pushues dhe i pari mysliman që veroi në fshatin turistik të Thethit që nga viti 1936, i ftuar fillimisht nga bajraktari i zonës i cili ishte edhe klient i tij.

Dr. Hasani i mahnitur nga bukuritë dhe ujërat e Thethit, mendon t’i bëjë një shërbim humanitar Thethit, një nxitje për emancipim, duke bërë një marrëveshje të firmosur nga vetë ai dhe lënë shenjat e gishtërinjve nga bajraktari i Shoshit. Ai ndërtoi depozitën e parë të ujit duke hapur kanale në drejtim të tre kullave kryesore aty pranë. Për këtë arsye, të futjes së ujit në disa shtëpi për herë të parë, që nga ajo ditë ai krua quhet “Kroni i Kadukut”. Kështu krahas kësaj hynë edhe toponime të reja “Livadhi i Kadukut”, “Bajrakja e Kadukut” etj. Ai i ftoi gjithashtu thethianët që të vinin dhe t’i kuronin dhëmbët falas në klinikën e tij në Shkodër. Gjatë qëndrimit në bjeshkët e Thethit ai mbli-dhte dhe përpunonte shumë bimë mjekësore, duke njohur vlerat e tyre për kurimin e shumë sëmundjeve evidente në këtë zonë.

Dr. Hasani, sipas dëshmisë së Lulash Markut, fshatar i zonës, ishte bërë shumë i vizituar nga malësorët e zonës, madje ai u lexonte edhe letrat që u vinin atyre me kënaqësi.

Hafiz Dr. Hasan Kaduku kuroi e mjekoi gjatë jetës së tij krajla, princa, konsuj, priftërinj, diplomatë e njerëz të thjeshtë. Në karrigen e tij u ulën gjithashtu njerëz të shumë kombësive.

Dr. Frederik Shiroka do ta quante Haxhi Hafiz Dr. Hasan Efendi Kadukun “Legjendë e stomatologjisë shqiptare”.⁶

Marrë nga:

(Revista “Drita Islame”, Shtator 2012)

⁶ Bizaku, Dr. Musa, Vol. XII, “Historiku i Dhëmbëtarëve në Shkodër” (Breznia Kaduku), Monografi, Shkodër, 2006: 8.

Genti Kruja

DR. HAXHI HAFIZ HASAN KADUKU (1865-1948)
FIRST ALBANIAN DENTIST

(Summary)

Hasan Kaduku was born in Shkodra. He was the oldest of 5 sons of Ismail (Mala) Kaduku, who was a distinguished merchant in the city market, a man of honor, very fond of knowledge and a great patriot.

غينتي كرويا

د . الحاج حافظ حسن كادوكو (١٨٦٥-١٩٤٨)

أول طبيب أسنان الباني

(خلاصة البحث)

ولد حسن كادوكو بمدينة شكودرا و هو أكبر ابن من خمسة أبناء لاسماعيل (مالا) كادوكو احد التجار المعروفين في سوق المدينة و اشتهر في أعمال التجليد و كان رجلا كريما و محبا للعلم و مشهورا بوطنيته .

Muhammedi të kërkojë vende të tjera për prezantimin dhe shtrirjen e ideve të tij.²

Emërtimi i lëvizjes

Bota myslimane jashtëvehabiste këtë lëvizje e njeh me emrin vehabinj, vehabistët (el-vehabijeh), sipas emrit të themeluesit, mirëpo pasuesit e kësaj lëvizjeje e refuzojnë një emërtim të tillë, duke e arsyetuar se ata janë kundër kultit të personalitetit dhe se nuk duan të lidhen me emrat njerëzorë. Nga ana tjetër, bota intelektuale dhe politike ka disa emërtime për vehabinjtë. Për shembull, hereziografi francez Henry Laoust i quan “*reformatorë ortodoksë*”³, kurse Aziz Ahmedi nga India i quan “*fundamentalistë teorikë*”.⁴ Intelektuali mysliman, Muhammed Ikbali, lëvizjen vehabiste e quan “*vezullim të parë të mirëfilltë të jetës moderne islame*”⁵, kurse Mekdonald vendin e shfaqjes e quan si “*vendin më të pastër në botën dekadente islame*.”⁶ Husein Gjozo, duke e analizuar ekzistimin e kësaj lëvizjeje pohon se fillimi i tyre është korrekt, por për vazhdimin e tyre thotë se “*duket se bartësit e vehabizmit, nuk ishin në nivel të misionit të tyre aq kompleks*.”⁷ Vetë vehabistët, preferojnë të quhen *muvehhidunë* (unitaritet, njësuës) dhe pasues të ehli-s-sunetit dhe xhematit, përkatësisht pasues të hanbelizmit. Mirëpo, përkundër këmbënguljes së tyre, shi’izmi, sufizmi dhe grupe të tjera i quajnë vehabinjë, sipas parimit të përgjithshëm: edhe mu’tezilitët, edhe harixhitët, edhe murxhitët, edhe hanefistët, edhe shafi’itët, nuk e quajten veten kështu, por ashtu u quajten nga të tjerët dhe se emërtimi i tyre nuk ndikoi në

AKTUALITETE

Nexhat Ibrahim

LËVIZJA TRADICIONALISTE VEHABISTE APO THIRRJA E MUHAMMED IBN ABDULVEHHABIT

Hyrje

Tradicionalistët islamë apo selefinjtë¹ janë lëvizje që lindi si rezultat i mësimi dhe veprimi të reformatorit nga gadishulli arab, shejh Muhammed ibn Abdulvehhab (1703-1787). U lind në Ujejne, afër Rijadit, krahina e Nexhdit, nga një familje autoritative, që i përkiste medhhebit hanbelist. Babai i tij ishte gjykatës në qytetin e tij. Edhe i vëllai, Sulejmani ishte me përgatitje fetare. Më vonë pas kthimit të Muhammedit nga Iraku, Irani e vendet tjera, edhe babai edhe i vëllai iu kundërvunë Muhammedit në idetë e tij të skajshme, që ndikoi që

¹ Kuptimi bazë është: Pararendësit, të parët, selefinjtë. Këta janë brezi i parë i muslimanëve, i cili nga të tjerët konsiderohej si burim i praktikës dhe i udhëzimit islam. Këta mendojnë se pikëpamjet, vendimet dhe interpretimet duhet të mbështeten në brezin e parë. Selef quhet brezi i dijetarëve që fillon me as’habët dhe përfundon me tebei-tabinët, apo me Muhammed ibn Hasen Esh-Shejbaniun. Ky grup e komenton jashtësinë e teksteve dhe refuzon të japë mendim dhe të interpretojë brendinë e tyre. Sipas: Nexhat Ibrahim, Leksikoni islam, botimi 3, Logos-A, Shkup, 2012.

² Nexhat Ibrahim, Zhvillimi i sekteve në historinë e mendimit islam, Tetovë, 2007, fq. 122 e tutje.

³ Fikret Karcic, Drustveno pravni aspekt islamskog reformizma, Sarajevë, 1990, fq. 106.

⁴ A. Ahmed, Islamic Modernism in India..., fq. 261, sipas F. Karcic, fq. 261.

⁵ Muhammed Ikbali, Ripërtëritja e mendimit fetar në Islam, Logos-A, Shkup, 2008, fq. 198.

⁶ M. Ikbali, po aty, fq. 198.

⁷ Husein Gjozo, fetve, Novi Pazar, 1996, fq. 492.

pëlqyeshmëri apo jopëlqyeshmëri, por në këtë ndikuan shumë faktorë, e sidomos doktrina dhe veprimet e tyre.

Doktrina e lëvizjes

paraqesin kontingjentin e parë e të papërshtueshëm, që nuk po iu dihet fundi dhe ende po e presim liberalizimin e vizave që të shkojnë edhe të tjerët. Vetëm ne që e kemi përjetuar këtë fat në diasporë, kurbet (mërgim) e dimë sa vështirë është, por njeriu është më i fortë se guri, që do të thotë se është shumë vështirë vetëm ta përkujtosh. Për këtë shkak, unë Ramadan Gara, medresant i Medresesë së Mesme “Alaudin” në Prishtinë, nga fshati Kizharekë, Komuna e Drenasit, iu kam përkushtuar kësaj teme, sepse vetë e kam përjetuar si një lloj vështirësi në jetë, por edhe sot e kam një kujtesë dhe brengë të hidhur që pasardhësit tanë po e përjetojnë këtë fat – fatkeqësi që po na përcjell neve shqiptarëve të mjerë në përgjithësi. Unë, me disa shokë të mi të cilët do të përmenden në vijim ishim të angazhuar me një bashkëpunim dhe njëherësh themelues të këtij Komuniteti humanitar, i cili kishite bërë aktivitete të ndryshme, si p.sh. në vitin 1975, për organizimin dhe ndarjen nga një pagë mujore për ndërtimin e shkollave shqipe në Kosovë, të cilën në atë kohë e kishte marrë aksion vullnetar Qeveria dhe Ministria e Arsimit të Kosovës. Në këtë angazhim, si aktivist të dalluar kanë qenë Mulla Osman Beqa nga Shtrubullova e Drenasit, Shaban Berisha nga fshati Kizharekë (tash jeton në fshatin Ramon të Komunës së Pejës). Aktivitet tjetër ka qenë edhe organizimi i faljes së teravive, ndërsa xhemat kishte edhe nga komuniteti boshnjak. Teravitë janë falur nëpër vende ku ka pasur komunitet mysliman, si p.sh. në Ndërmarrjen Ndërtimore “Vranica” të Sarajevës në Kroaci, në vendin e quajtur barakat e Vranicës, në Ndërmarrjen Ndërtimore “Industrogrdnja”, në vendin Zaprugje. Derisa është hapur Xhamia e Re e Zagrebit, vlen ta përmendim edhe të ndjerin prof. Ahmet Berishën, i cili na ka inkurajuar dhe na ka bërë nder shumë të madh që ka ardhur si imam për Ramazan dhe ka ligjëruar në katër gjuhë: gjuhën arabe, boshnjake, shqipe por edhe në gjuhën turke. Për ne shqiptarët ka qenë nderi më i madh për ato katër dekada, ndërkaq Ahmet Berisha ka pasur një privilegj dhe autoritet të veçantë të Bashkësisë Islame të Kroacisë. Ne shokët që punonim në Zagreb, iu bashkoheshim atyre dhe tërë natën nuk venim gjumë në sy meqë ishim shumë të përmalluar. I ndjeri, Ahmeti, ka ardhur shumë herë, kurse respekt të madh ka pasur

për të ndjerin dr. Sylejman Mashoviqin. Gjithashtu e kemi bërë edhe këndimin e mevludeve, mbajtjen e ligjëratave fetare dhe edukatën islame dhe gjithashtu jemi munduar t'i mësojmë shokët tanë, duke filluar nga mësimi i shtyllës së parë islame, shehadeti dhe disa sure dhe si të falet namazi sa për fillim, dhe kështu e kemi mbajtur një unitet edhe kombëtar dhe fetar.

Duke filluar prej Kur'anit famëlartë si p.sh. "Inne'd-dine inda'-Allahil-Islam, Amene resulu, ve unzile ilejhi min Rabihi", Kulu amene Bil-lahi ve ma unzile ilejna ala Ibrahim ve Ismaile ve Ishaka ve Jakube vel esbat ve Mus ve Isa ve... kryerjen e trajnimit me temën "Marrëdhëniet ndërfitare, njerëzore, shpirtërore, kombëtare", si p.sh. "Klubi romak për tolerancë" ose "Toleranca është pragu i paqes" nga Shopen Hauve për mirëkuptim ndërnacional dhe ndëregjional dhe bashkëkohor sepse na është deshur të dimë se si të gjendemi në mjedisin ku kemi mbijetuar me dekada me pjesëmarrje të shumtë vetëm e vetëm për t'ia siguruar familjes kafshatën e bukës. Në atë ditë mbledhja ka filluar me një Ashere të Kur'anit, që e ka kënduar Hafuz Mevludini. Në këtë xhami, për hir të ne kosovarëve, në sallën më të madhe që posedon, kemi mbajtur disa mbledhje, si zakonisht kur ka qenë edhe zotëri Ramush Tahiri, si përfaqësues dhe udhëheqës me gazetarrët mërgimtarë në Kroaci, që vlen ta përmendim si zonjën Nadire Avdiq Vllasin, që ka punuar si redaktore apo si gazetare në gazetën "Vjesnik" të Zagrebit dhe na ka përkrahur në çdo aspekt dhe të gjithë e kemi respektuar si një mikeshë-motër e gjithë shqiptarëve anëmbanë botës. Në këtë mbledhje, në vitin 1992, kanë marrë pjesë edhe një numër katolikësh që kanë pasur përgjegjësitë e veta për kombin shqiptar. Ky komunitet bashkëpunoi edhe me studentët në klubin shqiptar "Shkëndija" "Kaptoll 6" në Zagreb, Kroaci dhe me ish-studentët që studionin bashkë, si p.sh., Shaban Hasi, tash doktor i shquar, Fatos Morina, tash doktor ortoped i dalluar, Gani Halilaj, Sadik Zekaj e Xhevat Podrimqaku, sot magjistër ose dr. në Ministrinë e Punëve të Brendshme në Kosovë, e shumë të tjerë kombëtarë shqiptarë të krishterë në Zagreb si p.sh. gjeneralkolonel Tomë Berisha, gjeneral Naim Maloku me vëllezërit Kuzmini, Simoni dhe Mikeli e Martin Krasniqi

etj. Qysh në protestat e Zagrebit si dhe organizimin e mjeteve "Vendlindja Thërret" dhe Unioni i bashkësive Shqiptare në Republikën e Kroacisë, të cilën ka qenë z. Riza Hoxha, sekretar, që jam takuar për herë të dytë në vitin 2011 në zyrat e këtij Unioni. Kontributin për ndihmën e dezertimeve të ushtarëve shqiptarë nga Ushtria Jugosllave dhe për dërgimin e literaturës si "Informatori" që ishte mjaft i popullarizuar në atë kohë nga Kroacia dhe shumë i rrezikshëm për ta bartur nga Kroacia për në Kosovë dhe për UÇK-në, si ndihma të para me barna mjekësore, veshmbathje e anasjelltas.....për furnizimin me literaturë islame nga Kosova për në Kroaci dhe për botën perëndimore si p.sh. "Edukata Islame", "Dituria Islame", Kuranët e parë në tërësi përkthyer nga dr. Feti Mehdiu dhe Kur'ani dhe Hija e Tij, Kur'ani i Sherif Ahmetit – 60 copë dhe afro 700 copë të revistës "Dituria Islame".

Vlen të përmendet edhe kryetari i atëhershëm H. Jetish Bajrami për përkrahjen dhe autorizimin që ma ka besuar në atë kohë aq të vështirë pa kurrfarë dyshimi dhe unë e kam kryer në atë kohë.

Madje, së fundit unë jam arrestuar në Kralevë, me një numër 50 copë të revistës "Dituria Islame" për shkak se në atë kohë edhe "Dituria..." ka luajtur një rol të veçantë për guximin që e ka pasur për ta botuar ashtu si ishte realiteti, edhe pse jemi munduar pak për t'i ndihmuar kësaj popullate, ky komunitet ka bërë aktivitete për grumbullimin e mjeteve nga një pagë mujore për ndërtimin e shkollave të reja në Kosovë, në vitin 1975, me bashkëpunëtorët si Shaban Berishën nga fshati Kizharekë, të Komunës së Drenasit, i cili tani banon në fshatin Ramun, të Komunës së Pejës, Nazif Haxhiu nga fshati Poklek, të Komunës së Drenasit, i ndjeri mulla Osman Beqa nga fshati Shtrubullovo të Drenasit, Isa Hajrizi nga i njëjti fshat, Nasuf Bytyqi nga fshati Damanek të Drenasit etj.

Ky komitet ka fituar "Çimin e Nderit" (Fazlur Rahman) „EMIN” nga Xhamia e Zagrebit, si njerëz të besueshëm, si p.sh. në besimin dhe ruajtjen e të hollave të panumëruara "SERGIA" dhe kthimin e të hollave të vitrave, të cilat ishin 10 mijë DM, që nuk i pranoi nga Xhamia e Zagrebit asnjë punëtor shqiptar, duke thënë se "unë nuk i pranoi vitrat sepse e ndjej veten si i pasur dhe kam rrogën time të cilën e fitoj

me djersë”. Prej kësaj dite shqiptarët kanë gëzuar autoritet të lartë në MESHIHATIN e Bashkësisë Islame të Zagrebit, që e udhëhoqi myftiu mr. Shefko Omerbashiq dhe bashkëpunëtori i tij prof.dr. Sylejman Mashoviq dhe kryeimami i Xhamisë së Zagrebit në atë kohë dr. Mustafa Ceriq dhe Azis Hasanoviq, për hir të autoritetit të tij të lartë që kam pasur ndaj të ndjerit prof. dr. Sylejman Mashoviqit, unë Ramadan Gara e kam marrë iniciativën dhe investuar përkthimin e librit të tij “ISLAMSKA GLEDIŠTA” (PIKËPAMJET ISLAME), të cilën kryemyftiu Sefko Omerbašić, z. Mirasd Srebernikoviq dhe zotëri Pliqanin më përkrahën me lejen e përkthimit. Xhamia e re e Zagrebit, e cila është ndërtuar pas shumë përpjekjeve dhe u arrit vendimi që të ndërtohet në Zagreb të Ri në vendin Folnegoviqev Gavelina p.n. më datën 11.9.1981, me një përkrahje të gjithë xhematit dhe gjithashtu me ndihmën e Republikës Kroate të asaj kohe. Kështu që Bashkësia Islame i ka angazhuar edhe arkitektët më të mirë në Bosnjë dhe në Kroaci, të cilët e projektuan Xhaminë madhështore që paraqet sintezën e arkitekturës shekullore islame dhe perëndimore, si specifike me minaren më të lartë në Evropë, sipas rekomandimeve të Ligës Botërore Islame “Rabita” dhe seksionit të saj për xhami në Evropë dhe është ndërtuar si Qendër Islame bashkëkohore, që duhet t’i përmbushë nevojat jo vetëm të një kryeqyteti, siç është Zagrebi, por të myslimanëve të shpërndarë në hapësirat e gjera të Botës së Re. Krahas ndërtimit për ibadete (adhurime) xhamia është edhe për mbajtjen e mësim-besimeve dhe edukimeve islame dhe i ka dy salla të mëdha për simpoziume shkencore islame, si p.sh. për garuesit e Kur’anit etj.

Me rastin hapjes së Xhamisë së Re më datën 16.9.1987 dhe gjatë këtyre gjashtë vjetëve në këtë xhami kanë kontribuar edhe shqiptarë e sidomos ata nga Maqedonia, që jetojnë më shumë se një shekull kur i ka detyruar me dhunë të shpërngulen nga Jugosllavia e Vjetër e Krajl Petrit për në Kroaci, si një realitet që gëzojnë një autoritet të lartë në këto treva të Kroacisë, në jetën kulturore dhe atë kombëtare dhe fetare që është vështirë të gjejë shokë të cilët neve shqiptarëve nga Kosova na u kanë gjetur në kohët më të vështira. Mirëpo, edhe ne kosovarët në atë kohë kemi qenë një numër shumë i madh afro 60 mijë që iu

kemi ndihmuar muhaxhirëve – refugjatëve boshnjakë si për strehim, po ashtu edhe për ushqim dhe veshmbathje etj. Sepse e kemi pasur një zonë mjaft të ndjeshme “Samo za Kalesiju” më të rrezikshëm që nuk kemi guxuar të shpërndajmë asnjë gjë tjetërkund.

Por, edhe nga ana e Komunitetit Boshnjak Mysliman kemi qenë shumë të privilegjuar në çdo aspekt, si atë moral dhe financiar. Kështu që, duke falënderuar këtë kryesi dhe tërë stafin e kësaj Bashkësie Islame të Zagrebit, e në veçanti Hafiz Mevludin, i cili atëherë ishte hatib-imam dhe këndonte mukabele, kurse tash ishte drejtor i Gjinnazit Islamik “Ahmet Smajlovic”, z. Muzaferin dhe Muharrem Xhaferin nga Reçica e Tetovës dhe Abdurrahimin nga Tetova, tash së fundi ka ardhur hafiz Aziz Alili, si kryeimam, ku për këtë njeri mund të themi se na e ka dërguar Zoti si dhuratë neve shqiptarëve me atë moral të lartë dhe me një zë të ëmbël dhe të fuqishëm edhe si kryeimam në këtë xhami të Zagrebit edhe alim i aftë në çdo aspekt me tipare njerëzore dhe edukatë të jashtëzakonshme, siç i ka hije një njeriu të shekullit XXI.

Kështu, ne si komunitet jemi si krenari e tërë kombit shqiptar. Ne si komunitet iu kemi bashkangjitur në ndihmën e kësaj xhamie gjatë kohës së hapjes solemne, të cilës iu kemi dhuruar afro 100 mëditje për parapërgatitjen e këtij objekti aq të çmuar për tërë Evropën, që shumëkush e quan Bukuroshja e Evropës, sepse është më modernja në Evropë.

Dhe tash së fundi, ishte shumë kënaqësi e veçantë që e gjeta në krye të detyrës të kryeimamit hafiz Aziz Alilin dhe një pamje të mrekullueshme që ia kishin lakmi i tërë xhemati.

Unë, Ramadan Gara, i punësuar në dy ndërmarrje ndërtimore “Gik Zagorje” dhe “Industrogradnja” në Kroaci, prej vitit 1966 deri në vitin 1993 që kam dalë në pension dhe kam vizituar Zagrebin disa herë e tash si vizitor pas dy dekadave që ia bëra kësaj bashkësie për afro një muaj më bëri shumë përshtypje veprimtaria e komunitetit shqiptar dhe autoriteti i tyre që e kishin arritur me punën e tyre të palodhshme. Dhe me këtë e kuptova se vetëm me punë edhe me qëndrim të sinqertë një pakicë e komunitetit në një vend tjetër mund të arrijë këtë autoritet.

Ishte një kënaqësi dhe privilegj shumë i madh për mua edhe për ne shqiptarët nga Kosova, që na kishin rënë hise këta hafizë dhe mualimë (dijetarë) si në jetën shpirtërore edhe në atë kombëtare dhe i lutem të madhit Zot që t'u japë fuqinë dhe dijen në jetën e mëtejshme. Një dijetar islam ka thënë se "kur njeriu ka shumë tipare të mira që ua ka dhënë dhuratë Zoti dhe natyra". Ky komunitet është marrë edhe me organizimin e tubimit të të hollave nga Bashkësia Islame e Zagrebit, e cila në veçanti me përkrahje morale dhe financiare shumë më të madhe të hollave nga "Sergija" për ndërtimin e Xhamisë 6000 DM na ka dhuruar për rindërtimin e xhamisë të fshatit Kizharekë të Komunës së Drenasit dhe bashkatdhetarët e këtij komuniteti në tërësi 3000 DM. Ky komunitet ka ndihmuar edhe për ndërtimin e xhamisë që kjo xhami të rindërtohet në fshatin Vërmicë të Komunës së Malishevës dhe xhamisë në Podujevë, si edhe për dezertimin e ushtarëve shqiptarë nga Armata Popullore Jugosllave, të cilët i kemi strehuar nëpër banesa me muaj të tërë derisa kanë gjetur mundësi për të depërtuar në Kosovë.

Ky komunitet i ka pasur edhe qëndrimet e veta të veçanta për tolerancë dhe mirëkuptim ndërnacional, ndërfetar dhe ndërnjerëzor, e sidomos gjatë luftës serbo-slllovene, serbo-kroate, serbo-boshnjake – myslimane të vitit 1990 e më pas.

Pas vdekjes së mr. Sahit Dragusha në vitin 1986, unë R. Gara e kam vazhduar këtë veprimtari, e cila ende vazhdon. Si veprimtarë të këtij komuniteti kanë qenë më të dalluarit në shumë aspekte, Mulla Osman Beqa nga Shtrubulova (që e ka kryer medresenë në Gjakovë, dhe si i burgosur politik dhe i përndjekur që ka ardhur në Kroaci, dhe ka punuar si punëtor fizik deri në pension, që pas një kohe të shkurtër ka ndërruar jetë në vendlindje), Isa Hajrizi si myezin, që me ka përkrahur deri në fund në këtë organizim për afro katër dekada dhe sot e kësaj dite jemi në veprim, por me një intensitet më të vogël për shkak se kanë vërshuar shumë parti, që janë zhytur në lakmi të ndryshme që është shumë turp t'iu jepet një kuptim i saktë, se çfarë po kërkojnë tash mbas këtyre shumë sakrificave që i dha ky popull me luftën e UÇK-së.

Ky komunitet i ka pasur edhe specifikat e veçanta në krahasim më të tjerat si p.sh. bashkëpunimin me të tjerët, si me besimtarët e krishterë, si ata ateistë, që asnjëherë nuk kemi pasur polemika, por mirëkuptim të plotë si me ata hebraikë, si p.sh. me veprimtarinë "Slobodan Lang", e cila na u ka bashkangjitur në protestat e Zagrebit në atë kohë dhe me komunitetin boshnjak, që kemi organizuar bashkë faljen e teravive në atë kohë afro 8 vjet para se të ndërtohej Xhamia e re në Zagreb, dhe në rastet urgjente ka marrë aksione të veçanta, si p.sh. kur ka ndërruar jetë një shok i yni i quajtur Haxhi Ibriqi nga Komorani i Drenasit, i cili ka vdekur në spitalin e quajtur „Rebro" të Zagrebit, të cilin e kemi vizituar shumë shokë deri në fund të jetës, i cili ka qenë i martuar me një grua ateiste dhe të droguar, e cila asnjëherë nuk e ka vizituar në spital kur i ndjeri ka vuajtur nga kanceri, ndërkaq kur ka ardhur koha për t'ia marrë shpenzimet e varrimit ka vrapuar dhe ka tentuar ta varrosë pa e pyetur askënd nga familja e ngushtë e të ndjerit e as neve shokëve më të afërt, por ne nuk e kemi lejuar atë dhe e kemi nxjerrë nga morgu, e kemi dërguar në Xhaminë e Zagrebit dhe ia kemi bërë ceremoninë sipas rregullave të Sheriatit, ia kemi falur xhenazen dhe ia kemi bërë amanetet e të ndjerit duke e falënderuar shumë Mulla Osman Beqen, që është angazhuar më së shumti. Osman Beqa ishte këmbëngulës për çdo të padrejtë që na u bënte në çdo lëmi. Krahas tij ishte dhe Nazif Haxhija, Shaban Berisha, Nasuf Bytyqi, Xhevat Podrimqaku, nga ana tjetër gjeneral Tomë Berisha me oficerët që e kanë dhënë kontributin e jashtëzakonshëm, vëllezërit Kuzmini e shumë e shumë të tjerë.

Ky komunitet është shtrirë edhe në Evropë, se një numër shumë i madh ka dalë në Perëndim nga Kroacia dhe Sllovenia, dhe një pjesë e bijve tanë tash veç janë në Perëndim dhe kështu që është shumë e vërtetë se i kemi lidhjet e forta me ta, duam apo nuk duam, se edhe në kohën para ose pas luftës na kanë lidhur po të njëjtat interesa si p.sh. lëvizja që ka qenë si një veprimtari e përbashkët "Vendlindja Thërret Studentët në Veprimtarinë e Tyre" dhe kush më shumë e kush më pak, të gjithë kemi pasur një qëllim që na ndihmoi i Madh Zot e jemi

këtu ku jemi, në Liri dhe Pavarësi, që po gëzojmë sot të lirë e të pavarur.

Këta persona kanë qenë të dalluar, por jo vetëm këta por shumë njerëz të cilët kanë dhanë një kontribut të veçantë në shumë aspekte, që duhet të cekem me një përkushtim të veçantë dhe studim të mirëfilltë, që në të ardhmen do t'i mbledhë dëshmitë e sakta dhe veprimtaritë e shumta që na ka sjellë si para lufte ashtu edhe pas lufte. Madje, edhe kjo veprimtari e jona e ka zanafillën prej tyre si komunitet edhe pas vitit 1963. Kemi vazhduar të marrim edhe veprime të ndryshme, si p.sh., në kohët e dhura kemi bashkëpunuar me Këshillin e Arsimit në Fshat, si përgjegjës në Këshillin e Prindërve dhe në kohën e luftës për hapjen e shkollës në Malet e Berishës me arsimtarët e nderuar që kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm, si në guximin për hapjen e shkollës, po ashtu edhe mbajtjen e mësimëve dhe rregullave shkollore edhe në ato kohë shumë të vështira, si një trup i përbashkët me këta prindër që na kanë përkrahur në çdo aspekt, se pa ndihmën e këtyre njerëzve të devotshëm as që kishim mundur me t'u dalim në ballë këtyre vështirësive që i tejkaluam disi. Edhe sot e kësaj dite jemi në angazhime por më pak për shkak të rrethanave që po na pengojnë nganjëherë. E tash së fundi, ne si prindër jemi të angazhuar me Këshillin e Prindërve dhe jemi shumë të kënaqur me ata arsimtarë të devotshëm ashtu si i ka hije një kombi të pasluftës. Sepse, edhe para lufte arsimtarët e kësaj shkolle kanë kontribuar pa pagesë, duke dhënë mësim gjithnjë.

Gjatë kohës së luftës kemi bashkëpunuar edhe me UÇK-në, si në rastet e emergjencës për organizimin e fhënies në disponim Xhaminë për Shtabin e UÇK-së., hapjen e istikameve për ndihmën e përgatitjes së vendit të antenës së Radio Kosovës së Lirë dhe për furnizimin e banorëve dhe të atyre që vinin nga të katër anët e Kosovës për strehim në Grykën e Kizharekës, sepse ishte vendi shumë i përshtatshëm për refugjatët që i ndiqte ushtria barbare serbe. Sepse, në këtë grykë ka pasur shumë ujë të pijshëm nga burime të shumta që i ka pasur në këtë rajon por edhe organizimi i jashtëzakonshëm si për përcjelljen e mësimëve të shkollës të (najlonit) në ato kushte të mjerueshme në ndër-

timin e koroit për atë kohë që me vështirësi ka bërë përcjelljen dhe varrosjen e të vrarëve ose të vdekurve në mënyrën më të mirë me Imam afër kampit të kësaj gryke që edhe sot gjenden varret në vendin e quajtur Livadhi i Hazi Garës, që ka qenë një vend, falë m. Musli Bajraktarit me Heset Bajraktarin dhe unë Ramadan Gara, që ia kemi dalë disi. Edhe organizimin e mbajtjes së të pameve nëpër vendet e caktuara nga një javë.

Nga Kroacia

Si më të dalluarit ishin:

/Mr. Sahit Dragusha

1. Mulla Osman Beqa – Shtrubullovë, Drenas;
2. Isa Hajrizi – Shtrubullovë, Drenas;
3. Shefshet Gashi – Balincë, Malishevë;
4. Rrahman Cani – Baicë e Epërme, Lipjan;
5. Shyqyri Grajçefci – Ribar i Madh, Lipjan;
6. Shaban Thaçi – Shkoroshnik, Malishevë;
7. Hazir Fana – Llozicë, Malishevë;
8. Rasim Olluri, Krojmir;
9. Ukë Thaçi – Shkoroshnik, Malishevë;
10. Bajram Balaj – Rixhevë, Klinë;
11. Nezir Morina – Rixhevë, Klinë;
12. Bajram Zekolli – Bllacë, Suharekë;
13. Rrustem Bytyqi – Semetisht, Suharekë;
14. Ukë Elshani - Baicë e Ulët, tash me banim në Klinë;
15. Isa Sylja, student – Kizharekë, Drenas;
16. Jakup Sylja – Kizharekë, Drenas;
17. Qamil Bajraktari – Kizharekë, Drenas;
18. Zeqir Nuha – Kizharekë, Drenas;
19. Xhevat Podrimqaku – Krojkovë, Drenas;
20. Brahim Krasniqi – Novosellë e Maxhunit, Vushtrri;
21. Ibrahim Bunjaku – Samadregjë, Vushtrri;
22. Shaban Verrshefci – Vushtrri;
23. Hakif Bunjaku – Samadregjë, Vushtrri;
24. Halil Dervishi – Zabllaq, Istog;

25. Bajram Dervishi – Zabllaq, Istog;
26. Gzim Ahmeti – Bollopojë, Besianë;
27. Refki Bekolli – Besianë;
28. Hasan Bajraktari – Kizharekë, Drenas tash Slloveni;
29. Ali Bajraktari – Kizharekë, Drenas tash Slloveni;
30. Xhafer Krasniqi – Negroc, Drenas;
31. Rasim Krasniqi – Negroc, Drenas;
32. Hamdi Bajraktari – Kizharekë, Drenas;
33. Ramadan Krasniqi – Negroc, Drenas;
34. Beqir Gashi – Nekof, Drenas;
35. Isa Imer Zeka – Nekovc, Drenas;
36. Mustafë Hoxha – Nekofc, Drenas;
37. Haxhi Dugolli – Nekofc, Drenas;
38. Xhafer Zeka – Nekofc, Drenas;
39. Adem Haxholli – Zabel, Drenas;
40. Nasuf Bitiqi – Damanek, Drenas;
41. Ujkan – Rezalla, Skenderaj; 1
42. Jashar Januz Berisha – Berishë, Malishevë;
43. Syl Desku - Siqevë;
44. Rustem Bajraktari – Llaushë;
45. Muharrem Hykaj – Kizharekë;
46. Sylë Desku (ka pasur edhe përgatitje fetare);
47. Miftar Jashari – Nekovc, Drenas;
48. Hamdi Zogu – Novasellë, Malishevë;
49. Hysri Qelaj – Kizharekë, Drenas;

E shumë të tjerë që vështirë është për t'i kujtuar emrat për aktivitetet që i bënë në këto katër dekada dhe disa prej tyre veç kanë ndërruar jetë "paqja dhe rahmeti i Zotit qoftë mbi ta".

Mirëpo, kohëve të fundit kemi dhënë një kontribut për hapjen e istikameve nëpër pikat, ku ka pasur nevojë prej Grykës së Llapushnikut deri në Kroimir, dhe që sa kemi pasur mundësi nuk kemi kursyer asgjë vetëm e vetëm për t'iu dalë në ndihmë popullatës sonë. Dhe po ashtu takime me një intensitet të vogël ndër brengat që i kemi pasur më së shumti na kanë preokupuar për rininë tonë që po na mbesin pa

shkollim dhe që po marrin drejtime të ndryshme si në aspektin kombëtar ashtu edhe atë fetar si p.sh./

Komandant Dajën Azem Sylën prej këtij fshati që na ka dhënë shumë kurajë dhe moral për luftën e UÇK-së dhe komandant

Çelikun, Fatmir Limën, që jemi shumë krenarë për këta burra dhe

shumë e shumë të tjerë që kanë kontribuar për këtë atdhe dhe e kanë sakrifikuar edhe jetën e tyre për këtë liri që sot ne po e gëzojmë.

Kjo luftë që na i ka imponuar kulturat e huaja me ardhjen e të huajve në Kosovë, si ndihmëtarë, por në fakt po na sjellin disa kultura të veta nga kanë ardhur si nga Perëndimi ashtu edhe nga Lindja, që po na sjellin telashe si p.sh., me seriale të pazakonshme, dhe sekte fetare, prostitucionin e drogën, që është paraqitur njëra dhe tjetra që janë shumë të rrezikshme për tërë opinionin në tërësi. Kurse paria e shtetit sikurse nuk po ua vë fort veshin madje po i favorizon siç ishte rasti me Avokatin e Popullit z. Sami Kurteshin, që i mbron antivlerat kombëtare. Ne si prindër që kemi kaluar gati tërë jetën në kurbet - për një të ardhme më të mirë për pasardhësit tanë, kemi një dëshirë të veçantë se të tjerët, se kemi shumë etje për dije, se ne nuk kemi mundur të shkollohemi për shkak të rrethanave të caktuara të gjendjes ekonomike, por iu kemi përveshur punës fizike të cilën e kemi pasur bukur të rëndë si bukën me 5 kore dhe me djersë por po ashtu edhe psikike nëpër botë. Mirëpo, disi ia kemi dalë. Tash kemi dëshirë që këto lëshime të rishikohen sa më parë nga organet përgjegjëse sa nuk është bërë vonë. Është për t'u habitur, si mund të miratohet Kushtetuta e Shtetit të Kosovës, e cila në asnjë vend nuk përmend emrin e Zotit - Krijuesit të Gjithësisë. Kur njeriu nuk e njeh Krijuesin e vet a thua si do ta njohë vetveten e si po propagandojnë nëpër botë se si nuk po na njohin pavarësinë, a thua a është e logjikshme kjo pavarësi e pakuptimtë me disa nene të ligjit si për martesën e një gjinie të njëjtë e që i mbron edhe Avokati i Popullit siç e quante vetë si të shenjtë që ishte dalë pa përcjellje d.m.th. me ia mbrojtur autoritetin e këtij njeriu të ndershëm që po mundohet t'ia mbrojë namuzin e këtyre grupeve që

na u kanë paraqitur në këtë kohë. Kur zotëri Kurteshi me djersën e këtij populli e merr rrogën shumë më të madhe se punëtorët që me mund të madh dhe me rrezik për jetë punojnë nëpër vende të punës fizike e ju z. Sami Kurteshi e përbuzni atë djersë të punëtorëve, se ne shqiptarët jemi krenarë për këto që kurrë nuk i kemi pasur ne shqiptarët, d.m.th. ne jemi më të mençurit në botë ose më të çoroditurit në botë. Dhe mbështetim në të drejtat njerëzore dhe në parimet e Shteteve të Bashkuara d.m.th. e nënçmojmë edhe Kushtetutën e një shteti demokratik në botë, që po të shikojmë në çdo dollar të Amerikës shkruan: “Ne besojmë në Zot”. A thua ne jemi më të mençur se e tërë bota apo jemi disi se po na vjen turp me ia kthye shpinën marksizmit një ideologjie më të shëmtuar që njeh njerëzimi ndonjëherë në botën e qytetëruar, për fat të keq vetëm te ne dy shtetet në krejt botën nuk lejohet mësim-besimi nëpër shkollat tona se ia kemi dhënë besën nënës Parti Komuniste, titiste, enveriste, marksiste më shumë se Shtetet e Bashkimit Sovjetik dhe Jugosllavia Titiste, që na ka çnjerëzuar në çdo aspekt si kombëtar ashtu edhe njerëzor e moral dhe ende është ngulitur nëpër disa koka të “intelektualëve” tanë për fat të keq të së ardhmes së këtij populli të vuajtur shqiptar. Por sidoqoftë, ne e lusim të Madhin Zot që të na ndihmojë në këtë situatë kaq të nevojshme për ne. Amin!

Ramadan Gara

THE ALBANIAN AND BOSNIAK MUSLIM COMMUNITY IN CROATIA AND SLOVENIA

(Summary)

The Albanian and Bosniak Muslim Community in Zagreb was established in 1970 by Sahit Dragusha, a madrassa student during the '60-s, and Ramadan Gara. It includes members of the Albanian and Bosniak diasporas in Croatia and Slovenia.

رمضان غارا

المجتمع الالباني المسلم و البوشناك في شتات كرواتيا و سلوفينيا و أوروبا و العالم (خلاصة البحث)

ان المجتمع الالباني المسلم و البوشناك في شتات كرواتيا و سلوفينيا أسس سنة ١٩٧٠ جمعيته بمدينة زغرب عاصمة جمهورية كرواتيا و الاشخاص الذان قاما بتأسيسها هما : السيد ساحت دراغوشا خريج المدرسة في الستينات من القرن المنصرم و رمضان غارا ناشط اسلامي .

HISTORIOGRAFI

Zachary Karabell

KRYQËZATAT

Në terma plotësisht ushtarakë, kryqëzatat ishin të parëndësishme. Të paktën shtatë herë gjatë dy shekujve, ushtritë nga Franca, Gjermania, Italia dhe Anglia pushtuan Lindjen e Mesme. Fillimisht këto ushtri udhëhiqeshin kryesisht, megjithëse jo plotësisht, nga fisnikë të rendit të dytë dhe djem të rendit të tretë, të cilët përballeshin me jetë qorre si shërbyes. Më vonë, ata u udhëhoqën nga mbretërit dhe princërit, të cilët kërkonin lavdi të përkohshme dhe shpirtërore në fushatat kundër myslimanëve. Në kulmin e tyre, shtetet kryqëtare të Lindjes së Afërt përbënin një rrip të ngushtë që mezi përfshinte Izraelin, Libanin dhe një pjesë të Jordanisë, Turqinë dhe Sirinë e sotme. Derisa nxitja për kryqëzata mori shekuj për t'u zhdukur, në fillim të shekullit XIV kryqëzatat si lëvizje masive përfunduan, dhe shtetet kryqëtare u zhdukën. Lëvizja filloi si shpërthim i furisë religjioze, por në fund me sa duket më shumë dëmtoi Perandorinë Bizantine të krishterë sesa shtetet myslimane të Lindjes së Afërt.

Në terma plotësisht simbolikë, megjithatë, kryqëzatat u bënë metaforë perfekt për konfliktin midis Islamit dhe Perëndimit. Nga brengosja, shpesh historia patetike e kryqëzatave, ishte krijuar miti i konfliktit të pafund.

Kryqëzatat ishin nisur nga Papa Urbani për të çliruar qytetin e shenjtë të Jerusalemit nga sundimi i myslimanëve, të cilët ishin përshkruar si të pafe të trashë që fëlliqin vendet më të shenjta dhe si “një racë e huaj për Zotin”, të cilët kanë përdhosur tokën e shenjtëruar nga gjaku i Krishtit¹. Do të duheshin lentet e trasha ngjyrë rozë për të transformuar kryqëzatat në një simbol të harmonisë. Rugët e përgjakura të Jerusalemit, të pushtuara pas një rrethimi të gjatë më 1099, dhe ushtritë e botës së krishterë të kënaqur me atë që madje edhe propagandistët perëndimorë e pranojnë se ishte një orgji e egër e vdekjes, e bënë atë të pamundshme. Por, fushat e vrasjes të Jerusalemit zgjatën me ditë. Shtetet kryqëtare do të qëndronin në Lindjen e Afërme për mbi 200 vjet. Midis betejave periodike kishte periudha të gjata të qetësisë dhe momente therëse të miqësisë.

Madje me kryqëzata, si pasojë, memoria që ka mbijetuar është e mangët. Ajo është memorie e modeluar nga paragjykimi, dhe çfarëdo që nuk i përshtatet historisë së konfliktit është lënë jashtë, është harruar dhe groposur. Në vitet e gjata që ndanë kryqëzatat aktuale, myslimanët jetuan të qetë nën sundimin e krishterë në Lindjen e Afërme. Derisa kishte shumë pak ndërveprim kulturor që e bëri Spanjën myslimane aq dinamike, kishte gjithashtu edhe armiqësi. Indiferenca mund të mos jetë pjesë e legjendës, por ajo me më saktësi përshkruan dekadat e sistemit të jetesës që ndanin episodet e shkurtra, por ekzistuese të thirrjes së ushtrive, ngritjes së rrethimeve dhe zhvillimit të betejave.

Derisa myslimanët e Egjiptit dhe Lindjes së Afërme ishin mësuar me përlëshjet me Bizantin e krishterë, arritja e kryqëtarëve të parë nga Evropa Perëndimore i zuri në befasi. Mizoria e kryqëtarëve i tronditi, sikur edhe intensiteti i thjeshtë i besimit të tyre. Në fund të shekullit XI, myslimanët e Lindjes së Afërme kishin vetëm lidhjen më të dobët

¹ Papa Urbani II citohet në Thomas Asbridge, *The First Crusade: A New History: The Roots of Conflict Between Christianity and Islam* (New York: Oxford University Press, 2005), 32-33. Disa studiues kanë vënë në dyshim nëse Jerusalemi ishte në të vërtetë qëllimi i synuar në Kryqëzatën e Parë, por shumica kanë ardhur në përfundim se ishte. Për këto debate historiografike, shih Andrew Jotischky, *Crusading and the Crusader States* (New York: Longman, 2004), chap. 1.

me entuziazmin e hershëm të Muhamedit dhe pushtimeve arabe. Ata ishin mësuar me luftë, por jo me luftën e inspiruar nga pasionin religjioz.

Përrjashtimi, ndoshta, ishte armiqësia midis sunitëve dhe shiitëve, e cila dukej se po keqësohej pas çdo shekulli që kalonte. Ngritja e papritur e Perandorisë Fatimite shiite në Egjipt në shekullin X ishte parë nga shumica sunitë e Lindjes së Afërme si një kërcënim serioz, dhe me arsye. Fatimitët krijuan një koalicion të pangjashëm të fiseve të Afrikës Veriore, dhe pastaj shkuan përtej shkretëtirës nga Tunizia dhe në Egjipt. Lideri i tyre e shpalli veten kalif, që do të thoshte se mes shekullit X, tre persona njëherësh kishin veshur atë mantel, një në Bagdad, një në Kordoba dhe një në Kajro. Pastaj Hakimi, kalifi fatimit i fillimit të shekullit XI, deklaroi se ai ishte gjithashtu mesiu, dhe filloi të persekutojë ata që nuk i përkuleshin. Në vend që të tregonte tolerancë, ia hoqi të drejtat e ithtarëve të Librit. Sikur Caligula mysliman apo Neroni, sjellja e tij ishte e çuditshme, konfuze, dhe shpesh mizore. Ai kërkoi që dyqanet në Kajro të rrinin hapur gjithë natën me mundësinë që t'i mbyllte, dhe krijoi një lotari ku disa shpërbleheshin me ari, të tjerët me vdekje.²

Hakimi aplikoi ndëshkimet drakoniane për secilin - sunit, shiit, i krishterë, i zi, i kafentë apo me ngjyrë të çelët - që mund të sfidonte ligjshmërinë e tij. Persekutimi i të krishterëve, megjithatë, pati pasoja që ai nuk i kishte parashikuar e as jetoi t'i shihte. Më 1009 ushtarët e tij përdhosën dhe pastaj shkatërruan pjesërisht Kishën e Varrit të Shenjtë në Jerusalem për të ndëshkuar të krishterët për refuzimin e tyre për të pranuar shpalljen e tij të re. Fjalët e këtij veprimi u përhapën në Perëndim, dhe megjithëse papa dhe mbretërit e Evropës mund të bënin më shumë sesa sulmi kundër fatimitëve, kujtesa nuk u zhduk. Në vend të kësaj, ajo u acarua gjatë dekadave të ardhshme, derisa u shndërrua në atë që u bë Kryqëzata e Parë.

² Sjelljet e al-Hakim janë përshkruar në Marshall Hodgson, *The Venture of Islam*, vol. 2, 26-28. Disa kanë thënë se Hakim ishte viktimë e polemistëve të mëvonshëm dhe nuk ishte aspak e turbullt.

Atëherë, megjithatë, Hakimi kishte vdekur nga kohë. Ai kishte bërë shumë armiq, dhe në fund kishte armiqësuar shumë fraksione. Përfundimi i tij ishte mjaft bizar. Ai u largua nga Kajro me një gomar dhe u zhduk. Ai e kishte zakon të linte pallatin me një grup të vogël rojesh, dhe kjo ishte shthurja e tij. Por, mungesa e trupit i dha një grupi të pasuesve një fije shprese. Fraksionet e ndryshme shiite gjatë viteve kanë deklaruar se imami i tyre nuk ka vdekur, por ka larguar veten nga shoqëria e dallueshme për të pritur momentin e duhur për t'u shfaqur sërish. Kur u zhduk Hakimi, disa pasues të patundur refuzuan të besonin se ai ishte vrarë dhe pohuan në vend të kësaj se ai ishte fshehur për të pritur fundin e botës. Pas shkuarjes jashtë Egjiptit, këta pasues u bënë të njohur si druzë, një komunitet i fshehtë e i bashkuar që i mbijetoi maleve të Libanit, Sirisë dhe Palestinës.

Kur sunitët nuk luftonin fatimitët shiitë, ata luftonin njëri-tjetrin. Shekujt X dhe XI ishin dëshmitarë të ngritjes së fuqisë turke. Turqit kishin depërtuar në Lindjen e Afërme dhe Anadoll nga Azia Qendrore dhe ishin konvertuar ngadalë në Islam pasi që ishin marrë si mercenarë nga kalifi abasid dhe sundimtarët e tjerë arabë. Shfaqja e dinastisë së turqve selxhukë në shekullin XI kërcënoi të gjitha fuqitë që ishin në rajon, veçanërisht Bizantinët dhe shiitët fatimitë.

Pasi që Lindja e Afërme e shekullit XI ishte shkatërruar nga konfliktet e përgjakshme midis sekteve dhe shteteve myslimane, ishte e gatshme për një pushtim të huaj. Megjithatë, askush nuk kishte pritur një luftë me të krishterët nga Evropa, dhe vetëm disa banorë të Lindjes së Afërt kishin ndonjë marrëdhënie me Perëndimin. Spanja ishte shumë larg nga bota e përditshme e Damaskut, Antiochut, Jerusalemit, apo qyteteve-shtete të tjera të Lindjes së Afërt. Megjithëse klanet çifute mbajtën lidhjet me njëri-tjetrin përgjatë mijëra miljeve të rrethuar nga Mesdheu, shumica e myslimanëve ishin më provincialë. Tregtarët udhëtonin shumë, dhe të njëjtën e bënë edhe dijetarët, por madje edhe këta patën pak kontakt me shtetet e prapambetura të Evropës. Si rezultat, paraqitja e papritur e mijëra kalorësve evropianë që pretendonin urdhrin hyjnor për të çliruar Jerusalemin nuk ishte diçka që myslimanët në Lindjen e Afërme e kishin imagjinuar ndonjëherë.

Kjo ishte e papritur edhe për të krishterët e Evropës Perëndimore. Ata, megjithatë, kishin luftuar në “kryqëzatat” kundër jo të krishterëve dhe heretikëve. Derisa studiuesit kanë analizuar arsyet e ndryshme që çuan në Kryqëzatën e Parë, ka debate akademike të nxehta rreth asaj sesi ishin në të vërtetë kryqtarët e rinj. Ka pasur fushata kundër paganëve në veri të Evropës dhe kundër myslimanëve në Spanjë dhe në Itali. Sundimtarët e krishterë në mënyrë rutinë kishin nxitur pasionet e ushtarëve të tyre duke lidhur sakrificën në betejë me sakrificën e Krishtit në kryq. Por, kishte një dallim midis evokimit të Krishtit në fjalimet para betejave dhe thirrjeve për pelegrinazh të shenjtë ushtarak mijëra milje larg.³

Pavarësisht sesa romantike ishte ideja, rezultati i thirrjes së Papa Urbanit ishte i paprecedentë. Kurrë më parë nuk ishte grumbulluar një ushtri e të krishterëve nga Perëndimi kundër myslimanëve në Lindjen e Afërme.

Përgjigja në thirrje

Thelbi i fjalimit të Urbanit në Klemont në fund të vitit 1095 ishte i thjeshtë: të krishterët kishin obligim të shenjtë të çlironin Jerusalemin nga sundimi mysliman. Asnjë version zyrtar i fjalimit nuk ka mbijetuar, dhe kronistët e ndryshëm bashkëkohorë dallojnë shumë në detaje dhe në ton. Por, të gjithë sugjerojnë se Urbani i nxiti peshkopët dhe princërit e botës së krishterë të mblidhnin një ushtri për qëllimin e vetëm të marrjes së Jerusalemit. Në disa kronika, Urbani kishte përsëritur mizoritë e qëllimit të bëra nga myslimanët kundër të krishterëve dhe pelegrinëve të devotshëm. Në stilin e demagogjisë klasike, ai listoi torturat që të krishterët po i vuanin, duke nisur nga nxjerrja e zorrëve me instrumente metalike të pista e deri te veprimet e pazbuluara të kryera brenda Kishës së Varrit të Shenjtë, duke përfshirë synetimin

³ Literatura për origjinën e luftës së shenjtë të krishterë është e pafund. Shih Asbridge, *The First Crusades*, chap. 1; Christopher Tyerman, *Fighting for Christendom: Holy War and the Crusades* (New York: Oxford University Press, 2004); Jotischky, *Crusading and the Crusader States*; Claude Cahen, *Orient et Occident au temps des Croisades* (Paris: Editions Aubier, 1983), 54-80.

me forcë të murgjve në altarin e gjakosur. Kronikat tjera të fjalimit theksojnë fuqinë shpenguese të çlirimit të qytetit. Urbani paralajmëroi princërit se ata po bënë jetë të mëkatit dhe vetë kishin bërë mizori në luftërat e tyre të papërfillshme kundër njëri-tjetrit. Për këtë, Urbani deklaroi se ata do të jepnin përgjegjësi në Ditën e Gjykimit, derisa të dedikonin veten për kauzën fisnike të Jerusalemit.

“Bëni që urrejtja të largohet nga ju”, tha Urbani; “Lini grindjet tuaja, luftërat të pushojnë, dhe të gjitha mosmarrëveshjet e polemikat të marrin fund. Hyni në rrugën drejt Varrit të Shenjtë; rrëmbeni atë tokë nga raca e ligë, dhe nënshtrojani vetes”. Vetë Toka e Shenjtë, vazhdoi Urbani, po vajton për ndihmë.

Ajo tokë, për të cilën Bibla thotë se gëlon nga qumështi dhe mjalti, iu është dhënë në zotërim bijve të Izraelit. Jerusalemi është qendra e botës; toka është më e frytshme se të tjerat, si një parajsë tjetër e kënaqësive. Ky shpengim i racës njerëzore është bërë i famshëm nga ardhja e Tij, është zbukuruar nga rezidenca, është shenjtëruar nga vuajtja, është shpenguar nga vdekja, është lartësuar nga varrosja. Ky qytet mbretëror, kështu, i vendosur në qendër të botës, mbahet rob tani nga armiqët e Tij, dhe është në varësi të atyre që nuk e njohin Zotin, nën adhurimin e të pafeve. Prandaj, ai kërkon dhe dëshiron të çlirohet, dhe nuk pushon t’ju përgjërojë që të vini e ta ndihmoni.

Dhe ata që iu përgjigjën thirrjes, Urbani premtoi se do të shpërblehen. “Të gjithë që vdesin gjatë rrugës, qoftë në tokë apo det, apo në betejë kundër paganëve, do t’iu shlyhen menjëherë mëkatet. Këtë ua jap përmes fuqisë së Zotit që më ka dhënë”. Ishte një detyrë që çdo besimtar e kishte obligim ta kryente, duke ia siguruar mjetet. Alternativa, Urbani deklaroi, ishte e papranueshme.

O çfarë turpi nëse një racë e tillë e përbuzur dhe e ulët, e cila adhuron demonët, të pushtojë njerëzit, të cilët kanë besimin e Zotit të Plotfuqishëm dhe janë bërë të lavdishëm me emrin e Krishtit! Me çfarë pushtimi Zoti do të na pushtojë nëse nuk i ndihmoni ata, të cilët me ne, deklarojnë religjionin e krishterë! Lejoni ata, të cilët janë mësuar padrejtësisht të zhvillojnë luftë personale kundër besimtarëve që tani të luftojnë të pafetë dhe kjo luftë të përfundojë me fitore, e cila do

*të duhej të fillonte shumë kohë më parë. Lejoni ata që për një kohë të gjatë, kanë qenë grabitës, të bëhen tani kalorës. Lejoni ata që kanë luftuar kundër vëllezërve dhe të afërmeve të tyre të luftojnë tani në mënyrën e duhur kundër barbarëve. Lejoni ata që kanë shërbyer si mercenarë për paga të vogla të fitojnë tani shpërblimin e përjetshëm... Lejoni ata që nuk mund të shtyjnë udhëtimin, por japin me qira tokat dhe mbledhin para për shpenzimet e tyre; dhe posa të përfundojë dëmmi dhe të vijë pranvera, lejoni ata që të etur të ndërmarrin rrugën me Zotin si udhëzues të tyre.*⁴

Ata që dëgjonin Urbanin mund të falen për mendimin se Jerusalemi vetëm së fundi ishte pushtuar nga hordhitë myslimane. Në fakt, Jerusalemi kishte qenë nën sundimin e një apo tjetrit princ mysliman që nga shekulli VII, dhe pelegrinëve të krishterë rrallë iu kishte mohuar hyrja. Madje, shkatërrimi i shkurtër, megjithëse tronditës, i kalifit të çmendur Hakim kishte ndodhur gati një shekull para se Urbani të qëndronte në Klemont dhe të mbante fjalimin që ndryshoi historinë. Por, motivimi për lansimin e Kryqëzatës kishte më pak të bënte me ndodhitë në Jerusalem sesa me situatën në Perëndim dhe Evropën Qendrore.

Siç kanë shkruar shumë, kryqëzatat dëshmuar të jenë një zgjidhje e shkëlqyer për anarkinë dhe kaosin në Evropë. Princërit e Francës në shekullin XI, përveç pushtimit të suksesshëm të Normanit në Angli më 1066, ishin angazhuar në betejë konstante me njëri-tjetrin, dhe gjendja nuk ishte më e mirë as në lindje të Gjermanisë. Kisha, përveç qendra si Cluny, funksiononte sipas tekave të fisnikëve. Duke bërë thirrje për çlirimin e Jerusalemit, Urbani shpresonte të fokusonte energjitë e princërve në diçka tjetër sesa lufta e brendshme dhe në këtë mënyrë do të rritej prestigji e influenca e kishës. Ai urdhëroi kalorësit të bartnin simbolin e kryqit për të treguar veten si ushtarë të Krishtit, dhe udhëzoi peshkopët e tij për të përhapur fjalën. Ata e bënë, dhe përgjigja ishte e menjëhershme. Normanët ishin veçanërisht të etur.

Të tillë ishin edhe fshatarët e Gjermanisë Qendrore, të udhëhequr nga një figurë enigmatike e njohur si Peteri i Hermitit, ushtria barbare dhe e pajisur keq e të cilit u mblodh në Danub dhe vazhdoi në jug e lindje.

Rruga për Jerusalem shkonte përmes Kostandinopojës. Derisa disa qytete italiane kishin anije, nuk kishte flotë të aftë në Evropë për transportimin e një ushtrie prej 50 mijë ushtarësh dhe shërbëtorët e saj përtej Mesdheut. Legjionet e Perëndimit duhej të shkonin përmes rrugëve tokësore, dhe kjo nënkuptonte një udhëtim prej mijëra miljeve në Kostandinopojë dhe nga aty nëpër Turqi dhe në Siri e Palestinë.

Kryqëzata e Parë ishte bekuar me fat të jashtëzakonshëm, ndoshta hyjnor. Nuk mund të kishte kohë më të mirë. Megjithëse pushtimet e hershme myslimane kishin ndodhur në rrethana gati perfekte pasi që bizantinët dhe sasanianët kishin rraskapitur njëri-tjetrin pas luftës disadekadëshe, kryqtarët arritën në Kostandinopojë kur edhe bizantinët dhe turqit selxhukë po luftonin për të ruajtur perandoritë e tyre. Në shekullin XI, selxhukët kishin zëvendësuar abasidët si kërcënimi kryesor për bizantinët. Më 1071, në betejën e Manzikertit, ushtria bizantine ishte asgjësuar nga sulltani turk, dhe perandori ishte kapur rob. Si rezultat i kësaj humbjeje vendimtare dhe poshtëruese, e gjithë Azia e Vogël përveç qytetit antik perandorak të Nicaes, disa qindra milje nga Kostandinopoja, ra nën kontrollin e federatës selxhuke.

Pas Manzikertit, megjithatë, selxhukët u copëtuan. Ata kurrë nuk kishin qenë një federatë e centralizuar, dhe çdo princ selxhuk komandonte besnikërinë e ushtrisë së tij të vogël. Me martesë të shumta, numri i princërve rritej shumë. Grumbullimi i tyre në një forcë të unifikuar ishte përjashtim, jo rregull, dhe ilustrimi më perfekt i ligjit të entropisë, shteti selxhuk u shpërbë në dhjetëra njësi të vogla pothuajse sa ishin formuar. Këto njësi pastaj u shpërbënë në njësi edhe më të vogla, derisa shumë qytete që rrethonin Jerusalemin, duke përfshirë Antiochun dhe Damaskun, u sunduan nga fraksione të ndryshme dhe shpesh antagoniste të selxhukëve, asnjë prej të cilëve nuk ishin të gatshëm apo të përgatitur të ndihmonin të tjerët. Plotësisht në kundërshtim. Sa kohë që ata vetë nuk ishin objekt i një sulmi të kryqtarëve,

⁴ Citimi i Urbanit I është nga kronika e shkruar nga Fulcher i Chartres, i dyti nga murgu Robert, dhe të dyja mund të gjenden në Internet Medieval Source-book në www.fordham.edu/halsall/sbook1k.html.

ata ishin shumë të kënaqur t'i lejonin të krishterët që të eliminonin qytetet-shtete rivale në rrugën e tyre drejt Jerusalemit.

Jo vetëm selxhukët ishin të përçarë dhe bizantinët të prangosur, por edhe Fatimitët e Egjiptit, të cilët formalisht kontrollonin Jerusalemin dhe pjesën më të madhe të territorit të Palestinës, ishin gjithashtu një hije e ish-vetës së tyre. Të paaftë për të sfiduar në mënyrë efektive emirët e përçarë selxhukë në Siri, Fatimitët mirëpritën kryqtarët si një mbajtës efektivë. Kur kalifi fatimit në Kajro mësoi se ushtritë e krishtera nga Evropa po avanconin drejt Sirisë nga Kostandinopoja, ai dërgoi përfaqësues të tij për të ofruar ndihmë. Armiqësia midis selxhukëve sunitë dhe fatimitëve shiitë mund edhe të mos ishte aq e madhe, por asnjëri prej tyre nuk kishte ndjenja të forta për princërit nga Evropa. Kryqtarët ishin të panjohur, dhe lëvizjet e tyre ishin një mister. Kalifi fatimit fatkeqësisht nuk vuri re detajet më të qarta, që qëllimi final i kryqtarëve nuk ishte Siria por Jerusalemi, i cili atëherë sundohej nga vetë fatimitët.⁵

Shkurtimisht, kur kryqtarët u nisën drejt Jerusalemit, asnjë shtet i vetëm i fortë nuk i doli para. Po të fillonte lëvizja vetëm një dekadë më parë, sulltani selxhuk që kishte orkestruar fitoren në Manzikert do të ishte akoma gjallë, dhe kryqtarët nuk do të kishin asnjë shans kundër tij. Në çdo kohë tjetër në shekullin XI, ata do të përballeshin me një perandor bizantin të fuqishëm dhe armiqësor në Kostandinopojë, si dhe një Perandori Fatimite të bashkuar, po të dinin disi të menaxhohnin atë në jug të Sirisë.

Jo vetëm kryqtarët ishin bekuar me kohën e mirë, por ata gjithashtu u përballën me kundërshtarë, të cilët kishin njohuri të pakta për taktikat, ambiciet dhe ideologjinë e tyre. Në retrospektivë, Kryqëzata e Parë ishte qartë një luftë e shenjtë e zhvilluar nga të krishterët kundër myslimanëve, por është e habitshme sesa të pavetëdijshëm për këtë fakt ishin myslimanët në atë kohë. Selxhukët dhe pastaj fatimitët,

i shihnin bastisjet e para të kalorësve nga Evropa si një telash, dhe pastaj si një sfidë ushtarake, deri madje pas rënies së Jerusalemit, nuk kishte asnjë ndjenjë në botën myslimane se kjo ishte një luftë religjioze apo një përballje e civilizimeve.

Në fakt, është e ekzagjeruar që madje të flasim për një “botë myslimane”. Nuk kishte unitet midis myslimanëve madje edhe kur u përballën me një invadim të krishterë të Levantit. Siç do të shohim, pas suksesit të Kryqëzatës së Parë, disa myslimanë u përpoqën – dhe dështuan – të krijojnë një aleancë pan-islamike kundër të krishterëve. Madje, gati një shekull më vonë, Salahudini bashkoi qytetet-shtete të ndara dhe i udhëhoqi drejt rimarrjes së Jerusalemit. Ai pati sukses kryesisht për shkak të aftësive të tij si komandant ushtarak, e jo se njerëzit u mbledhën nën një flamur pan-islamik. Në vitet pas Kryqëzatës së Parë, derisa kishte mungesë së banaliteteve rreth solidaritetit mysliman përballë një sfide të krishterë, disa në pozita autoritare bënë më shumë sesa i dhanë mbështetje idesë së një komuniteti mysliman të unifikuar.

Shkurtimisht, religjioni kishte rëndësi, përveç kur nuk kishte, dhe nuk kishte rëndësi, përveç kur kishte. Lidhja midis besimit dhe vepimit është e megjullt. Thirrja e Urbanit për ushtritë që të marshojnë në Jerusalem në emër të Zotit shpesh është trajtuar si dëshmi se njerëzit do të luftojnë dhe do të vdesin për religjionin e tyre. Reagimi i myslimanëve gati një mijë vjet më vonë, kur Jerusalemi u rimor më 1187, është trajtuar në të njëjtën mënyrë. Por, çka për kohët kur myslimanët apo të krishterët u bënë thirrje vëllezërve të tyre që të ngrihen në emër të Zotit dhe askush nuk dëgjoi? Çka për periudhat midis luftimeve, pas rënies së Jerusalemit? Ku ishte religjioni kur kalorësit e krishterë formuan aleanca me myslimanët sunitë për të luftuar myslimanët shiitë apo kur një fisnik i krishterë kërkonte ndihmë nga një kurd mysliman për të nënshtuar një fisnik tjetër të krishterë? Nëse religjioni kishte rëndësi më shumë se gjithçka tjetër, si të shpjegojmë këto kohëra kur kishte rëndësi gati më shumë se gjithçka?

Megjithëse kryqtarët u bënë përfundimisht sinonim me konfliktin midis Krishterimit dhe Islamit, në kohën kur gjendja ishte padyshim

⁵ Historia e aleancës së mundshme midis Fatimitëve dhe kryqtarëve vjen nga kronisti i shekullit XIII të quajtur Ibn al-Athir, i cituar në Carole Hillenbrand, *The Crusades: Islamic Perspectives* (New York: Routledge, 2000), 46.

Zakonet e tyre seksuale ishin gjithashtu të çuditshme për të. Usama nuk ishte as i pari e as i fundit që ishte gudulisur nga tregimet tmerruese. Ai kujtoi kohën kur po qëndronte në një han që shërbente për udhëtarët myslimanë dhe të krishterë, dhe hanxhiu i tha atij se një i krishterë ishte kthyer në dhomën e tij vetëm për të gjetur një person tjetër që do të flinte me gruan e tij. Natyrisht, ai ishte i shqetësuar pak dhe zgjoi burrin. “Ç’po bën këtu me gruan time?”, pyeti njeriun. “Mirë, isha i lidhur”, iu përgjigj ai. Gruaja ishte tashmë në shtrat, dhe kjo, i tha ai burrit të nevrikosur, do të ishte e pasjellshme që ta zgjonte atë.

Usama rrëfen gjithashtu një ngjarje që ia kishte treguar një pronar mysliman i një banje publike. Një ditë, pronari shkoi në banjë i shoqëruar nga disa fisnikë frankë, dhe u habit sesa të pacipë mund të ishin frankët. Ai u mbulua me peshqir para se të hynte në banjë, por pa se frankët nuk kishin mbuluar veten. Njëri prej tyre erdhi tek ai dhe ia hoqi peshqirin, i cili me shpejtësi zbuloi dallimin tjetër kulturor. Pronari, si shumica e fisnikëve të kulturuar të Lindjes së Afërt, i mbannte flokët të rregulluar – *kudo!* Franku shikoi dhe kërkoi që myslimani t’ia rregullonte flokët sikur ai. Franku pëlqeu rezultatit aq shumë sa që kërkoi sjelljen e gruas së tij. I tha asaj që të shtrihej në shpinë dhe pastaj i kërkoi pronarit që të bënte të njëjtën gjë për të dhe i ofroi pagesë për këtë!

Komenti i vetëm editorial që Usama kishte bërë gjatë tregimit të historisë ishte se frankët dukeshin imunë nga xhelozia dhe modestia. Fakti se pronari i banjës publike i kishte prerë flokët kalorësit frank dhe gruas së tij në publik ishte me sa duket i panjohur për Usamën. Gjëja e vetme e rrallë nga perspektiva e Usamas ishte ajo që kishte kërkuar kalorësi. Me sa duket, fakti që pronari ishte obliguar ishte thjesht mënyrë e mirë.

Usama ishte gjithashtu i prekur nga drejtësia e ashpër e frankëve. Jurisprudenca myslimane ishte mjaft e avancuar në shekullin XII. Gjykatësit mund të ndaleshin në precedentët legalë disashekullorë, si dhe në vëllimin e librave ligjorë për të aplikuar parimet e Kur’anit në rastin që kishin përpara. Nuk kishte ekuivalencë të tillë te frankët, të cilët kishin harruar pjesën më të madhe të sistemit ligjor romak dhe nga kohë kishin braktisur diskutimet e kujdesshme që e karakterizonin ligjin romak në kulmin e tij. Në një rast të treguar nga Usama, një farkëtar lokal frank ishte akuzuar se kishte ndihmuar disa hajdutë, dhe për këtë kishte sfiduar paditësin e tij në duel. Në vend të paraqitjes së rastit në gjykatë, zotëria lokal ishte pajtuar, dhe farkëtari dhe paditësi ishin përballur me njëri-tjetrin. Farkëtari fitoi, tërhoqi zvarrë kufomën, dhe pastaj e vari si një akt të poshtërimit ritual. Usama përshkroi gjithashtu gjyqin “e provuar me ujë”. I akuzuari lidhej dhe pastaj hidhej në një fuqi me ujë. Nëse zhytej, konsiderohej i pafajshëm, por

nëse pluskonte, do të shpallej fajtor. Duke ditur që trupat e njerëzve nuk janë të prirë të fundosen menjëherë, ai pluskonte pak, dhe si rezultat i kësaj shpallej fajtor dhe dënohej duke ia futur shufrat e nxehta në sy.¹⁶

Usama ishte aristokrat mysliman, i cili i shërbeu emirit të Alepit dhe Damaskut dhe shpesh luftoi kundër ushtrive franke. Por, gjithashtu ai kishte ngrohur marrëdhëniet me kalorësit e krishterë. Në disa raste, ai shkoi në Jerusalem për t'u falur në xhaminë Al Aksa dhe pastaj ndau ushqimin me Templarët, të cilët kishin pushtuar vendin. Ai i referohej Templarëve si "miqtë e mi", dhe duket të ketë kaluar kohë të konsiderueshme në shoqërinë e tyre. Ai mund të ketë qenë më radhë i kënaqur dhe i zmbarsur nga frankët, por bota e tij nuk ishte aq e ndryshme. Ajo gjithashtu ishte nënvizuar nga aktet rutinë të dhunës, dhe nga qëndrimet e rastit ndaj jetës, vdekjes dhe skllavërisë. Në memoriet e tij, njerëzit jetojnë, njerëzit vdesin, ata vrasin dhe vriten, dhe pak nga kjo e trondit atë.

Nocionet e sotshme të konfliktit religjioz nuk do t'i bënin përshtypje Usamas. Ndryshe nga Osama bin Ladeni, Usama ibn Munkidh nuk e shihte identitetin religjioz si gjithëpërfshirës. Besimi i tij ishte vital, dhe vullneti i Allahut ishte suprem. Frankët ishin pabesimtarë – dhe rrezikonin mallkimin – por të tillë ishin shiitët dhe fatimitët. Një muaj, ai mund të ishte në luftë me ta; tjetrin, mund të ishte mysafir i Templarëve në xhaminë Al Aksa.

Megjithëse ishte vëzhgues jashtëzakonisht finok i natyrës njerëzore. Usama ishte gjithashtu njeri i kohës së tij. Mënyra sesi ishte lidhur me fqinjët e krishterë dhe frankë ishte tipike për një person të klasës dhe pozitës së tij. Tregtarët dhe ushtarët udhëtonin shpesh dhe lirshëm kudo në Siri dhe Palestinë, pavarësisht rrugëve të rrezikshme dhe pikëpamjeve të ndryshme politike. Aleancat ishin të shkurtra dhe bëheshin e prisheshin pa kriter. Kur ishte e favorshme, frankët nënshkru-

anin marrëveshje paqësore me selxhukët apo fatimitët, dhe kur nuk ishte e leverdishme ata luftonin krah myslimanëve kundër armiqve reciprokë. Fisnikët frankë ishin të prirë për luftërat me frankët tjerë ashtu siç ishin në zhvillimin e fushatave kundër myslimanëve. Ashtu sikur Spanja që kishte parë koalicionet e ndryshueshme varësisht se kush luftonte kë, ushtarët frankë luftonin krah turqve një vit dhe kundër tyre vitin tjetër. Nganjëherë religjioni ishte zona e luftës; nganjëherë nuk ishte.

Deri në mesin e shekullit XII, shtetet kryqëtare kishin kontrollin e Lindjes së Afërt. Pastaj, rrjedhja ndryshoi. Disa emirë të talentuar turq unifikuan Sirinë dhe përfundimisht Egjiptin. Derisa motivi i tyre ishte krijimi i dinastive të fuqishme, ata përdorën retorikën e luftës së shenjtë, dhe kur ishte e mundshme, ata definuan politikën në Lindjen e Afërt, duke iu referuar myslimanëve përballë frankëve. Nëse kanë besuar apo jo retorikën e tyre, në atë që ishte ndryshe një rajon i ndarë, ajo i bashkoi arabët dhe turqit, sirianët, egjiptianët, dhe mbi të gjitha, kurdët dhe i transformoi në një forcë potenciale për dëbimin e kryqtarëve nga Lindja e Afërt. I pari që i nxiti myslimanët për të luftuar frankët ishte emiri turk i quajtur Zengi, por më i njohuri ishte një princ kurd, i lindur në qytetin Tikrit matanë Tigrin, i quajtur Jusuf, djali i Ejubit, i njohur më vonë me llogarinë e tij, Nderi i Besimit, Salahudini.

¹⁶ Usama ibn Munqidh, *An Arab-Syrian Gentleman and Warrior in the Period of the Crusades*, trans. Philip Hitt (New York: Columbia University Press, 1929, 2002), 161-70.

Zachary Karabell

THE CRUSADES

(Summary)

In purely military terms, the crusades were negligible. At least seven times over the course of two centuries, armies from France, Germany, Italy and England invaded the Near East. Initially, these armies were led by second class noblemen. Later on, they were led by kings and princes, who sought spiritual glory in their campaigns against Muslims. At their height the crusader states barely contained a narrow stretch that included present day Israel, Lebanon, and small sections of Jordan, Turkey and Syria. By the end of the XIV century the crusades ended and the crusader states ceased to be. The crusades began as an explosion of religious fervor, which eventually did more damage to the Byzantine Empire than to the Muslim states of the Near East.

زاقارى كارابيل

الحروب الصليبية

(خلاصة البحث)

حسب المصطلحات العسكرية الحروب الصليبية لم تكن ذات أهمية . يمكن القول بأنه خلال قرنين من الزمن قامت جيوش من فرنسا و المانيا و إيطاليا و إنجلترا باحتلال الشرق الاوسط . فى اول الامر كان على رأس هذه الجيوش اساسا نبلاء من الدرجة الثانية و غلمان من الدرجة الثالثة و الذين كانوا يعانون مصاعب فى حياتهم اليومية كخدم . فيما بعد تم قيادة تلك الجيوش من قبل الملوك و الامراء الذين كانوا يطلبون المجد المؤقت فى حملاتهم ضد المسلمين . و فى أقصى مجدهم كانت الدول الصليبية فى الشرق الاوسط تحتل حزاما ضيقا و تشمل اسرائيل و لبنان و جزءا من الاردن و تركيا و سوريا الحالية . مع أن التحريض على الحروب الصليبية أخذ قرونا لاختفائها و مع بداية القرن الرابع عشر انتهت الحروب الصليبية كحركة جماهيرية و قد تم معها اختفاء الدول الصليبية أيضا . بدأت الحركة كانفجار دينى و لكن فى النهاية كما يبدو الحروب الصليبية أضرت أكثر بالامبراطورية البيزنطية المسيحية مما أضرت بالدول الاسلامية فى الشرق الاوسط .

PORTRETE

Mexhid Yvejsi

NË PËRKUJTIM TË 110-VJETORIT TË LINDJES SË DIJETARIT TË FAMSHËM - HOXHËS SË HOXHALLARËVE MYDERRIZ, HAFIZ FAHRI EF. ILJAZI (1903-1985)

Myderrizi, Hafiz Fahri Efendi Iljazi, ishte njëri prej hoxhallarëve më të ditur dhe më të ndritur, jo vetëm të Gjakovës, jo vetëm të Kosovës, por ishte njëri nga më të dalluarit, njëri nga më të shquarit në nivel kombëtar, në të gjitha trojet, ku ka shqiptarë. Shkurt, ai ishte dijetar i famshëm, hoxhë i hoxhallarëve!

Gjakova, vendlindja e myderrizit, hafiz Fahri ef. Iljazi

Duke u mbështetur në defterët osmanë të Sanxhakut të Shkodrës, Gjakova ishte katund, dhe si qendër pazari përmendet qysh në vitin më 1485. Me një status të këtillë, ajo mbeti deri më 1582.



*Hafiz Fahri ef. Iljazi
(1903-1985)*

Në vitin 1592, pra dhjetë vjet më vonë, prej 68 familjesh shqiptare, sa kishte atëherë Gjakova, 13 ishin të islamizuara e të tjerat të krishtera.

Gjakova si fshat i vogël, kryente funksionin e tregut lokal. Ky treg lokal ishte një veçanti për Gjakovën si dhe qytetet shqiptare gjatë shekullit XV, deri në fillim të atij XVI.

Në atë periudhë, konkretisht në vitin 1594, Hadum Sylejman Efendia ose Hadum Aga, siç njihet nga populli, ndërtoi xhaminë, e cila po ashtu e mban emrin Xhamia e Hadumit.

Me ndërtimin e Xhamisë së Hadumit, njëkohësisht, qenë ndërtuar edhe hani (bujtinë) hamami, shtëpi, kulla, me dyqane përreth. Kjo ishte bërthama e qytetit, që më vonë u zhvillua e që njihet edhe sot me emrin Çarshia e Madhe.

Çarshia e Madhe, me të gjitha objektet e para, si Xhamia e Hadumit, hani, hamami, shtëpitë, kullat, dyqanet, sipas traditës gojore, u ndërtuan në fushën e Jak Vulës, prej nga rrjedh edhe emërtimi i qytetit Jakovë (Fusha e Jakut).

Gjakova është një qytet i veçantë, sepse u themelua me emrin e Zotit, ose siç thotë populli me Bismilah! Pra, fillimi i Gjakovës si qytezë fillon që nga objekti i parë kryesor që është Xhamia e Hadumit, e cila e mban emrin e themeluesit, Hadum Aga ose Sulejman Efendiu nga rrethi i Gjakovës, prej fisit Thaç.

Të dhënat e para për Gjakovën si qytet i kemi nga udhëpërshkruesi i madh turk, Evlia Çelebiu, i cili e vizitoi Gjakovën në vitin 1662, ku ndër të tjera shkruan:

“Gjakova i ka dy mijë shtëpi të stolisura që ndodhen mbi një fushë të gjerë. Ka dy xhami të bukura, mesxhide (xhami të vogla), hane të mbuluara me plumb. Ka një hamam të bukur që të kënaqë zemrën dhe nja treqind dyqane të ndryshme, të mbushura me mallra e me një mijë lloj mjeshtërish. Meqë e ka klimën e këndshme, banorët e saj janë të bukur dhe të dashur!”

Dyqind vjet pas Evlia Çelebiut, dijetari, atdhetari, ideologu kryesor i Zgjimit Kombëtar, Sami Frashëri (1850-1904), në kryeveprën e

tij Kamus al Alam, botuar më 1889, në faqen 4.787 të vëllimit VI, për Gjakovën, ndër të tjera, shkruan:

“Në Gjakovë ka 16 xhami, dy medrese, një shkollë ruzhdie dhe disa mektebe, një bibliotekë, kishë dhe shkolla fillore të veçantë për katolikë e ortodoksë. Ka afro 1000 dyqane, ka bujtina e banja publike. Popullsia e Gjakovës është e njohur për ruajtjen e traditave dhe kanë prirje për tregti e zejтари. Është popull guximtar dhe i aftë për armë. Nga gjiri i këtij qyteti ka pasur gjithmonë dijetarë të dëgjuar e myderrizë...”

Për qytetin e Gjakovës, me popullsi që ishte e njohur për ruajtjen e traditave, që kishte prirje për tregti e zejтари, me burra guximtarë, të aftë për armë, me banorë të bukur e të dashur, me dijetarë të dëgjuar e myderrizë, kanë shkruar edhe shumë dijetarë të tjerë në Lindje; kanë shkruar edhe shumë dijetarë, misionarë, historianë, shkencëtarë aq më shumë në Perëndim, siç janë Mylleri, Nopça, Hekardi, Mehju etj.

Ne, në këtë rast, do të kufizohemi vetëm te rëndësia e veçantë e monumenteve islamike-shqiptare, siç është Xhamia e Hadumit, për të cilën eksperti i historisë së artit islam, drejtori i Qendrës Dokumentare të Artit Islam dhe Arkitekturës Islame pranë Universitetit të Harvardit në SHBA., prof. A. Ridlmajer thotë:

“Xhamia e Hadumit është monument unik në të gjitha trojet shqiptare. Është i vetmi kompleks i këtij lloji që është ruajtur. Xhamia e Hadumit nuk është vetëm xhami, por është qendër kulturore. Pranë xhamisë gjendej biblioteka, e cila ishte më e madhe se vetë xhamia. Pranë bibliotekës gjendej mejtepi, ndërsa aty pranë Çarshia e Vjetër me dhjetëra dyqane, të cilat ishin vakëfe të xhamisë. I tërë kompleksi, pra, përbënte një qendër edukative e fetare. Kompleksi ishte ndërtuar dhe zhvilluar nga ana e vetë gjakovarëve.

Kjo qendër nuk ishte e importuar nga jashtë. Ky është monument i kulturës shqiptare...”

Prejardhja familjare

Myderriz, hafiz Fahri ef. Iljazi rrjedh prej një familje të njohur gjakovare, prej së cilës ndër shekuj kanë dalë shumë besimtarë, intelektualë, dijetarë, myfti, myderrizë, hafizë, hoxhallarë e atdhetarë.

Fahri Efendi Iljazi u lind në vitin 1903, në Gjakovë. Është djali i myderrizit, Hafiz Iljaz Efendiut, i cili ishte djali i myderrizit, Hafiz Muhamedi Efendiut, i cili ishte njëri nga pesë djemtë e myderrizit, Hafiz Yveys Efendiut, të gjithë hoxhallarë të njohur, të nderuar, siç janë: Muhamed Efendiu, Hafiz Ismail Efendiu, Hafiz Muhamedi Efendiu, Jahja Efendiu dhe Hysein Efendiu.

Yveys Efendiu është djali i myderrizit, Hafiz Jahja Efendiut, kurse është babai i pesë hoxhallarëve të shquar, ka qenë myderrizi i parë në Medresenë e Madhe të Gjakovës, e cila ishte vatra kryesore edukative, arsimore, kulturore, jo vetëm e Gjakovës, por e tërë Kosovës...

Shkollimi dhe diplomimi

Fahri Efendi Iljazi mësimet fillestare i kreu në Gjakovë, ku krahas mësimëve, pranë babait, myderrizit, Hafiz Iljaz Efendiut, e mësoi Kur'anin e Shenjtë përmendësh, në moshën 11-vjeçare dhe e fitoi titullin e nderuar: Hafiz. Hafiz ishte edhe babai i tij, Myderriz Iljaz Efendiu, që nga mosha 9-vjeçare...

Hafiz Fahri Efendi Iljazi i vazhdoi mësimet në Medresenë e Madhe në Gjakovë, pranë babait, Myderriz Iljaz Efendiut, deri në vitin 1920, viti kur ndërroi jetë babai i tij i nderuar.

I vijoi studimet në Medresenë “Mehmed Pasha” në Prizren, pranë Myderrizit të shquar Nusret Efendi Galibit, i cili ka qenë Myfti i Prizrenit, kryeqyteti shpirtëror e historik i shqiptarëve...

Gjatë studimeve në Prizren, Fahri Efendi Iljazi, ishte njëri prej studentëve më të zgjuar, më të talentuar, aq sa, ka ndodhur shpesh, në mungesë të myderrizëve, edhe myderrizët i ka zëvendësuar...! Me përfundimin e studimeve, me sukses shembullor, përveç diplomës e

përfitoi edhe titullin e nderuar, titullin e çmuar: Myderriz. Këtë titull të çmuar, si sot akademik, për ta fituar, iu nënshtrua provimit para komisionit të përbërë nga tre myderrizë, siç janë: Myderriz Rexheb Efendi nga Mitrovica, Myderriz Ataullah Efendi nga Shkupi dhe Myderriz Nusret Efendi Galibi nga Prizreni.

Shërbimet dhe vlerësimet

Që nga janari i vitit 1930 e deri në vitin 1948, kur e mbyllën komunistët, Hafiz Fahri Efendi Iljazi ka qenë Myderriz, udhëheqësi kryesor, në Medresenë e Madhe të Gjakovës, e cila i ka dhënë dritë tërë Kosovës...

Gjatë 18 vjetëve sa shërbeu në Medresenë e Madhe në Gjakovë, ku kanë studiuar 93 studentë, nga të gjitha trevat shqiptare, mësimi zhvillohej në gjuhën shqipe. Në programin arsimor të Medresesë, Hafiz Fahri Efendia, përveç lëndëve që ishin në të kaluarën, futi lëndë të reja, si Kelami (Apologjetika) Ilmul-Feraiz (E drejta trashëgimore), Filozofia Islame, Tesavufi Islam, Fizika, të cilën e ligjëronte Beqir Efendi Baraku, i cili ka qenë edhe poet...!

Në vitin 1938 doli gjenerata e parë e të diplomuarve nga Hafiz Fahri Efendia dhe për këtë ngjarje nga Sarajeva, erdhi një delegacion me në krye Reisin (Kryetarin) Xhemaludin Çausheviç dhe mysafirë të shquar nga të gjitha trevat shqiptare, të cilët qëndruan bashkërisht tre ditë në Medrese, në Gjakovë. Të diplomuarit e gjeneratës së parë nga Gjakova janë: Hafiz Teufik Ef. Nahi, Hafiz Selim Ef. Yvejsi, Jahja Ef. Bakalli dhe Qamil Ef. Ferizi.

Shumica prej nxënësve të Myderriz Fahri Efendiut, pasi kanë diplomuar, u bënë dijetarë të shquar, atdhetarë e luftëtarë të dalluar, prej tyre vlen të përmenden disa emra të paharruar si: Mulla Zekë Bërdynaj, ish i burgosur politik për çështje kombëtare, Mulla Ramush Shatri, Haxhi Jahja Daci, Mulla Iljaz Broja, Hafiz Muhamed Gashi, Mulla Ragip Ademi, Mulla Hajriz Demaku etj.



Myderriz, Hafiz Fahri Ef. Iljazi, ulur në mes, me nxënësit e tij në Medresenë e Madhe në Gjakovë, i pari majtas, ulur, Hafiz Selim Yvejsi, fotografuar në vitin 1937

Në vitin 1948 u mbyll me dry Medreseja e Madhe e Gjakovës nga komunistët, me arsyetim banal se kinse nuk i plotëson kushtet higjienike...! Megjithëkëtë, Hafiz Fahriu e vazhdoi edhe për dy-tri vjet në fshehtësi mësimin me disa studentë të rinj...!

Më 15 nëntor të vitit 1957 në Sarajevë, u zgjodh kryetari i ri i myslimanëve të ish-Jugosllavisë, Haxhi Sulejman ef. Kemura. Kurse më 8 dhjetor 1957, u zhvillua në Sarajevë ceremonia në Begova Xhaminë pranimit të detyrës dhe betimit. Për këtë ngjarje me rëndësi, ishin ftuar në Sarajevë, me rastin e shpalljes, betimit, të Reisit (kryetarit) të ri të Bashkësisë Islame për Jugosllavi, Sulejman Efendi Kemura, përveç delegacioneve vendore, kishte edhe delegacione nga vende të ndryshme arabe-islame, ishte caktuar që Hafiz Fahri Efendia nga Gjakova të lexonte tekstin e Betimit (Menshura) në gjuhën arabe, ashtu edhe ndodhi. Kjo nuk ishte rastësi, por ishte një vendim me rëndësi nga di-

jetarët që kuptojnë, që dinë të vlerësojnë dijetarët, vlerat e një personaliteti të shquar të Kosovës, siç ishte Hafiz Fahri Efendia i Gjakovës.

Në vitin 1963, një delegacion fetar nga ish-Jugosllavia viziton Marokon, ndër anëtarët e delegacionit ishte edhe Hafiz Fahriu, aty i pret Mbreti i Marokut Hasani i Dytë dhe kur foli Hafiz Fahriu në gjuhën arabe, pastër, rrjedhshëm, me maturi dhe zgjuars, mbreti mbeti i habitur...! Pas disa vitesh, Mbreti Hasan i Dytë, e kishte pyetur Fadil Hoxhën në Maroko: “A e njeh Hafiz Fahri Efendiun, është nga vendi i juaj? Po, bile jemi nga i njëjti qytet, nga Gjakova, ishte përgjigjur Fadil Hoxha. Kurse, Mbreti Hasan i kishte thënë: “Një kokë si e tij, plot urtësi, i mjafton vendit tuaj!”

Veprimtaria e Hafiz Fahriut është shumë e gjerë, është shumë e gjatë, ka shërbyer me përkushtim, mbi gjysmë shekulli, ditë e natë...

Ka shërbyer si imam në disa xhami, ka shërbyer si kryeimam i Gjakovës, edhe i një pjesë të Kosovës, që quhet Dukagjin, duke përfshi Pejën, Istogun deri në Klinë.

Hfz. Fahri efendija ka dhënë fetva të shumta në lidhje me çështjet e së drejtës trashëgimore sipas Sheriatit, ngase ka qenë njëri ndër njohësit më të mirë të kësaj lëmie në Kosovë e më gjerë.

Ka qenë kryetar i Këshillit të Bashkësisë Islame të Gjakovës, gjithashtu, ka qenë anëtarë shumëvjeçar në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës...

Ka shërbyer për shumë vite në Xhaminë e Hadumit, e cila është xhamia e parë e Gjakovës, bukuroshja e Kosovës, themeluar më 1594, nga një shqiptar, nga Sylejman Efendiu, apo siç njihet në popull me emrin Hadum Aga.

Në Xhaminë e Hadumit, që kur isha fëmijë, i kam përcjellë në vazhdimësi, ligjëratat, hytбет, predikimet e tij. Predikimet e tij kanë qenë në nivel superior, ishte klasik, por edhe bashkëkohor. Gjithnjë ka qenë i përgatitur, çdo fjali e tij ishte e ndritur...Kurrë s’ka folur me hame-ndje, përherë dëgjohej me respekt e vëmendje...!



*Hafiz Fahri Ef. Iljazi (1903-1985)
me nxënësin e kushëririt të tij, Hafiz
Selim Ef.Yvejsi (1913-2001)
Fotografue më 1970, Gjakovë*

Hafiz Fahri Iljazi, ishte një personalitet i madh, si një figurë e shquar, gjithnjë ka qenë i vëzhguar, i përgjuar, nga kundërshtarët, që ishin anti-fetarët, anti-shqiptarët...

Përveç veprimtarisë fetare, edukative, arsimore, Hafiz Fahri Efendiu është marrë edhe me veprimtari kulturore. Rreth vitit 1950, e ka bërë transkriptimin në gjuhën shqipe të veprës “Vehbi-je” (Dhuratë), të myderriz Tahir Efendi Gjakovës, shkruar e botuar në Stamboll, më 1835. Ka qenë anëtar i komisionit për transkriptimin e parë të Mevludit të Tahir ef. Popovës dhe shqipërimin e fjalëve të huaja që janë përdorë në te, botuar në vitin 1965 nga Shoqata Ilmije në Pri-

shtinë, që këndohet nëpër të gjitha trevat e Kosovës. Ka marrë pjesë në marrjen e vendimit për botimin e të parit doracak “Ilmihal i Vogël”, që është botuar në Prishtinë, më 1957, nga Shoqata Ilmije. Ka lënë në dorëshkrim veprën “Jasin”, përkthim nga gjuha arabe, por me komentim...

Emri i Myderrizit, Hafiz Fahri Iljazi, si një dijetar, si një personalitet i rrallë, përmendet me nderim edhe sot e kësaj dite, jo vetëm në Gjakovë, jo vetëm në Kosovë, por që nga Shkodra deri në Vlorë, nga Sarajeva në Shkup, Dibër, Tetovë deri në Stamboll...!

Hafiz Fahriu ndërroi jetë më 19 nëntor 1985, në moshën 82-vjeçare. Shërbimet e fundit mortore, në këtë jetë të përkohshme tokësore, i kreu kushëriri i tij, nxënësi i tij, Hafiz Selim Ef.Yvejsi. Në për-

cjelljen e fundit, përveç popullit, morën pjesë të gjithë hoxhallarët e Gjakovës, morën pjesë hoxhallarët nga çdo anë e Kosovës.

Atë ditë, komunistët e Gjakovës, duke parë gjithë atë popull, qindra hoxhallarë, shejherë, dukeshin të tronditur, sepse këtë nuk e kishin pritur, vështronin si të hutuar me sy, ishin bërë si pulat pa krye...!

Namazi i xhenazës u fal pranë Xhamisë së Hadumit, ku oborri ishte mbushur përplot xhematli, ndërsa u varros në varrezat e oborrit të Xhamisë, Xhamisë së Hadumit, ku kishte shërbyer me përkushtim, derisa i erdhi ftesa prej Krijesit për n'Amshim...

Ky burrë, ky dijetar, pedagog, atdhetar, që ende përmendet me dashuri, e meriton që së paku një rrugë, një shkollë të emërtohet me emrin e tij të nderuar Hafiz Fahri Iljazi...

Kanë thënë për Medresenë e Madhe të Gjakovës*



Medreseja e Madhe në Gjakovë

Medreseja e Madhe e Gjakovës shquhej, jo vetëm si një objekt madhështor, ku në kompleksin e saj përballë Çabratit, ka një sipërfaqe të madhe, brenda së cilës ndodhet xhamia, biblioteka, mësonjëtorja, zyrat e administratës, konvikti për nxënësit, ushqimorja, në mes të oborrit përplot gjelbërim, lule, gjendet shatërvani, por për më tepër

* Medreseja e Madhe në Gjakovë sot shërben si institut për mësimin e Kur'anit përmendësh - për hafiz.

shquhej për nga niveli i lartë intelektual i myderrizëve të saj, që nga Yvejs Efendiu deri te Fahri Efendiu.

Për afro tre shekuj në këtë medrese, edhe pse tekstet mësimore dhe literatura profesionale, sikurse në mbarë Perandorinë Osmane, ishin në gjuhën arabe, osmane dhe perse, kurse shpjegimi i mësimëve, që nga alfabeti deri te përfundimi, diplomimi, zhvillohej në gjuhën shqipe. Lidhur me këtë, ish-nxënësit, studentë të medresesë, duke bërë krahasim midis Medresesë së Mehmed Pashës në Prizren dhe Medresesë së Madhe në Gjakovë, kanë deklaruar:

"Po nuk dite turqisht në Medresenë e Prizrenit, nuk ke mujt me kuptue mësimet, kurse, po nuk dite shqip, nuk ke mujt me kuptue mësimet në Medresenë e Madhe në Gjakovë."

Myderrizët e Medresesë së Madhe të Gjakovës, sikur edhe studentët e tyre, ishin besimtarë, dijetarë, atdhetarë, ishin pedagogë me edukatë e devotshmëri, si të tillë kanë lënë emër në histori. Veprimtaria e tyre nuk kufizohej vetëm në anën arsimore-fetare, por ajo shtrihej edhe në anën kulturore-atdhetare.

Myderrizët e shquar të Medresesë së Madhe të Gjakovës si Myderrizi, Hafiz Ismail Efendi Yvejsi dhe Myderrizi, Hasan Efendi Shllaku ishin pjesëmarrës të shquar në "Lidhjen e Prizrenit" (1878-1881), sikur ishte edhe ish-studenti i Medresesë së Madhe të Gjakovës, Mulla Haxhi Zeka, madje ky burrë fetar e atdhetar ishte udhëheqës i Besëlidhje Shqiptare "Besa-Besë" në Pejë më 1899.

Në vitin 1941, një delegacion i Komunitetit Mysliman Shqiptar me qendër në Tiranë, nën udhëheqje e dr.Behxhet Shapatit, vizituan Medresenë e Madhe të Gjakovës, e cila udhëhiqej nga Myderriz Fahri ef.Iljazi:

"Myderrizi (Fahri ef. Iljazi) së bashku me popullin dhe prijësit fetarë na udhëhoqën për në Medrese, pranë së cilës kishin dalë dhe ishin rreshtuar një grup studentësh duke na uruar mirëseardhje.

Qetësi e gëzim, të një ritmi fetar, konstatuam në fytyrat e tyre. Na çuan në sallën e Medresesë, sallë kjo e shtruar mirë dhe pastër. Këtu gjtëm të gjithë rehatinë për të cilën ka nevojë udhëtari.

Këtu pamë edhe programin e Medresesë, të cilin e gjetëm krejt të plotësuar e sidomos në disa mësimet si në Filozofi Islame, Etikë, Jurisprudencë Islame etj., të cilat duhet vihen edhe në Medresenë e Përgjithshme në Tiranë.”

(Revista “Kultura Islame”, Nr. 3, Tiranë, 1941)

Kanë thënë për Hafiz Fahri ef. Iljazin

Prof. Fejzullah Haxhibajriç nga Sarajeva, në librin e tij “Nekrolozi” ndër të tjera thotë:

“Sipas meje, e them me plot bindje se Hafiz Fahri Efendiu është njohësi më i madh i tesavufit dhe jurisprudencës islame në Ballkan. Nuk e ka njohur dhe komentuar Ibën Arabiun më mirë se ai askush në Ballkan”.



Hafiz Fahri Iljazi, në ballë, gjatë një manifestimi fetar, me shejhlërë e hoxhallarë në Xhaminë e Hadumit në Gjakovë, më 1966. Në fotografi dallohen: Myderriz Hasan ef.Nahi, Baba Qazim Bakalli, Mulla Tahir ef.Thaçi, Hafiz Selim Yvejsi, Mulla Sadik Brovina, Shejh Hakiu...

Në një intervistë me Hajriz Demakun, ish-nxënës i Hafiz Fahri Efendiut, ish-luftëtar i Shaban Polluzhës, babai i shkrimtarit të njohur

Daut Demaku, nga Drenica, gazetari e pyet: “Mixha Hajriz, kush është për ty më i pari për pushkë, trimëri dhe dituri?”

Mixha Hajriz tha: Për pushkë e trimni si Shaban Polluzha s’ka, kurse për ilm, dituni si Hafiz Fahri Efendija i Gjakovës, shtatë shokë myderrizë, s’ka asnjë! Këtë intervistë mund ta kërkonit në internet, e gjeni lehtë!

Ka thënë Hafiz Fahri Efendija

Myderrizi, Hafiz Fahri Efendija, që kur ishte i ri ishte enciklopedi, këtu mjafton të shënojmë tri thënie të tij!

“Nuk na mbetet tjetër veçse ta dojmë, ta ndërtojmë dhe ta çmojmë njani-tjetrin”

“Të zhvillohemi në pikëpamje shpirtnore, intelektuale dhe atdhetare.”

“Ditunija asht arma më e fortë kundër anmikut”

Burimet kryesore:

- Revista "Kultura Islame", Nr.3, Tiranë, 1941, Revista "Glasnik" Vrhovnog Islamskog Stareshinstva, Nr. 1-2, Sarajevë, 1958
- Dr. Ramiz Zekaj, "Zhvillimi i kulturës islame....gjatë shek.XX" Tiranë, 1997
- Jusuf Bajrakatari, "Gjakova me rrethinë" (1878-1912), Instituti i Historisë, Prishtinë, 1998
- "Islami luajti rol me rëndësi në historinë e Kosovës", Intervistë, mr.Qemajl Morina, botuar në revistën "Dituria Islame", Nr.125-126, nëntor- dhjetor, Prishtinë, 2000, faqe:39-40)
- Mexhid Yvejsi, "Kështjellat e gjakut tonë", Gjakovë, 2002
- Prof. Pleurat Krasniqi, "Aspekte kulturore-historike të Gjakovës dhe ixhazet-linjë" (1870-1940), Gjakovë, 2002
- Mexhid Yvejsi, "Ylematë e Gjakovës-Mburojë e Kosovës", Gjakovë, 2003
- Evlia Çelebiu, "Shqipëria dhe viset fqinjë", Tiranë, 2008
- Dr. Masar Rizvanolli, "Çarshia e Madhe –vatër e zhvillimit ekonomik-sho-qëror dhe kulturor të rajonit të Gjakovës", Vjetari, Nr.39-40, Arkivi Shtetëror i Kosovës, Prishtinë, 2008
- Gjakova City & Valbona Valley, Menaxher i projektit: Kujtim Rrahmani, Teksti: Dr.Masar Rizvanolli, Gjakovë, 2010
- Dr. Sc. Nehat Krasniqi, "Kontribute albanologjike, studime dhe dokumente historike e letrare të periudhës osmane", Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2011
- Ismail Rexhepi & Mr.Sadik Mehmeti, "Institucionet islame dhe nëpunësit fetarë në Gjakovë me rrethinë ndërmjet dy luftërave botërore", www.islamgjakova.net/ (30 nëntor 2012).
- Dr.sc. Nehat Krasniqi, "Reflekse të traditës kulturore të vendlindjes në personalitetin e Hasan efendi Nahit", "Edukata Islame", nr.99, Prishtinë, 2012, f.157-167.
- Mexhid Yvejsi, "Hafizët e Gjakovës – krenaria e Kosovës", Gjakovë, 2013

Mexhid Yvejsi

**On the 110th anniversary of the birth
of the distinguished scholar
MUDERIS, HAFIZ FAHRI EF. ILJAZI (1903-1985)**

(Summary)

MUDERIS, HAFIZ FAHRI EF. ILJAZI was one of the best learned hodjas not only in Gjakova/Kosova but throughout the Albanian lands. In brief, he was a distinguished scholar, the hodja of hodjas!

مجيد عويسى

بمناسبة احياء ذكرى ١١٠ سنة من ميلاد العالم الجليل المدرس

حافظ فخرى الياسى (١٩٠٣-١٩٨٥)

(خلاصة البحث)

كان المدرس حافظ فخرى الياسى من العلماء أكثر دراية و أكثر اشراقا ليس على نطاق جاكوفا و ليس على نطاق كوسوفا و لكن هو كان من افضل العلماء على مستوى أمتنا الالبانية . يمكن ان نقول باختصار كان عالما جليلا و شيخ المشايخ .

RECENSION

Prof. dr. Hysen Matoshi

NJË KURORË NOCIONESH FETARE

Mr. Qemajl Morina: **Glosar i nocioneve fetare (islame, ortodokse, katolike dhe çifute)**, botoi Fakulteti i Studimeve Islame, Prishtinë, 2010, f. 240.

Mr. Qemajl Morina hyn në radhët e atyre studiuesve që e bëjnë punën e tyre pa ndonjë bujë të madhe, pa pompozitetin publicistik që rëndom e shoqëron viteve të fundit nxjerrjen në dritë të ndonjë rezultati në fushën e dijes. Islamologun, profesorin, publicistin, përkthyesin tonë, më shumë se çdo gjë tjetër, në shumësinë e interesimeve e bashkon përkushtimi i rrallë dhe serioziteti ndaj punës. Ndër kontributet e tij të vyera renditet edhe vepra *Glosar i nocioneve fetare (islame, ortodokse, katolike dhe çifute)*, botim i Fakultetit të Studimeve Islame në Prishtinë, më 2010. Ky glosar përbën një ndër sprovat e para të njëmendta të standardizimit të terminologjisë së gjithmbarshme fetare ndër ne. Gjithsesi



standardizimi i terminologjisë është një proces dhe nuk mëtohet të jenë ofruar të gjitha përgjigjet me këtë kontribut të vlershëm. Është i padiskutueshëm fakti se viteve të fundit literatura me përmbajtje fetare është më e pranishme se çdolloj tjetër i botimeve. Jo rrallë vërejmë se si në përdorimin e nocioneve themelore të kësaj fushe ka mosnjohje, një pakujdesi dhe llojlloshmëri edhe brenda të njëjtimit botim, madje edhe kur është fjala për të njëjtin autor. Shkruhen gabimisht, ose shkruhen në dy e tri trajta të ndryshme nocionet e tyre themelore, emrat më përfaqësues të feve, të festave fetare, të vendeve të shenjta etj.

Veçori e një glosari, përveç saktësisë së formës standarde të fjalës ose të togfjalëshit terminologjik, është edhe shpjegimi për domethënien e tij, ngase ndodh shpesh në literaturën që botohet në shqip të përdoret emërtimi i saktë, por në një kontekst të gabuar, si rezultat i mosnjohjes së domethënies, ose edhe i një njohjeje të përcipte të saj. Përveç dimensionit informativ, gjithsesi rëndësia e kësaj ndërmarrjeje, sipas autorit, është edhe e karakterit edukativ. Edukata e drejtë fetare është burim i njohjes më të mirë të tjetrit, rrjedhimisht edhe i tolerancës fetare, sikundër thotë teologu zviceran Hans Küng, mendimi i të cilit i ka shërbyer autorit tonë si një moto orientuese në punën e tij. Sigurisht që një shtysë tje-

tër për t'iu rrekur kësaj pune ka të bëjë edhe me përdorimin e pasaktë të terminologjisë fetare te ne (në botime, në medie etj.) ndonjëherë edhe me mosnjohje të koncepteve themelore bartëse të kësaj fushe, pa përjashtuar edhe deformimet e qëllimta e tendencioze në disa shkrime. Ndaj, ky glosar është një ndihmesë e mirë për ata që duan të informohen drejt lidhur me domethënien e nocioneve kryesore fetare, por edhe një pengesë e pakalueshme për ata që synojnë ta shtrembërojnë esencën e tyre.

Nisur nga nevoja për një qasje profesionale, Qemajl Morina i është përveshur punës së vështirë të identifikimit të nocioneve themelore fetare, të shpjegimit të saktë të domethënies së tyre dhe të përfshirjes në një kontekst të përbashkët botimi. Glosari që do të përfshinte vetëm nocionet e njërës nga fetë e shpallura, të cilat në shkrimet e kësaj natyre përdoren gjithandej ndër shqiptarët, do të ishte gjithsesi i mangët, prandaj autori ofron material të nocioneve të katër feve: islame, ortodokse, katolike dhe çifute. Në vëllimin me rreth 240 faqe janë trajtuar 1475 fjalë, nocione ose togfjalësha terminologjike, që, ndonëse nuk e shterin tërësinë e nocioneve fetare, janë një bazë e mirë për trajtime edhe më përimtuese e më gjithëpërfshirëse në të ardhmen.

Në tërësinë e përmbajtjes së *Glosarit* vend të veçantë kanë gjetur edhe emrat e përveçëm, me të cilët, apo me trajtat e të cilëve, identifikohen fetë e përfshira në të. Për figurat historike autori është kujdesur që të ofrojë të dhënat kryesore biografike dhe karakteristika të veprimtarisë së tyre, me ç'gjë kontributi i tij merr, në njëfarë dore, edhe një dimension enciklopedik.

Në punën shkencore ka vepra që shkruhen për një periudhë të caktuar kohore, për realizimin e tyre nevojitet të ndahet një kohë e caktuar. Mirëpo, glosarët, fjalorët, enciklopeditë, janë vepra që përmbledhin gjithë përvojën jetësore të një autori, njohjen shteruese të çështjeve të bazuar në burime të shumanshme. Pra, kemi të bëjmë me njëfarë kurorëzimi të kërkimeve. Nëse do të shohin bibliografinë për secilën pjesë të këtij glosari, të konceptuar sipas feve, do të bindemi për një punë gjigante, për literaturë prej dhjetëra mijëra faqesh, të cilat këtu vijnë të sintetizuara në trajtë definicionesh prej një fjalie, ose prej disa sosh, varësisht nëse bëhet fjalë për një nocion të njohur, apo nocion që më rrallë është ndeshur në shkrimet tona. Zërat e këtij *Glosari* diferencohen në të vegjël dhe të mëdhenj, varësisht nga rëndësia e tyre që kanë në fenë e caktuar.

Glosari i mr. Qemajl Morinës është një përpjekje për ta ndrequr gjendjen e

shfityruar të terminologjisë fetare në fjalorët e hartuar të gjuhës shqipe në periudhën komuniste e nën diktatin ideologjik që shquhej për antifetari-zëm, përkatësisht që kishte si pikë nisëse në interpretimin e nocioneve themelore të fesë pozicionin ateist ndaj tyre. Autori, ndonëse islamolog në fushën dijes, u qaset drejt dhe pa-anshëm këtyre deformimeve, pavarësisht nëse kanë të bëjnë me islamin, apo me krishterimin. Duke afirmuar disa nga përmirësimet e bëra në botimet e kohëve të fundit të fjalorëve të shqipes, autori i *Glosarit* tërheq vërejtjen se recidivë të kësaj mendësie të dëmshme mund të hasen edhe në versionet e reja të fjalorëve, veçmas në shembujt e marrë nga frazeologjia jonë. Prandaj, e themi me bindje të plotë se *Glosari* është një kontribut i vyeshtëm edhe në pikëpamje të njohjes së drejtë të fesë dhe vlerësimit të rolit të saj në shoqërinë njerëzore.

Glosari i Qemajl Morinës, përveçse i shkruar me profesionalizëm dhe dashuri për materien që e trajton, është edhe një vepër në të cilën del në pah mjeshtëria e përkufizimit të nocioneve. Gjuha e lehtë dhe rrjedhshme, qartësia e definimit, saktësia e shprehjes janë vetëm disa nga vlerat e kësaj ve-pre. Ndonëse veprat e këtilla janë të tejkohshme, synimi për t'i qortuar disa trajta shprehjesh që aktualisht ndeshen gjithandej e ndërlihd drejtpërdrejt pu-

nën e autorit me kontekstin tonë të sotëm.

Përfundimisht, themi se kjo vepër e Qemajl Morinës përbën një kontribut të rëndësishëm për zotërimin e duhur e të saktë të terminologjisë fetare, por, gjithashtu, një meritë tjetër është edhe vizioni i tij për të ecur tutje në këtë drejtim. Autori sugjeron që punën e tij

prej pionieri ta vijojnë ekipet e përbashkëta të ekspertëve të gjuhës dhe të fesë. Urojmë që kjo punë e mbarë, në të mirë të thellimit të njohurive nga fusha e fesë, të nisë një ditë e më parë, sepse vetëm kështu dija jonë për fenë bëhet më e saktë, ndërsa gjuha shqipe më e pasur.

RECENISON

Prof. dr. Sabile Keçmezi-Basha

DËSHMI PËR KONTRIBUTIN E PRIJËSVE MYSLIMANË NË FORMIMIN E IDENTITETIT KOMBËTAR (Recension: “Kontributi i prijësve myslimanë në formimin e vetëdijes dhe identitetit kombëtar”, Tiranë, 2013, f. 307)

Vit më parë në Tiranë ishte organizuar konferenca shkencore me një titull shumë të rëndësishëm por edhe shumë meritore siç ishte “Kontributi i prijësve myslimanë në formimin e vetëdijes dhe identitetit kombëtar”, dhe vërtet ishte plotësisht i arsyeshëm emërtimi, ngase të gjithë ne e dimë se çfarë roli dhe çfarë pune e veprimtarie kanë pasur dhe kanë zhvilluar prijësit dhe kleri mysliman për formimin e vetëdijes dhe ruajtjen e identitetit kombëtar.

Thënë të drejtën gjatë punës sime hulumtuese shkencore më ka rënë të lexoj shumë biografi të atdhetarëve nga komuniteti mysliman dhe ndikimin e tyre që kanë pasur te xhemati i tyre, por shumë pak që të lexoj shkri-

me nga ndonjë konferencë shkencore, siç ishte kjo e Tiranës, e organizuar më 28-29 shtator të vitit 2012. Mreku-



llia e kësaj konference ishte se organizimin e saj e kishin bërë: Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Bashkësia Islame e Kosovës dhe Bashkësia Fetare Islame e Maqedonisë, thënë më ndryshe një unitet i përkryer, ashtu siç është dashur kaherë që të jetë dhe sinqerisht uroj që kjo nismë e mbar të mos ndalet asnjëherë. Historia na ka imponuar shumëçka, për të mos thënë se okupuesit dhe ideologjia komuniste kishte prekur aty, ku më së pakti duhej të cenohej e drejta e qytetarit të lirë, dhe me dashje kishte krijuar hendeqe që edhe sot po i ndejmë pasojat.

Në konferencë ishte premtuar se të gjitha kumtesat dhe diskutimet do të botohen në një përmbledhje të veçantë, dhe ky libër që po e promovojmë sot është rezultat i punës shumëvjeçare të studiuesve të mirëfilltë.

Libri “Kontributi i prijësve myslimanë në formimin e vetëdijes dhe identitetit kombëtar”, ka 307 faqe, ndërkaq në bazë të punës së konferencës që është zhvilluar në sesione, po ashtu edhe ndarja e librit ka këtë përmbajtje. Veç fjalës së hapjes të cilën e kishte mbajtur kancelari i Komunitetit Mysliman Shqiptar, Ali Zaimi, konferencën e kishin përshëndetur dhe madhëruar me praninë e tyre edhe: Haxhi Selim ef. Muça, kryetar i KMSH-së, Naim ef. Tërnavë, myfti i Kosovës, Sulejman ef. Rexhepi, Reis ul Ulema i BFI-së së Maqedonisë, Rifat ef. Fejz-

iç, kryetar i Bashkësisë Islame në Mal të Zi, prof.dr. Sali Berisha, kryeministër i Shqipërisë dhe me telegram urimi ishte prezent mr. Muhidin Ahmeti, kryetar i Unionit të Shqiptarëve Mysliman në Austri.

Në prezantimin e të dhënave për figurat e shquara atdhetare nga komuniteti islam u vlerësua lart roli dhe kontributi i tyre në përpjekjet për pavarësinë e vendit dhe në konsolidimin e shtetit të ri shqiptar në këto 100 vjetët e fundit dhe qëllimi i konferencës ishte që të shënohet 100-vjetori i shtetit shqiptar.

Në konferencë, seanca e parë iu kushtua temës “Roli i dijetarëve fetarë në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare”, që me temat e tyre u paraqitën 6 referues, që sollën prurje të reja për rolin e prijatarëve fetarë në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, ku përfshiheshin: prof. dr. Bajram Xhafa, “Pozita e shtetformimit në fillimshkullin XX”, dr. Nehat Krasniqi, “Roli i dijetarëve fetarë në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare”; dr. Fahrush Rexhepi, “Roli i ulemasë në rrjedhat shoqërore politike në periudhën e pavarësisë”; Mr. Ruzhdi Lati, “Kontributi i ulemave dibranë në shpalljen e pavarësisë”; Prof. dr. Mahmut Hysa, “Ecuria procedurale e mbledhjeve të Kuvendit të Vlorës”.

Seanca e dytë u kushtojë Fesë dhe Atdheu, me gjithsej 5 tema, në të cilën referuan doktorët e shkencave që

hapën dhe debatuan për raportet “Feja dhe atdheu”, në të cilën dominoi e dhëna se pa atdhe nuk ka fe. Në këtë seancë referatet e tyre i paraqiten: dr. Enis Sylstarova, “Për fe dhe atdhe”: Argumentet e klerit mysliman në debatin mbi modernizimin e Shqipërisë në vitet 20-30 të shek. XX; akademik dr. Feti Mediu, “Hafizët e Kur’anit në shërbim të vatanit”, prof.dr. Valentina Duka, “Institucionet fetare islame gjatë mbretërimit të Ahmet Zogut”; “Një vështrim të legjislacionit të kohës (11928-939)”, prof.dr. Zejnullah Gruda, “Krimet njëshekullore mbi popullatën shqiptare- (nxitja e urrejtjes ndaj boshnjakëve myslimanë dhe shqiptarëve-preludi i krimeve të rënda)”, dhe prof. dr. Adem Zejnullahu, “Dhuna fetare serbo-malazeze mbi shqiptarët pas shpalljes së pavarësisë”.

Seanca e tretë, njëherë edhe tema e saj ishte më provokuesja, ngase bënte fjalë për “Kontributin i prijësve myslimanë për gjuhën shqipe”, në të cilën u trajtuan dhe u sollën të dhëna të reja për gjuhën shqipe dhe shtetformimin në veprat e dijetarëve islamë. Temat që u paraqitën në këtë sesion ishin: doc. dr. Ismet Osmani, “Gjuha shqipe dhe shtetformimi në veprat e dijetarëve islamë”; prof. dr. Avzi Mustafa, “Kontributi i ulemasë shqiptare në Maqedoni për shkollën dhe gjuhën shqipe”; prof. dr. Mehdi Polisi, “Kontributi i Hafiz Ali Ulqinakut në arsi-

min shqip”; prof. asc. dr. Genciana Abazi, “Mbi përpjekjet dhe pasurimin e gjuhës shqipe në gjysmën e shekullit XIX”, Dervish Sali Ashkiu nga Tepele, dhe tema e fundit e seancës ishte: “Kontributi i klerit mysliman shqiptar në hartimin e abetareve të gjuhës shqipe nga mr. Hasan Bello.

Ndërsa seanca e katërt i kushtohej tolerancës fetare dhe lirisë së fesë, në të cilën referuan shumë profesorë për tema të cilat deri më tani kishin qenë të paeksploruara. Tema nga prof.dr. Ferit Duka, “Toleranca dhe mirëkuptimi ndërfetar si dimension i historisë kombëtare të shqiptarëve”

zgjoi interesim të pranishmit dhe ishte mu ajo e cila me argumente dëshmoi se asnjëherë gjatë historisë ndër shqiptarë nuk ka qenë molla e sherri feja, por anasjelltas. Po ashtu tema, nga prof.dr. Gjergj Sinani, “Liria e fesë në kontekstin e modelit evropian të marrëdhënieve ndërmjet shtetit dhe fesë solli risi në shoqëritë e lira demokratike, se liria e fesë shikohet si një tregues i rëndësishëm i shkallës së lirisë demokratike që karakterizon një shoqëri.

Një temë me shumë interes ishte “Toleranca fetare në Vilajetin e Kosovës dhe shpallja e pavarësisë së Shqipërisë 1908-1912” nga mr. Nuredin Ahmeti, që përfshinte një periudhë që i parapriu pavarësisë së shtetit shqiptar, duke ardhur në përfundime shumë

të rëndësishme për tolerancën ndërfetare në njërin anë dhe kontributin e prijësve fetarë në Lëvizjen Kombëtare në Vilajetin e Kosovës, gjatë viteve 1908-1912, që ishte jashtëzakonisht i madh. Edhe kumtesa e doc.dr. Qani Nesimit, “Rëndësia e revelatës hyjnore në mbrojtjen e identitetit kombëtar dhe rreziku nga qasja epistemologjike-antropocentrike- rasti Hafiz Ali Korça”, që trajtoi bipolarizimin në vlerësimin e njeriut, në veçanti, dhe vlerave shoqërore, në përgjithësi, gjithnjë duke u bazuar në mendimet e Hafëz Ali Korçës.

Me të dhëna nga hulumtimet e shumta që janë bërë në arkiva të ndryshme e literatura relevante, studiuesit u paraqitën në seancat e më vonshme që vërtetonin se kontributi i dijetarëve myslimanë në mbrojtje të trojeve shqiptare ishte i jashtëzakonshëm. U referua kumtesa për kontributin e Hoxhë Hasan Tahsin (Filati) në mbrojtje të trojeve jug-shqiptare të Çamërisë nga aneksimi dhe kolonizimi grek, nga prof. dr. Selman Sheme. Duhet përmendur edhe këtë veç angazhimit në mbrojtje të tokave shqiptare, Hoxhë Hasan Tahsin më 1870, u zgjodh rektori i parë i Universitetit të Stambollit, për gjerësinë e diturive që zotëronte si dhe për aftësinë e tij intelektuale. Për veprimtarinë e tij atdhetare Hoxhë Tahsin u përndoq dhe u burgos, por ai nuk u largua nga bindjet e tij shke-

ncore dhe rrugën e tij për zhvillimin e kulturës dhe për afirmimin e kërkesave kombëtare të shqiptarëve.

Mr. Qemal Morina kishte paraqitur temën: “Kontributi i Hoxhë Kadri Prishtinës në mbrojtjen e tërësisë së tokave shqiptare”, që po ashtu ishte një trajtim shkencor, ku vihen në pah meritat e pamohueshme të Hoxhë Kadriut pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore, dhe duhet cekur se më 1 maj 1918, formoi në ilegalitet komitetin “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”, me seli në Shkodër, që të jetë sa më afër Kosovës, thoshte hoxhë Kadriu. Ndërsa programi politik i kësaj organizate ishte kombëtar dhe angazhohej për tërësinë territoriale të shtetit shqiptar.

Sipas programeve të shumta serbe e që ishin kryekëput antishqiptare, për të asimiluar dhe zhdukur popullin shqiptar parashihej edhe shpërngulja e tyre me dhunë për në Turqi. Qëllimi dhe lufta e prijësve fetarë në Shkup, ishte që të ndalojnë shpërnguljen e madhe të shqiptarëve, andaj në kushte të pa kushte zhvilluan një aktivitet me plot rreze për të bërë fushatën e bujshme kundër shpërnguljes. Mu kësaj plaje i kushtohej tema e Mr. Qerim Litës, “Shpërngulja e shqiptarëve për në Turqi 1937-1941 dhe roli i bashkësisë islame në pengimin e saj”.

Mobilizimi shoqëror i krerëve fetarë myslimanë të shqiptarët (jashtë kufijve etno-shekullor të shqiptarizms)

ishite kumtesa që e paraqiti mr. Kushtrim Shehu, e cila ishte elaboruar historikisht nga fillimet e lëkundjes së themeleve të shtetit osman, e deri te lindja e lëvizjeve kombëtare dhe angazhimi i krerëve fetarë shqiptarë për ruajtjen identitetit kombëtar.

Seanca e gjashtë, kishte trajtuar temën e prof. dr. Hysen Matoshit, “Kontributi për vetëdijesimin kombëtar shqiptar”, në të cilën në mënyrë kritike e analitike u rrahën çështje të rëndësishme nga periudha të ndryshme historike. “Pavarësia në shkrimet letërore të ulemave shqiptarë” bënte analiza e vlerësonte se njëra ndër të metat kryesore të shqyrtimeve lidhur me identitetin shqiptar është edhe kundrimi i pjesshëm i tij. Shembull tipik i deformimit të këtillë është trajtimi që i është bërë identitetit tonë kombëtar në periudhën e komunizmit. Ideologjia sunduese e kësaj kohe e konceptonte identitetin kombëtar, si kundërshti të plotë me identitetin fetar. Logjika e këtillë përjashtuese nuk e akceptonte dot mundësinë e të qenit të një individi atdhetar dhe fetar njëkohësisht.

Me interes ishte edhe trajtimi i temës nga prof. dr. Sadri Fetiu, “Uniteti tradicional i shqiptarëve në luftën për mbrojtjen e Shkodrës, sipas epikës historike” si dhe tema nga dr. Agron Tufa, “Fillimet e persekutimit komunist mbi Komunitetin Mysliman Shqiptar”, në të cilën me të drejtë autori konsta-

ton se “zhdukja e fesë ishte thelbësore për injektimin e dogmës komuniste dhe, rrjedhimisht, për krijimin e “njeriut të ri”, e megjithatë, ky “asimilim” apo ky nënshttrim nuk ndodhi sa çel e mbyll sytë. Ai u shoqërua nga një përndjekje e pashembullt e anëtarëve më të ngritur të klerit. Në inventarin e përndjekjes së tyre nuk mungon pa epshmëria, madje, shpesh, ajo u përshatatet përmasave dhe ashpërsisë së përndjekjes. Duhet pasur parasysh se gjithçka zhvillohej në atmosferën e një rrënimi të plotë material, të frikës dhe të dëshpërimit.

Tema nga prof. dr. Gentiana Skura, “Zani i Naltë” dhe kontributi për vetëdijesimin kombëtar shqiptar” trajton kontributin e revistës fetare të përmuajshme “Zani i Naltë”, i cili botohej në vitet 1923- 1939. Duhet cekur se vetë motoja e revistës flet mjaft kur shkruan se “Na të “Zanit të Naltë” kemi le shqiptarë, jemi rritur shqiptar dhe do të vdesim shqiptarë”, mendoi se ndonjë koment tjetër do të ishte i tepërt ngase problematika e trajtuar në këtë gazetë është e lidhur ngushtë me çështjen kombëtare.

Dashuria për tokën dhe fjalën apo për fe e atdhe, i ka burimet në vlerën misionare, që kësaj letërsie i vjen nga librat e shenjtë, si edhe nga vetë individët shkruar, të cilët, në të shumtën e rasteve janë udhëheqës shpirtërorë, klerikë. Prej kënde, fjala është e vër-

tetë dhe individi krijues është misionar, për “fe dhe atdhe”, dhe e tërë kjo trajtohet në temën që e kishte prezantuar mr. Brikena Smajli, “Për fe dhe atdhe” një letërsi vizionare dhe misionare”.

Një pjesë të veçantë të librit zë trajtimi i temave nga: “Kontributi i institucioneve dhe ulemave në çështjen kombëtare”, e që trajtohen në pjesën e shtatë të librit. Duke filluar nga tema e mr. Sadik Mehmeti dhe Ramadan Shkodra, “Institucionet islame në Kosovë në shërbim të çështjes kombëtare”, në rrethana e në kushte të pafavorshme, krahas ulemasë islame, të cilët ose u vunë në krye të shumë proceseve me karakter kombëtar, ose ishin përkrahës të proceseve në shërbim të çështjes kombëtare, u vunë edhe institucionet islame dhe objektet që ishin nën administrimin dhe vartësin e këtyre institucioneve, duke u bërë vatra të përpjekjeve për mbijetesë dhe pavarësi të shqiptarëve.

Tema “Kontributi i prijësve myslimanë në çështjen kombëtare” i autorit mr. Genti Kruja, trajton periudhat e vështira të ecjes kombëtare duke u ndalur në Rilindjen Kombëtare, Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, Kongresin e Dibrës, për të ardhur deri te shpallja e pavarësisë të shtetit shqiptar, dhe padyshim se kësaj epoke të vështirë iu bashkëngjitën edhe dijetarët myslima-

në shqiptarë. Madje, në shumë raste roli i tyre ishte vendimtar.

Trajtim me shumë interes ishte tema e mr. Alban Dobrunës, “Kontributi i dijetarëve islamë në Lidhjen e Dytë të Prizrenit”, ku me të drejtë autori na paraqet figurat më markante të kësaj organizate, që ishin klerikë e intelektualë të besimit islam dhe aspiratat e tij për liri dhe bashkim me trungun amë.

Edhe një temë interesante që prezanton “Kontributi i institucioneve fetare në ngritjen e vetëdijes kombëtare”, e autorit doc. dr. Faredin Ebibi, e cila kishte për qëllim të nxjerrë në pah vlerat e caktuara, kontributin e veçantë të rezistencës patriotike të bijve të këtij populli. Në kuadër të kësaj rezistence dhe lufte të lavdishme, rol të çmueshëm kanë luajtur edhe institucionet me karakter fetar, siç është institucioni hoxhë xhami dhe mekte.

Tema e cila në vete trajton angazhimin dhe kontributin e atdhetarëve islamë ishte “Roli i dijetarëve islamë të Kumanovës, në ngritjen e vetëdijes fetare dhe kombëtare gjatë viteve 1930-1950”, temë nga doc. dr. Naser Ramadani, e cila me një seriozitet të madh na paraqet kontributin e këtyre dijetarëve e që nuk kufizohej vetëm në sferën e arsimit dhe të edukimit, ku një numër shumë i madh i hoxhallarëve, pas Luftës së Dytë Botërore, ishin edhe mësuesit e parë nëpër shkolla

shqipe, por ai përfshinte edhe sfera politike dhe ushtarake dhe kishin ndikim të madh në ngritjen e vetëdijes kombëtare shqiptare.

Andaj, krejt në fund duhet përshëndetur këtë nismë të tri bashkësive fetare myslimane, që organizuan këtë konferencë shkencore, mblodhën dhe grumbulluan në një vend shkencëtarët e njohur për të dhënë kontributin e

çmuar në aspektin shumëdimensional dhe për të ndriçuar një pjesë të historisë së lëvizjeve të mëdha kombëtare për liri dhe pavarësi për ndërtimin e identitetit kombëtar, se me anën e këtyre të dhënave erdhëm në konkludim se e përbashkëta e këtyre personaliteteve ishte sublimimi i besimit dhe dashuria për atdheun.

RECENSION

Refik Gërbeshi

KOMBI DHE FEJA TE SHQIPTARËT

Hyrje

Komponentët komb dhe fe për ne shqiptarët gjithnjë kanë qenë unike por edhe të pasqaruara sa duhet për sa i përket identifikimit me të dyja bashkë. Është mirë që nuk i ndajmë, por edhe nuk veçojmë ndonjërin si fe e shqiptarit, ngase fati e ka dashur që t'i përkasim llojllojshmërisë që në një aspekt janë pasuri kombëtare. Në vijim kam bërë një studim të profesorit të historisë bashkëkohore në Universitetin e Kalabrisë, italianit Roberto Moroko dela Roka, i cili bën një vështrim të gjendjes shqiptare nga Lufta e Parë Botërore në të Dytën, dhe vë në pah nacionalizmin si protagonistin e vetëm të jetës shoqërore shqiptare. Qasja e historisë shqiptare sidomos në këndin e zhvillimit të bashkësive fetare, ndikimin e tyre si dhe karakteristi-

kën e dominimit kombëtar te to, duke mos i shpëtuar edhe keqpërdorimit sidomos të të huajve si edhe lakmitarëve që të jenë në shërbim të përçarjes, por efekti ishte jo edhe aq i fortë. Gjithashtu autori vë në pah edhe gatishmërinë e bashkëpunimit apo përfshirjes në çështjen politike e shoqërore të tri apo katër feve shqiptare siç i quan ai. Gjithsesi pjekuria e elitës shqiptare për të përfshirë këtë element apo edhe për të hequr nga skena në raste te identifikimit me ndonjërin nga fetë.

Identifikimi fetar

Shqiptarët autoktonë nuk identifikoheshin as me gjysmëhënë as me kryqin ortodoks në kohën e Betejës së Kosovës (1389), “kurse serbët të vranin e tyre e shenjtëruan. Kjo në një

mënyrë i hapi rrugët Danubit, kurse princi serb që u mund dhe iu pre koka nga turqit, Llazari u bë për fenë e serbëve ortodoksë Shën Llazar”. Edhe pse tendencat për ta identifikuar shqiptarin si mysliman apo myslimanin si shqiptar në trevat ish-jugosllave, kjo nuk qëndron ngase kishte edhe kombe tjera që i përkisnin këtij religjioni. Nga ana tjetër, Shqipëria hodhi jashtë ligjit çdo doktrinë fetare që nga viti 1967. Fetë te shqiptarët i janë nënshtruar ideologjisë nacionale. “Pikërisht nga këndvështrimi i nacionalizmit dhe aspiratës për një pavarësi kombëtare të plotë. Fetë shqiptare i janë nënshtruar shpeshherë gjyqimit të shqiptarëve, thuajse arsyeja e ekzistencës së tyre duhet të ishte mbështetja ndaj patriotizmit të besimtarëve të tyre”¹. Autori ngrit konkluzionin e “të vjetërve se shqiptarët më shumë janë luftëtarë sesa fetarë” dhe se fe e vërtetë te ta është krenaria, ndërlidhjet me traditën dhe besën e theksuar edhe nga autori shqiptar Sami Frashri, në dramën e paraqitur në skenë, qysh në vitin 1857.² Bajroni kishte dyshuar në fenë e shqiptarëve, dhe kjo reflektonte

sidomos në kohën e Rilindjes apo kur atdheu është në rrezik.

Kisha shqiptare dallonte nga ajo evropiane dhe “nuk është e rastit që në Shqipëri nuk ekziston diçka që t'u ngjasojë, qoftë edhe pjesërisht lëvizjeve katolike të Evropës Perëndimore ndërmjet shek XIX dhe XX dhe Vatikani e dinte se kishte të bënte me një Kishë të veçantë, në të cilën autoriteti dhe disiplina praktikoheshin dhe kuptoheshin ndryshe...”³ Zogu i edukuar në Turqi dhe i profesionalizuar në Evropë, ishte si një kombinim doktrinash, edhe pse me Ataturkun nuk kishte marrëdhënie të mira shtetet e tyre ecnin paralel drejt modernizmit. Në një biografi për mbretin, të shkruar nga Kristo Dako, botuar në Tiranë, me 1937, shkruhej “Shqiptarët kanë qenë gjithmonë tolerantë. Nuk kanë dërdhur kurrë gjak për çështjen fetare. Por, propaganda dhe intrigat e huaja, gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore e kanë bindur popullin për ekzistencën e ndryshimeve fetare. Si pasojë ishte e nevojshme që të rivendosej në zemrën e shqiptarëve ndjenja fisnike e tolerancës dhe jemi krenarë të themi se mbreti ynë i dashur ia arriti ta bëjë edhe këtë gjë”⁴ Të udhëheqës shtetin shqiptar në atë kohë ishte mes dy taburëve, atyre të vjetërve më refleksi-

¹ Roberto Moroko dela Roka “KOMBI DHE FEJA NË SHQIPËRI 1920-1944” Përktheu: Luan Omari, Tiranë m.d f.8.

² George Gawrych GJYSËMHËNA DHE SHQIPONJA –Sundimi Otoman, Islamizmi dhe Shqiptarët 1874-1913, Përktheu: Aurel Manushi Tiran 2007, hyrja.

³ Roberto Moroko dela Roka “KOMBI DHE FEJA NË SHQIPËRI e cit 66,77.

⁴ Po aty 113.

one nga osmanlinjtë por edhe të rinjtë që ishin të shkolluar nëpër Evropë. Dhe padyshim se “*ekzistonte një ekuilibër me të vërtetë pa precedent.*”

Fetë mbronin kombin

Dihet se fetë janë për mbrojtjen e njeriut, andaj kishin edhe rolin për dallimin e shqiptarëve sidomos nga fqinjët, duke ruajtur identitetin e tyre edhe pse nuk kanë pasur asnjëherë identitet të veçantë fetar sikurse fqinjët. Në trojet shqiptare dominon islami pastaj ordodoksizmi, krishterimi e sekte të tjera te shqiptarët daton që nga koha apostolike në shekujt e parë të pas krishtit përmes së cilit shqiptarët përforcuan identitetin e tyre “*Ishte krishterimi ai që me elementet e kulturës greke e romake që bartte i dha një identitet më të fortë popullit shqiptar*”, kurse riti ortodoks ishte i lidhur me Konstantinopojën, Por në 1922 kongresi i ortodoksëve shqiptarë shpalli pavarësinë e kishës kombëtare autoqefale” duke afirmuar ndër të tjera të drejtën e vet për të emëruar peshkopë dhe për të përdorur shqipen si gjuhë liturgjike”⁵. Edhe Islami ishte ai që diferencoi shqiptarët nga popullsia përreth duke kryer ne një farë mënyre si një pritë e padepërtueshme ndaj dyndjes së kulturave të jashtme, funksion

kulturor ruajtës⁶. Është vënë në dukje se “Lëvizjes për pavarësi nuk i kanë munguar shtysa vendimtare nga njerëz fetarë ose të lidhur ne një farë mënyre me fenë që nga vëllezërit Frashëri, tek atdhetarët françeskanë që nga Negovani e Fan Noli” etj. Mehdi Frashëri potenconte se shqiptarët nuk përfaqësojnë fe të veçantë, por janë shtet me të gjitha fetë. Kurse Mbreti Zog kishte sjellë ligjin me 1928. “*Shteti shqiptar nuk ka fe zyrtare, të gjitha fetë dhe të gjitha besimet respektohen dhe garantohej ushtrimi i lirë i tyre...*”⁷

Toleranca fetare - identitet i shqiptarëve

Pretendimet e fuqive si edhe fqinjëve ua mohonin kombësinë shqiptarëve, dhe kjo ishte njëra nga arsyt që te shqiptarët të vijë në dukje bashkëjetesa e toleranca fetare. Një vend i ekspozuar ndaj pushtuesve, i detyruar përherë të mbrohej kundër botës së jashtme, andaj “*në disa periudha si ato të luftës kundër forcave të huaja për shoqërinë shqiptare, fetë pushonin së qeni një pretekst për shtimin e përçarjeve të brendshme të shqiptarëve*” kështu që me të drejtë autori thekson se “*Literatura për historinë e Shqipërisë në epokën moderne bashkëkohore paraqet një numër të madh kontribu-*

tesh në të mire të tezës, se një tolerancë fetare, thelbësore të realizuar nga shoqëria shqiptare...”⁸ Shqiptarët, qoftë myslimanë, ortodoksë apo katolikë etj., e mbronin njëri-tjetrin pavarësisht se pushtuesi mund të jetë i fesë se njërit nga ata si në kohën kur ishin osmanët e përkatësisë myslimane ashtu edhe kur vinin austro-hungarezët apo italianët, shqiptarët dinin t’u dilnin në mbrojtje bashkëkombësve të tyre. Kështu për shkëputje nga Perandoria Osmane ishin jo vetëm ortodoksët e katolikët por edhe myslimanët, edhe atë jo vetëm nga masa e gjerë popullore, por edhe nga prijësit fetarë. Sikurse kundër grekut që ishin ortodoksit apo kundër italianit katolikët. Lëvizjen kundër Vidit pretendonin ta bënin si Lëvizje Islame, e cila donte të vijë një princ nga Sulltanati, por prijësit islamë ishin edhe për shkëputje nga halifati si edhe ata katolikë nga papati apo ortodoksët nga kisha greke. Pra, ata shkelnin parime fetare për të qenë në shërbim të atdheut dhe kombit të tyre.

Fanatizmi është më shumë fisnor se fetar

Një popull që krenar për traditat e veta kulturore dhe për identitetin e vet etnik, kështu që edhe misionarët nga

Roma, Vjena apo Athina, nuk mund të kishin suksesin e duhur, ngase shqiptarët vlerësonin traditat e veta me fanatizëm. Nga ana tjetër, tradita e mikpritjes së malësive të Shqipërisë, si katolikët ashtu edhe myslimanët, sepse ishte fjala pikërisht për një tipar kulturor që nuk varej vetëm nga feja. Fanatizmi që mund të reflektonte te shqiptarët më shumë do të vinte nga rrënjët fisnore e tradicionale,”Legata italiane në Shqipëri në një raport të vitit 1936, për fetë e këtij vendi, argumentonte ekzistencën e një *fanatizmi fetar shumë a pak të mbuluar, por që ndoshta është më tepër fanatizëm fisi sesa feje*”⁹. Edhe gjakmarrja dhe besa të shoqëruara edhe më disa rite tradicionale ishin bartur si në krishterim ashtu edhe në islamin shqiptar. Kleri françeskan ishte ndër me të zëshmit kundër Italisë edhe pse u kishin dhënë shumë ndihma në para “*Prapa shprehjeve të mirënjohjes dhe vlerësimit të kontributeve të jashtme, Kisha shqiptare mbetej xhelozë për traditat dhe prerogativat e saj kombëtare, me një fjalë për shqiptarizmin e vet*”¹⁰

Fetë nën ndikimin kombëtar

Diplomacia austriake kishte vërejtur afërsinë toleruese mes feve shqiptare dhe besën që kishin mes vete për

⁵ Po aty 48,60.

⁶ Po aty 42.

⁷ Po aty 29.

⁸ Po aty 13.

⁹ Po aty 34 shiko fusnotën 62 të Librit.

¹⁰ Po aty 84.

ruajtjen e atdheut. Ministri i jashtëm austriak në Sofje, ndër të tjera shkruante: “Kjo rënie e fanatizmit fetar, hap i mëtejshëm drejt marrëveshjes së tri besimeve mbi bazën e idesë kombëtare”¹¹. Gazetat katolike “Leka” dhe “Hylli i dritës” konsideroheshin thjesht shqiptare dhe kishin merita në fushën kombëtare shqiptare ashtu si kurse ajo Islame “Zani i Naltë” apo “Kultura Islame”. Pjesëmarrja e ortodoksëve në Rilindjen Kombëtare erdhi me tepër nga bashkësitë e diasporës të Rumanisë, Bullgarisë, Egjiptit e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ku greqizimi i ndërmarrë nga Fanari dhe i fuqizuar nga Athina, nuk kishte ndikuar aq thellë sa në atdhe. Andaj, “*Jashtë sistemit të mileteve osmane, grekët nuk mundeshin më të mbronin tezën se të gjithë ortodokset shqiptarë ishin bashkatdhetarë të tyre.* (grek R.G)”¹². Është më se reale që besimtarët të mos i presin mirë reformat apo ndryshimet për fetë që i bënin ideologët e kombit apo prijësit, siç ishte rasti i ortodoksit Fan Noli, për kryerjen e liturgjisë në shqip, pastaj prijësit islam që bënin shkëputjen nga Halifati, apo që luftonin Sulltanin apo edhe katolikët që refuzonin prijësit italianë. Shqiptarët ishin treguar të kujdesshëm sidomos në përfaqësimet politike e shtetërore si në kohët kur donin t’i etiketonin me

ndonjë fe të veçantë ashtu edhe në delegacionet e ndryshme shtetërore apo edhe drejtuese të shtetit. Delegacioni shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris 1920-1921, përbëhej nga katër veta, një për çdo besim fetar, që kryente funksionin e organit më të lartë të shtetit¹³. Ipeshkvi Bumçi ishte kryesues i delegacionit shqiptar në Versaj, duke garantuar atje se *katolikët shqiptarë nuk donin të jetonin të ndarë nga bashkëqytetarët e tyre myslimanë, por të jetonin së bashku vëllazërisht*”¹⁴

Ligji mbi bashkësitë fetare

Politika e Zogut ndaj bashkësive të ndryshme fetare kishte për objektiv kontrollimin e tyre, nuk ekzistonte ndonjë fe zyrtare, duke u bërë presion të fortë për ta ulur ndikimin e tyre brenda vendit, “*Njëkohësisht u përpoq që ato të vareshin nga pushteti shtetëror, i cili merrte përsipër rolin e garantit të besimeve të ndryshme*”¹⁵ me ndarjen e shtetit nga kisha donte që të priste përfundimisht lidhjet me regjimin juridik të së kaluarës dhe të mos i nënshtrohen asnjë legjislacioni kanonik, që kleri të përbëhej nga njerëz me kombësi shqiptare dhe të merrte leje nga shteti. *Zogu kishte afirmuar kishën ortodokse në Autoqefal*

Shqiptare për të eliminuar ndikimet e fundit grek në Shqipëri, kishte penguar uniatizmin katolik, i cili mund të shënonte një shtrirje të ndikimit italian, kishte organizuar bashkësinë myslimane, dobësia e së cilës rrezikonte t’i shtynte disa eksponentë të saj që të kërkonin modele reformash fetare jashtë vendit”¹⁶, Shtresat kundërshtuese ndaj Zogut, vinin nga te tria përkatësitë fetare, kështu qysh më 1922, disa hoxhollarë ishin të përfshirë në një kryengritje dhe menjëherë i dënoi ata ashtu sikurse edhe disa krerë katolikë që i dënoi më vonë. Jugosllavia përkrahte opozitën katolike ndaj Zogut, më 1926, dhe qeveria i shoi ato kryengritje. Po të analizohet mirë kjo politikë e Zogut, kujtoj se mund të merret për model në kohën bashkëkohore në të dyja shtetet shqiptare për të mos lejuar devijimet e mundshme të bashkësive fetare. Ligji i vitit 1922, për ndalimin e shkollave katolike, nuk ishin vetëm fetare por ai donte t’i ndalonte shkollat e huaja në shtetin shqiptar. “*Një projektligj tjetër i propunuar në atë periudhë synonte të ndalonte në Shqipëri çdo lloj shkolle private të drejtuar si nga laikë ashtu edhe nga fetarë.* Me pretendim të shtetëzimit të të gjitha shkollave private dhe të huaja që ndodheshin në Shqipëri, nuk dallonte ritet e veçanta fetare. “*Përveç liceve të jezuitëve dhe*

të françeskanëve në Shkodër, dhe shkollave të tjera të mesme dhe fillore të drejtuara nga kongregacione fetare dhe nga kleri katolik i malësive, ligji i ri godiste para së gjithash disa shkolla private myslimane, shkollat e pakicës serbe në veri dhe vllahe në jug, liceun francez të Korçës, shkollat e shumta të pakicës greke pranë kufijve helenikë, disa institute të financuara nga amerikanët dhe ajo që synohej më shumë, shkollat teknike të administruara nga italianët në qytete të ndryshme shqiptare”.¹⁷

Edhe pushtuesit kujdeseshin për bashkësitë fetare

Kujdesi ndaj bashkësive fetare nga italianët ishte në fokusin kryesor, sidomos krerëve përmes të cilëve mendonte ta mbaje nën kontroll popullatën, edhe pse në ditët e para nuk kishte ndonjë vend të veçantë. “Duhet shumë dinjitet e shumë stil nga ana jonë sidomos respekt absolut për gratë e për fetë”, mendonte gjenerali Badio, në ditën e dytë të pushtimit “Objekti i një kujdesi të madh ishte që të vendosej një marrëveshje e plotë mes të ithtarëve të katolicizmit, të ortodoksizmit dhe të fesë myslimane...Me këtë rend idesh që ndërmarrë ndërtimi i kishave qoftë katolike ashtu edhe

¹¹ Po aty 97.

¹² Po aty 45.

¹³ Po aty 76.

¹⁴ Po aty 78,81.

¹⁵ Po aty 124.

¹⁶ Po Aty 126,128.

¹⁷ Po aty 138.

ortodokse si dhe i xhamive”¹⁸ Nga ana tjetër, Italia nuk do të thotë se nuk ishte e njohur me myslimanët, ngase në Romë që në atë kohë kishte përveç rendit katolik edhe “gjashtë milion nënshtetas italianë që ishin myslimanë, ndërkaq Musolini kishte ndërmend të ngrehë një xhami në Romë, mu në ditët e pushtimit të Shqipërisë. Shumë xhami u restauruan dhe u ndërtuan në gjithë Shqipërinë me paratë e qeverisë së Romës, ashtu sikurse edhe kisha të të dyja rriteve. Gjithashtu pushtuesi u kujdes edhe për festat, duke marrë pjesë në tempujt fetarë për madhërimin e tyre, gjë të cilën me kujdes e bënte Jakomoni. Italia përdori edhe këndin politik për të nënshtuar më lehtë shqiptarët, duke pretenduar bashkimin kombëtar. Myslimanët e Shqipërisë, janë mbi të gjitha shqiptarë, vëren autori dhe bën krahasimin se “ashtu si fashizmi beson te Zoti dhe mbështet te gjitha fetë, kështu feja Islame në Shqipëri ishte tolerante dhe mbron tempullin e çdo feje, kishat ashtu si edhe xhamitë”¹⁹ Patriotët shqiptarë duke përfshirë edhe klerikët fetarë mbanin për krenari gjeniumin e tyre të tolerancës e bashkëjetesës si vëllezër nga kombi, kështu një pamflet i françeskanit Marin Sirdani, i shtypur më 1941 në Tiranë, ku përpos lavdërimeve për Musolinin që donte

t’i bashkonte shqiptarët, ai vë në fokus “kombin autokton, i vetmi në Ballkan, meqë ngulimet greke e sllave ishin më të vonshme se ato të fiseve ilire paraardhësve të shqiptarëve të sotëm. Ai lavdëron gjatë gjeninë dhe qytetërimin shqiptar pa asnjë dallim feje.”²⁰ Edhe gjermanët premtonin autonomi për shqiptarët si “Arian të Ballkanit”, kurse sa i përket Islamit, ajo kishte lidhje me Turqinë, bile në një shkrim nga komandanti i Vermahtit thuhej: “Shqipëria në kuadrin e politikës tërësore islamike të Gjermanisë dhe sidomos me lidhjet me Turqinë, kërkonte një trajtim të posaçëm politik”²¹. Mehdi Frashri nuk i besonte mitit Airan të gjermanëve, ndërkaq përpjekja gjermane për themelimin apo krahasimin e SS Mysliman, që kishte vepruar në Francë 1943, i përbërë nga boshnjakë e kosovarë, elita shqiptare reaguesh ashpër duke thënë: “Shteti shqiptar nuk është fetar dhe të gjitha fetë kishin të drejta të barabarta”²².

Përçarja nuk vjen nga feja

Përçarja shqiptare vjen nga të huajt ashtu sikurse copëtimi i trojeve siç u cek më herët që në lashtësi me ndarjen e kishës u ndanë edhe shqiptarët. Pastaj ndarja thellohej përmes fanatizmit fisnor, lokal, ardhjes së pushtuesve

²⁰ Po aty 218.

²¹ Po aty 226,227.

²² Po aty,239.

turq, bullgarë, grekë, sllavë etj. Italia-nët i financonin katolikët që t’i kenë shërbëtorë kundër Zogut, por që në vitet 1927-28, ata më shumë u gëzoheshin ndihmave më të pakta nga vendi i tyre, dhe refuzonin mbrojtjen e financimin nga Musolini-Italia, Venediku, Austria, Franca, e bile edhe Jugosllavia. “Ndihma nga shteti yt më së miri mendonin ata”²³. Të huajt duan ta përdorin fenë për të na përçarë dhe ishte prifti Mjeda, që refuzonte ndihmën dhe propozimet e tyre. “Për mbrojtje nga “masakrimet” e mundshme të katolikëve nga ana e qeverive myslimane dhe bolshevike” Edhe Moroko dela Roka, autori i librit për të cilin po diskutojmë e vëren këtë padrejtësi të shteti të tij që pretendonte ta bëjë në Shqipëri, “Përfundimisht është e guximshme të pohosh se ndihmat italiane ndaj klerit katolik janë provë e përzierjes së tij në politikën shqiptare të qeverisë së Romës”²⁴. Diaspora shqiptare kishte vërejtur se Italia tentonte të përdorte antagonizma mes feve, duke vënë të krishterët kundër myslimanëve, kështu kishte ngritur zërin Stavro Skëndi. Kishte dhe vërejtje të tjera sikurse kjo “Baraspesha e arritur brenda shtetit në mes tri feve nuk mund të turbullohet”²⁵. Nëpër kohë shqiptarët ishin të përçarë

politikisht por jo fetarisht. Të gjitha fetë apo më mirë të themi prijësit fetarë të pasuar nga besimtarët e tyre ishin kundër turkut, grekut, sllavit, italianit, apo siç e sqaron autori “Mysliman ortodoks e katolik kishte si në Frontin e Rezistencës kundërgjermane ashtu edhe në Partinë Komuniste, ashtu edhe në Ballin Kombëtar e Legalitet “Qëndrimi politik nuk varej nga feja por nga mendësia, nga tradita lokale, nga gjendja shoqërore, nga fisi, nga ideologjia, nga përkatësia në njërën ose tjetrën krahinë. ”Nuk janë përkatësitë fetare ose arsye të një natyre fetare ato që karakterizojnë zhvillimin e një konflikti, në të cilin asnjëra nga dyja palët e ballafaquara nuk u referohej shprehimisht interesave fetare. As kleri katolik as ai mysliman nuk kishin fare simpati për lëvizjen komuniste që vepronte me anë të Frontit Nacional Çlirimtar”.²⁶

Konkluzion

Feja do të ishte në vendin më të merituar sikur t’i përmbahej ligjit nga Kongresi i Lushnjës, ku në nenin 93 thotë: “Shteti shqiptar nuk ka fe zyrtare. Të gjitha fetë dhe besimet fetare respektohen dhe sigurohet liria e ushtrimit të tyre të jashtëm, feja në asnjë mënyrë nuk mund të përbëjë një pengesë juridike. Fetë dhe besimet fetare

²³ Po aty 143,144,159.

²⁴ Po aty 161.

²⁵ Po aty 190,193.

²⁶ Po aty 246.

¹⁸ Po aty 189,190.

¹⁹ Po aty 197.

nuk mund të përdoren kurrsesi për
qëllime politike”

RECENSION

Prof. dr. Adem Zejnullahu

MISIONI I KISHËS ORTODOKSE SERBE – VEPËR E DJALLIT

**Hysen Matoshi, “Hapësira etnike, kulturore shqiptare
dhe Kisha ortodokse serbe”, Logos-a, Shkup, 2012, f.47.**

Hysen Matoshi është njëri ndër intelektualët e shquar në letrat shqipe, sidomos në dekadat e fundit, i cili në fushën e mendimit kritik dhe estetik të letërsisë, por edhe të shkencave të tjera, ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në trajtimin e shumë problemeve të ndryshme. E veçanta e shkrimeve të tij është vendosmëria e tij, që të merret me tema më pak ose fare të patrajtuara, të ndërlikuara, të mprehta, të cilave të tjerët iu ikin për shkaqe subjektive.

Një tematikë të tillë, jo të rëndomtë, por me shumë interes e trajton edhe vepra: *Hapësira etnike e kulturore shqiptare dhe Kisha ortodokse*

serbe, e cila para një kohe u botua në dy gjuhë: në shqip dhe në anglisht.

Me ardhjen dhe vendosjen e sllavëve në Gadishullin Ballkanik filloi edhe e keqja më e madhe e popujve të kësaj hapësire, e sidomos për shqiptarët, të cilët pësuan më së shumti në tkurrjen e hapësirës etnike, në dëmtimin e qenies kombëtare, si dhe në shkatërrimin e vlerave etnokulturore.

Dhuna gjenocidiale ndaj popullit tonë fillon që nga kohërat e hershme, e sidomos intensifikohet me ardhjen në pushtet të Stefan Nemanjës, themelesit të shtetit të parë serb mesjetar, i cili ushtroi dhunë të egër ndaj të gjithë atyre që nuk i përkisnin popullit dhe fesë së tij. Ai dhe pasardhësit e tij:

mbreti Millutin dhe Car Dushani në mënyrë të vazhdueshme, që nga koha e formimit të këtij shteti, i ndoqën, i plaçkitën, i dogjën, ua përvetësuan pronat e popujve të tjerë në hapësirën ballkanike, e në radhë të parë shqiptarëve, maqedonasve, bogomilëve, grekëve etj., madje duke ua zhdukur edhe vlerat e tyre etnokulturore, si për shembull: mësuesve të bogomilëve ua prinin gjuhën, ua digjin librat etj., gjë që shkaktoi shpërnguljen e tyre nëpër vende më të sigurta.

Hysen Matoshi në veprën e lartshënuar, në objektivin vështrues e studiuës, ka çështjen e hapësirës etnike e kulturore të shqiptarëve, në raport me dhunën institucionale të Kishës Ortodokse Serbe, e cila gjatë tërë historisë, e njësoi mendimin dhe veprimin e saj me dhunën e egër të prijësve shtetërorë në përvetësimin e hapësirës dhe të zhdukjes së vlerave kulturore të kombit tonë. Autori në shkrimin e tij: *Akti i parë i zhbërjes së hapësirës etnike dhe kulturore shqiptare*, kthen kujtesën e hidhur në periudhën Luftërave Ruse-Turke të viteve 1875-1878, kur afro 600 fshatra e qytete shqiptarë të Sanxhakut të Nishit me tërë pasurinë e tyre shpirtërore e materiale, u fshin nga harta gjeografike nga forcat ushtarake serbe, të cilat barbarisht i plaçkitën, i dogjën, i vranë, duke i shkatërruar edhe vlerat e trashëgimisë kulturore e fetare. Urrejta ndaj shqi-

ptarëve e turqve nga klerikët ortodoksë serbë ishte e patologjike. Kështu, Peshkopi i Nishit, Domentijani, kur i vizitoi të plagosurit, i porosiste ushtarakët serbë që “të thernin turq e të grinin shqiptarë!”.

Serbët rrënuan edhe tempujt fetarë: mejtepe, teqe e xhamia, me qëllim të caktuar që të mos ketë gjurmë shqiptare. Në vazhdim të shkrimit, autori sjell të dhëna të mjaftueshme nga udhëpërshkruesit e ndryshëm të asaj kohe, si Evlia Çelebiu e të tjerë, të cilët në shkrimet e tyre, flasin për prarinë e madhe të popullatës shqiptare në Sanxhakun e Nishit, me tempujt e tyre kombëtar e fetar.

Nga kjo hapësirë e madhe etnike shqiptare, mbetën vetëm vuajtjet, tragjeditë, kujtimet e hidhura me toponimet dhe këngët e muhaxhirëve, të cilat u bartën brez pas brezi deri në ditët tona.

Në realizimin e këtij skenari tragjik për popullin tonë, ideatore dhe bashkëvepruese, ishte edhe Kisha Ortodokse Serbe, që nxiti, e frymëzoi dhe i ndihmoi forcat ushtarake serbe, për pushtimin e hapësirës sonë etnike dhe zhdukjen e traditës kulturore. I këtij mendimi ishte edhe bariu i grigjës së saj - Mitropolitit Amfillohi, kur thoshte: ”Zoti kërkon prej këtij populli

diçka të madhe, posa e vendosi në fokus të ngjarjeve botërore”.¹

Po të vështrohet me kujdes fragmenti i lartshënuar, nënteksti i tij, qet në shesh rrenën e kulluar të këtij patriku, që mundohet ta mashtrojë Zotin dhe besimtarët e vet, se kinse: Zoti e paska krijuar këtë racë njerëzore të privilegjuar, që t’i sundojë të tjerët, t’ua rrëmbejë të tjerëve hapësirën etnike, lirinë dhe vlerat kombëtare, ashtu siç pretendojnë edhe sot disa nga popujt që e quajnë veten “popull hyjnor”. Kjo fantazi serbe donkishotiane u bart brez pas brezi, madje edhe në luftërat e fundit në ish-Jugosllavi, kur njëri nga kriminelët e njohur serb, Radovan Karaxhiq, deklaronte bashkëveprimin e Kishës Ortodokse serbe me forcat e ndryshme ushtarake serbe: “Kleri ynë është i pranishëm në të gjitha mendimet dhe vendimet tona, kurse zëri i kishës dëgjohej si zëri i autoritetit më të lartë!”²

Në vlogun e zhvillimit të ngjarjeve në ish-Jugosllavi gjatë viteve të 90-ta, Kisha Ortodokse serbe shkoi shumë larg me veprimtarinë e saj, duke i deklaruar zëshëm edhe “...kufijtë e shtetit të ri serb, edhe popujt me të cilët serbët nuk mund të jetonin më së bashku e të cilave nuk mund t’u besonin më, duke shpjeguar se duhen përdorur

edhe armët për realizimin e interesave të tyre”.³

Në vazhdim të veprës autori bën fjalë edhe për barinjtë e grigjës së Kishës Ortodokse serbe, të cilët u angazhuan shpirtërisht dhe fizikisht me përkushtim për realizimin e qëllimeve ogurzeza ndaj popujve të tjerë të Ballkanit, e veçanërisht ndaj shqiptarëve.

Hysen Matoshi në shkrimin tjetër në vazhdim në këtë vepër: *Priftërinjtë serbë – “engjëj” të luftës*, përforcon edhe një herë fuqishëm mendimin se klerikët e Kishës Ortodokse serbe gjatë tërë historisë, kanë qenë frymëzues, nxitës, madje vullnetarë të bandave dhe formacioneve të rregullta për të vrarë, plaçkitur, djegur, shkatërruar vlerat e popujve të tjerë. Ata, kur kishin mundësi, vlerat e huaja i përvehtësonin, duke i ndryshuar e mitizuar, siç është rasti i shumë tempujve fetarë i kishave dhe manastireve të paraardhësve tanë në këto hapësira.

Priftërinjtë e Kishës Ortodokse me udhëheqësit politikë serbë gjatë rrjedhave historike kur ballafaqoheshin me realitetin jetësor e historik, për të çuar ujë në mullirin e tyre, shtrembëronin aktet e faktet me një imagjinatë të shfrenuar, duke i mitizuar apo kamufluar me mjeshtëri djallëzore, ngjashëm si dikur Jozef Paul Gebles,

ministër për propagandë i Hitlerit, kur i porosiste bashkëpunëtorët e vet: “Thojeni gënjeshtren shumë herë dhe mandej përsëritni, se njerëzit mund ta besojnë.” Ngjashëm vepruan edhe serbët gjatë tërë historisë. Ata rrejtën, trilluan shumëçka. Shumë herë, disa prej rrenave të tyre, bile disa i morën për të vërteta.

Tanimë nuk është kontestuese se Kisha Ortodokse serbe, u krijua dhe u zmadhua me gjakun e të tjerëve, me shpatën e Nemanjiqëve, Millutinoviqëve dhe të Dushanëve, të cilët si parim patën: **të dobët bjeri e të fortit përulju.**

Sipas studiuesit Millorad Tomaniq, njërit ndër njohësit më të mirë të kësaj problematike, serbët gjatë gjithë historisë i dogjën, i pushtuan dhe i zotëruan tokat e huaja shekuj me radhë.

Mbreti Dushan, më 1347, pushtoi tërë Shqipërinë. Ai dogji fshatra e qytete të tëra, preu kokat e shqiptarëve, të maqedonasve dhe i zhduku bogumilët. Kështu, Kisha Ortodokse u ngrit në nivel të Patriarkales me vuajtjet dhe gjakun e popujve të Ballkanit.

Kaptinë e veçantë në librin e Hysen Matoshit, është vuajtja dhe tragjedia e shqiptarëve gjatë gjithë historisë, e sidomos konvertimi me dhunë nga feja e vet në fenë ortodokse, që ishte fe e pushtuesit. Kjo e keqe shtesë ndaj shqiptarëve ka zënë vend të rëndësishëm në trajtimin dhe në studimin e

Hysen Matoshit. Ai, këtë problematikë e vështron nga aspekti kombëtar, historik dhe fetar.

Sipas të dhënave memoriale, folklorike dhe historike konvertim të dhunshëm ndaj shqiptarëve bënë sllavo-bizantinët: malazeztë, serbët, grekët dhe maqedonasit, sidomos gjatë periudhës së viteve 1912-1918.

Matoshi konstaton me të drejtë se pushtuesit e hapësirës sonë etnike para botës propagandonin se kinse shqiptarët konvertoheshin në fenë ortodokse me dëshirë, por në të vërtetë, ata torturoheshin e masakroheshin në mënyrën më të egër, duke i vënë të gjallë në zjarr ose në akull derisa pranonin ose vdisnin, bile edhe duke i shtirë të gjallë në varre.

Në këtë dramë tragjike të shqiptarëve, rolin kryesor e kishte Kisha Ortodokse serbe me priftërinjtë e saj, të ndihmuar edhe nga ata rusë, që do të thotë se aktin e konvertimit e bënë me dije të Rusisë dhe të disa vendeve të tjera, përkrahëse të këtij akti të shëmtuar.

Shqiptarët e Plavës, të Gucisë dhe të Rrafshit të Dukagjinit etj., konvertimin me dhunë nga feja islame në atë ortodokse që ishte fe e huaja e përjetuan dhe e pagëzuan me të drejtë si: **“Dita e Kiametit në tokë”**. Konvertimi të tilla pati shumë në: Plavë, në Guci me rrethinë, në shumë fshatra të Pejës, të Gjakovës, në Leshan të Suha-

¹ Millorad Tomaniq, Kisha serbe në luftë dhe luftërat Brenda saj, Shkodër, 2006, f.8.

² Vepra e cituar, f.134.

³ Po aty, f.80.

rekës, në Karadak të Gjilanit, në disa fshatra e qytete të Çamërisë, në Milincë, Bukuçan dhe Tajmisht të Kërçovës së Maqedonisë etj.

Në këtë hark kohor ishte shfrenimi më i madh i urrejtjes së bandave serbe ndaj shqiptarëve. Kështu Vojvoda i kralit – Koica Popoviq i Marocës, njëri ndër kriminelët më të mëdhenj të kësaj kohe pasi pushkatoi shumë shqiptarë në Kosovën Lindore, të cilët nuk pranuan të konvertoheshin në ortodoksë, ai me dhunë mori Hamiden e Sylë Sijarinës, pastaj Ajshen e Qehajave, dy vajza të reja shqiptare me qëllim që t'i konvertojnë dhe t'i martojë për serbë. Mirëpo, Hamidja që ishte më e rritur nuk pranoi të martohet për serb, atëherë kriminelët e lidhen për bishtin të kuajve dhe e shqyen mu tek Ura e Petrelës, në Medvegje. Ndërsa, Ajshja e frikësuar nga tmerri që kishte parë e pranon fatin që të mbetet në duart e kriminelëve çetikë, duke pritur ditë më të mira.⁴

Aktin e konvertimit me dhunë të shqiptarëve në fenë ortodokse serbe, e kënduan shumë rapsodë, (në njëmijë e gjashtëqind vargje) në të cilat pasqyrohet hollësisht dhuna e shfrenuar e pushtuesve, me pamje të ndryshme makabre, duke vrarë shqiptarë, pa marrë parasysh moshën e gjininë e tyre.

Për këtë veprim antinjerëzor shkruan edhe shumë intelektualë të ndryshëm historianë, studiues, publicistë, udhëpërshkrues të ndryshëm, ndër ta edhe njohësja më e mirë e ngjarjeve të Ballkanit, zonja Edith Durham.

Në veprën “*Hapësira etnike e kulturore e shqiptarëve dhe kisha ortodokse serbe*”, një vend të veçantë zë shkrimi me titull: Akti i tretë: *Toka e djegur shqiptare – tokë e lirë serbe*, në të cilën autori shkruan në mënyrë të hollësishme për dhunën e orkestruar sistematike ndërmjet Kishës Ortodokse, Akademisë së Shkencave të Serbisë dhe udhëheqësve të shtetit serb, në zhvillimin e ngjarjeve të shek. XX, e, në veçanti, gjatë viteve të '80, kur kisha me ultranacionalistët serbë njësoi tërë mendjen dhe veprimin e saj për shkatërrimin hapësirës etnike dhe vlerave etnokulturore të shqiptarëve.

Në kujtesën e popullit tonë, ende për pa u harruar emrat e xhelatëve të Avro Cemit, Savë Batarjes, Mitrit të Zi, Miliq Kërstës, Kosta Vajvodës, Spiro Dellocit etj, në vitet e '80 doli në skenë Slobodan Millosheviqi me bashkëpunëtorët e tij, që morën bekimin e Kishës Ortodokse për të masakruar, ndjekur, djegur e vrarë shqiptarë, në mënyrë që t'u tkurret hapësira etnike, liria kombëtare e fetare dhe ta braktisin atdheun e vet.

Nuk ka dyshim se barinjtë e grigjës së Kishës Ortodokse serbe gjatë histo-

risë i bashkërenditnin mendimet dhe aksionet e tyre me ato të AKSHS-së dhe të prijesve shtetërorë për realizimin e projekteve të tyre, në tkurrjen e hapësirës etnike dhe në zhdukjen e vlerave të trashëgimisë sonë kulturore. Këtë dramë tragjike e ndihmuan edhe shumë intelektualë serbë: akademikë, shkrimtarë, historianë, publicistë, studiues dhe profesorë të cilët në shkrimet e tyre prekën kulmet e absurditetit profesional e shkencor. Një veprim të tillë paraqet edhe shkrimi i profesore-shës, Ollga Llukoviq, kur shkruan: “...shqiptarët ua kanë borxh serbëve tokën në të cilën jetojnë, emrin me të cilin i njih bota dhe gjysmën e gjuhës me të cilën flasin”...⁵ Nuk do mend se edhe lexuesi më pak i informuar për historinë dhe zhvillimin kulturor të shqiptarëve nuk do ta pranonte këtë çmenduri pa kurrfarë baze reale e as shkencore, ndoshta edhe ajo e dinte të vërtetën, por do t'i shërbejë politikës ditore ultranacionaliste serbe për qëllime të caktuara.

Dëshiroj t'ia përkujtoj profesore-shës - se ka harruar të shkruajë, për të parët e saj kur erdhën nga Karpatet e largëta, a e sollën edhe këtë tokë në çanta, apo e gjetën këtu, e ia rrëmbyen dikujt?! Ky zbulim donkishotian “shkencor”, ndoshta është frymëzuar nga fjalët e Pjanoviçit kur thoshte –

serbët janë populli më i vjetër në botë, të publikuar në gazetën e Patriarkales serbe “Pravoslavlje”.

Sa e kishte të zgjatur dorën “e shenjtë” Kisha ortodokse serbe në bashkëveprim me udhëheqësit politikë shtetërorë serbë në vitet e '90, duke i bërë gjithmonë shqiptarët fajtorë kujdestarë për të gjitha të këqijat që ndodhnin në hapësirën e ish-Jugosllavisë, Hysen Matoshi, flet në shkrimin me titull: *Shqiptarët – halë në sytë e një patriarku*, ku bën fjalë për njërin ndër udhëheqësit e shquar të Kishës ortodokse serbe, Patriku Pavël që kishte shërbyer 34 vjet në Kosovë. Do theksuar se edhe ky patriark veprimtarinë e vet e inkadroi në rrjedhat shoqërore e politike të kohës, duke e ndihmuar politikën hegjemoniste serbe ndaj popujve të tjerë në ish-Jugosllavi, e në mënyrë të veçantë ndaj shqiptarëve. Ai, në vitet e '90 derdhi një det vrer ndaj të gjithë atyre të cilat s'i përkisnin kombit e fesë së tij. Qëndrimet e tij ndaj çështjes kombëtare e fetare të popullit shqiptar ishin në pajtim të plotë me ato të ultranacionalistëve të kohës më të re. Ky patrik në një fjalim të tij të mbajtur para besimtarëve të vet në Zagreb, kur ishin acaruar tej mase marrëdhëniet ndërmjet kroatëve dhe serbëve tha: “Në Kosovë kam shërbyer si peshkop 34 vjet. Një ditë prej ditësh mora një letër prej një shqiptari, hoxhë i një vendi të atje-

⁴ Arkivi i Institutit Albanologjik të Prishtinës. Dosja e Muhamet Pirrakut.

⁵ Millorad Tomaniq, vepra e cituar, f. 94.

*shëm, i cili më shkruante: "Për besimin mysliman është i papranueshëm parimi: po nuk iu err njërit, nuk mund t'i zbardhë dita tjetrit". Unë iu përgjigja se edhe për krishterimin një parim i tillë është i papranueshëm. Toka e Zotit është mjaft e gjerë sa të këtë vend për të gjithë, po të jemi njerëz. Po të mos jemi njerëz, ajo është e ngushtë edhe për një grusht njerëzish."*⁶

Koha tregoi se ky patrik, ndryshe kishte thënë e ndryshe kishte vepruar, si ndaj të tjerëve ashtu edhe ndaj shqiptarëve. Ky, si edhe të gjithë priftërinjtë serbë, i bekonte me dorën e vet kriminelët që vranë me mijëra shqiptarë.

Dimension të veçantë në këtë vepër paraqet shkrimi i Hysen Matoshit, që flet për raportet e këtij patriku dërguar Sinodit të shenjtë të Kishës ortodokse serbe, në gazetën "Večernje Novosti" të Beogradit. Ky udhëheqës shpirtëror ortodoks, edhe pse e kishte për detyrë e obligim të mbjellë e kultivojë besimin ndërmjet popujve dhe besimeve të ndryshme, që të kishin më shumë mirëkuptim e tolerancë fetare e kombëtare, ai për çudi i shërbeu politikës hegjemoniste serbe, për tkurrjen e hapësirës etnike dhe rrënimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të popujve të tjerë, e sidomos të shqiptarëve. Në vazhdim të shkrimit, Hysen Matoshi shkruan në mënyrë të hollësishme

edhe për urrejtjen patologjike që ndien ky pjesëtar i grigjës së Kishës ortodokse serbe ndaj kombit, lirisë, traditës dhe gjuhës sonë.

Tanimë nuk është fare kontestuese se Kisha ortodokse serbe u themelua dhe u avansua me anë të zjarrit e të shpatës, mbi djegiet e hapësirës etnike dhe gjakut të derdhur të popujve më të dobët në Gadishullin Ballkanik, ndër ta më së shumti të shqiptarëve, të cilët gjatë gjithë historisë u therorizuan për mbijetesë kombëtare e fetare. Këtë të dhënë të pamohueshme, madje e pohojnë edhe vetë themeluesit e shtetit dhe të Kishës ortodokse serbe, që nga Stefan Nemanja, mbreti Millutin, Car Dushani, Millan Obranoviqi etj. Në këtë orkestrim fatkob e tragjik për popullin tonë dhe të disa popujve të tjerë, fatkeqësisht i hasim edhe barinjtë e grigjës së Kishës ortodokse serbe, të cilët në vend që ta kultivojnë e propagandojnë te besimtarët e vet dashurinë hyjnore ndërmjet popujve në këtë botë, ata bënë të kundërtën, morën shpatën, e nuk morën mësim nga veprimi i Isasë, kur i thoshte Apostullit Pjetër, që ta" ... kthejë shpatën aty ku e ka vendin, sepse të gjithë ata që rrokin shpatën, prej shpatës do të vdesin"⁷. Priftërinjtë ortodoksë e përqaftuan urrejtjen dhe veprimin gjenocidial ndaj popujve të tjerë, sidomos ndaj

shqiptarëve, duke ua mohuar e tkurrur hapësirën etnike, lirinë e dhuruar nga Zoti dhe besimin fetar, ndaj për çudi veprimtarinë e tyre e vunë në shërbim të djallit, e jo të Zotit. Këtë e dëshmon edhe vepra e Hysen Matoshit.

Në fund do thënë se vepra "*Hapësira etnike e kulturore e shqiptare dhe Kisha ortodokse serbe*", e Hysen Matoshit, edhe pse në aspektin e gjerësisë është e vogël si vëllim, me përmbajtjen që ngërthen dhe me trajtimin që i bën, njërës ndër çështjet më të rëndës-

ishme dhe më të ndërlikuara ndërmjet dy popujve, shqiptarëve dhe serbëve, veçmas dimensionit hapësinor etnik, dhe vlerave të trashëgimisë etnokulturore, përplasjes së tyre gjatë shekujve, njëri për të mbijetuar, e tjetri për të mbizotëruar dhe zhdukur të tjerët, është vepër me vlerë të theksuar historike, sepse i shtron dhe trajton me kompetencë shkencore çështjet e ndërlikuara të marrëdhënieve serbo-shqiptare.

⁶ Po aty, f.86.

⁷ Vepra e cituar, f.246.

PËRMBAJTJA

Qemajl Morina	
Pranvera arabe: mes islamit dhe laicizmit.....	5
Nexhat Ibrahim	
Besimi në Kader	15
Mr. Ejup Haziri	
Kamata dhe alternativat islame	27
Qemajl Morina	
Gjuha arabe në vendet islamike.....	57
Sadik Mehmeti	
Koleksioni i librave të vjetër në gjuhët orientale në Bibliotekën e Arkivit të Kosovës.....	83
Genti Kruja	
Dr. Haxhi hafiz Hasan Kaduku (1865-1948), stomatologu i parë shqiptar.....	113
Nexhat Ibrahim	
Lëvizja Tradicionaliste Vehabiste apo thirrja e Muhammed ibn Abdulvehhabit	121
Nuridin Ahmeti	
Çështja Çame (Sipas gazetës “DAJTI” të Hafiz Ibrahim Dalliut).....	131
Mr. Rexhep Suma	
Etika Islame në komunikim	143
Sadik Mehmeti	
Koleksioni i librave të vjetër në gjuhët orientale në Bibliotekën e Arkivit të Kosovës.....	173
Ramadan Gara	
Komuniteti Mysliman Shqiptar dhe boshnjak në diasporën Kroate-Slllovene në Evropë dhe në botë	201
Zachary Karabell	
Kryqëzatat	215

Mexhid Yvejsi

Në përkujtim të 110-vjetorit të lindjes së dijetarit të famshëm - hoxhës së hoxhallarëve - myderriz, hafiz Fahri ef. Iljazi (1903-1985).....	251
---	------------

Prof. dr. Hysen Matoshi

Një kurorë nocionesh fetare	265
--	------------

Prof. dr. Sabile Keçmezi-Basha

Dëshmi për kontributin e prijësve myslimanë në formimin e identitetit kombëtar	269
---	------------

Refik Gërbeshi

Kombi dhe feja te shqiptarët.....	277
--	------------

Prof. dr. Adem Zejnullahu

Misioni i Kishës Ortodokse Serbe - vepër e djallit.....	285
--	------------

Përmbajtja	299
-------------------------	------------